



Botim i përtremuajshëm i QSHRT
(Qendra Shqiptare e Rehabilitimit të Traumës dhe Torturës)




QSHRT Botimet 2013
Rr. "Kont Urani" Nr.10



Me mbështetjen e Bashkimit Evropian

Në kuadër të zbatimit të programit "Mbështetje për të drejtat e njeriut dhe aksesin në drejtësi për grupet e marginalizuara në vendet e privimit të lirisë"



SHËNDETI MENDOR
dhe TË DREJTAT E NJERIUT

SHËNDETI MENDOR
dhe TË DREJTAT E NJERIUT

Vol 14 (2013)
Nr. 1

Zhvillimet në sistemin e burgjeve

Volumi 14, Numri 1 (2013)

Ne kuader te zbatimit te programit
“Mbeshtetje per te drejtat e njeriut dhe aksesit ne drejtesi per
grupet e marginalizuara ne vendet e privimit te lirise”
Publikuar me mbështetjen e Komisionit Evropian



Volumi 14, Numri 1 (2013)
TE DREJTAT E NJERIUT DHE SHENDETI MENDOR



©Copyright: Qendra Shqiptare e Rehabilitimit të Traumës
dhe Torturës (QSHRT).

Te gjitha te drejtat jane te rezervuara.

Permbajtja e ketij botimi nuk mund te riprodhohet,
kopjohet pa citimin ne dokument. Permbajtja reflekton opinionet e bot-
uesit dhe ne asnje rrethane te Komisionit Evropian

Botimet QSHRT 2013

Drejtor Ekzekutiv:

Adrian KATI

ARCT/QSHRT

Rr.Kont Urani 10

Tirana, ALBANIA

Tel: +355 422 56522

Fax: +355 422 39121

Email: arct@albmail.com

Grafika

Elvira Çiraku (Osmani)

PËRMBAJTJA E LËNDËS

PJESA E PARE

PERSONAT ME NEVOJA TE VEÇANTA NE SISTEMIN E PRIVIMIT TE LIRISE KUADRI NDERKOMBETAR.....	5
A. Njerëzit me Aftësi të Kufizuar si Subjekte dhe jo si Objekte.....	5
1. Domethënia e të Konceptuarit të Aftësisë së Kufizuar si një aspekt i të Drejtave të Njeriut	6
2. Ndryshimet e Larmishme të Koncepteve të Barazisë	7
3. Një proces reformash me shumë shtresa: Zhvillimet Kombëtare dhe Rajonale.	9
B. Të Drejtat Ndërkombëtare të Njeriut dhe Aftësia e Kufizuar: Ndryshime brenda Makinerisë së të Drejtave të Njeriut në Kombet e Bashkuara.....	10
1. Zhvillimet e Politikave të Ligjshmërisë së Paqëndrueshme.....	10
2. Zhvillime të Vështira të Ligjshmërisë: Mbrojtja sipas Instrumenteve të Përgjithshme të të Drejtave të Njeriut	12
3. Një Rend i Ri Dite: Drejt një Traktati të Ri ndaj Aftësisë së Kufizuar? ...	13
C. Procesi Reformues në Ligjshmërinë Krahasuese	14
1. Modeli: Përdorimi i ADA-s dhe Rregullat Standarde si Modele Tërësore Ligjore.....	15
2. Një aspekt tematik: Ligji mbi Aftësinë e Kufizuar si një ligj për mëshirë në Evropë	16
3. Një Krahasim tërësor i Ligjeve - Kundër-diskriminuese.....	19

RAST STUDIMI:

PËRDORIMI I LIGJIT RAJONAL TË SHËRBEJË SI NJË NXITËS PËR NDRYSHIM – DREJT “ NJË AKTI EVROPIAN PËR TË DREJTAT E NJERËZVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA”	35
A. Këshilli i Evropës dhe Aftësia e Kufizuar	37
1. Sfondi: Mjetet Ligjore dhe Instrumentat Administrative të Këshillit.....	37
2. Konventat e Këshillit të Evropës në kontekstin e aftësisë së kufizuar	40
3. Rekomandime për Linja Veprimi të Këshillit të Evropës në kontekstin e Aftësisë së Kufizuar	54
4. Grupet e Punës së Këshillit të Evropës, Studime, etj., në Kontekstin e Aftësisë së Kufizuar	63
A. Bashkimi Evropian dhe Aftësia e Kufizuar	66
1. Sfondi: Mjetet Ligjore dhe Instrumentat e Linjave Vepruese të Bashkimit Evropian	66
2. Linjat e Veprimit për Aftësinë e Kufizuar të BE-së në vitet 1980.....	70
3. Modeli për zhvendosje të Shanseve të Barabarta/Mos-Diskriminim në vitin 1990	73
Krijimi i Qasjeve të Barabarta në Instrumentat e dhënies së Informacionit Shoqëror	82
Përshtatja me Nismat e Reja të të Drejtave të Njeriut të Evropës.....	84
Konkluzionet – Perspektivat për një Akt Evropian për Aftësitë e Kufizuara (EDA).....	85
Tendencat e Tanishme dhe Perspektivat e së Ardhmes	86

PJESA E DYTE

SISTEMI I BURGJEVE DHE KARAKTERISTIKAT E PERGJITHSHME TE ZHVILLIMIT.....	89
Kuadri ligjor i trajtimit të personave me liri të kufizuar.....	93
Zbatimi i rekomandimeve të ndërkombëtarëve për rehabilitimin e të burgosurve	95
Parandalimi i torturës nëpërmjet trajnimit të stafit	98
Praktikat në trajtimin e personave me liri të kufizuar.....	100
Zhvillimi i programeve për rehabilitimin e personave me liri të kufizuar...	108

**PJESA E PARE**

*Personat me nevoja te veçanta ne sistemin
e privimit te lirise kuadri nderkombetar*

A. Njerëzit me Aftësi të Kufizuar si Subjekte dhe jo si Objekte

Ligjshmëria e Aftësisë së Kufizuar nuk ka qenë një fushë e kërkimeve legale dhe mësimi në shumë universitete të Shteteve të Bashkuara, por gjithashtu as nuk ka qenë gjerësisht e njohur nëpër vendet e tjera të mbarë botës. Në Amerikën e Veriut dhe në shumicën e vendeve Evropiane, aftësia e kufizuar si një çështje ligjshmërie ka qenë e trajtuar si një aspekt i sigurisë, ndihmës, kujdestarisë sociale apo si aspekt i ligjshmërisë shëndetësore. Pra këta persona me aftësi të kufizuar nuk janë parë si subjekte me të drejta legale por si objekte të ndihmës sociale, shëndetësore dhe të programeve bamirëse.

Shtrirja e politikave sociale prapa këtyre përgjigjeve legale, ka qenë një faktor që i shkëputte dhe i përjashtonte njerëzit me aftësi të kufizuar nga rrjedha e përgjithshme e shoqërisë, edhe pse disa herë ata siguroheshin në shkolla të veçanta, përfshiheshin në seminare të posaçme, strehoheshin nëpër shtëpia të ndara dhe transportoheshin veçmas të tjerëve. Këto forma organizimi justifikoheshin nga paragjykimet e përhapura se gjoja personat me aftësi të kufizuar janë të paaftë të përballen me të gjitha ose me më të shumtën e aktiviteteve mbarëshoqërore të jetës së përditshme. Për fat të mirë, kur disa vende bënë përpjekje për të bërë një qasje më integruese dhe më përfshirëse ndaj politikave të aftësisë së kufizuar, në fakt rezultoi që të ndërmerreshin reforma më të mëdha ligjore. Orvatjet që ndaj njerëzve me aftësi të kufizuar tu hapeshin dyert e punësimit, arsimimit, strehimit, tu shpërndareshin të mira materiale dhe tu ngriheshin shërbime kanë çuar në forcimin e opinionit që problemet që lidhen me aftësinë e kufizuar kanë një bazë sociale dhe jo mjekësore. Një element thelbësor i këtij koncepti të ri është se botëkuptimi i ndarjes dhe i përjashtimit të njerëzve me aftësi të kufizuar, logjikisht nuk

duhet të ndjekë faktin e dëmtimit, dhe as zgjedhjen e atyre politikave që bazohen tek konceptet e gabuara mbi aftësinë e kufizuar. Pasja e problemeve nuk vjen domosdo nga dëmtimet në lëvizshmëri, shikim apo dëgjim, por më tepër janë rrjedhim logjik i ndërmarrjes së politikave për të bërë hapa dhe jo platforma të lëvizshme; sikur të merresh informacioni nëpërmjet një letre të printuar dhe që nuk mund të tjetërsohet apo nëpërmjet komunikimit me anë të shenjave. Në vend që aftësia e kufizuar të shihet si një problem individual, mjedisi dhe shoqëria si një e tërë ngecet duke mos marrë në konsideratë dallimet midis njerëzve.

1. Domethënia e të Konceptuarit të Aftësisë së Kufizuar si një aspekt i të Drejtave të Njeriut

Në bazë të tezave të hedhura sipas të cilave aftësia e kufizuar të shikohet jo vetëm si aspekt mjekësor por për më tepër si model shoqëror aftësia e kufizuar u riklasifikua në bazë të ligjshmërisë ndërkombëtare si një çështje e të drejtave të njeriut.

Reformat në këtë fushë kishin për qëllim të siguronin shanse të barabarta për njerëzit me aftësi të kufizuar dhe të vënë në dukje se ndarja, institucionalizimi dhe përjashtimi i tyre është një formë tjetër sakatimi e bazuar në diskriminim. Me evoluimi e të drejtave të tilla civile me legjislacionet e reja për personat me aftësi të kufizuar si Akti Amerikan për Aftësinë e Kufizuar (ADA), edhe tezat ligjore kombëtare në fjalë shkuan edhe më tutje nga të qenurit ligje të ndihmës sociale në ato të së drejtës civile. Ky dimension i ri i aftësisë së kufizuar është mirëpritur si një moment historik në njohjen eventuale të të drejtave të njeriut tek njerëzit me aftësi të kufizuar, si një nismë që do të duhet të përkrahet nga shumë e shumë qeveri të tjera.

Sidoqoftë mbetet e paqartë se sa do të jetë shtrirja e këtij ndryshimi. Në çfarë shkalle do të mund të përkrahesh nga qeveritë zëvendësimi i legjislacionit të tanishëm të vjetërsuar të përkrahjes sociale që e trajton aftësinë e kufizuar si një problem mjekësor, me legjislacionin bashkohor të të drejtave civile?

Kemi nevojë më ne për përfitime të cilat tradicionalisht janë dhënë si kompensime sociale? Kush janë pasojat legale të zëvendësimit të modeli mjekësor të aftësisë së kufizuar me atë social? Natyrisht, këto çështje ngrenë temën delikate se si do të bëhet shpërndarja e burimeve materiale, shpirtërore dhe intelektuale në shoqëri.

Pastaj, gjithashtu, këto pyetje janë të lidhura ngushtë me një tjetër çështje që ndikon në rezultatin e reformës ligjore të ligjshmërisë së aftësisë së kufizuar: me parimin e barazisë. Ky parim, njëri prej më themelorëve të të drejtave të njeriut, është relativ: barazia për njerëzit me aftësi të kufizuar ngre disa pyetje plotësuese, të tilla si me cilët duhet të jetë i barabartë, të së cilës shtrirje, dhe në çfarë rrethanash? A është e mjaftueshme hapja e dyerve të arsimimit, punësimit dhe të pjesëmarrjes në politikë, apo a kemi nevojë ne

për të ndihmuar këdo për tu gjendur i ingranuar? Si mund të ndihmohet kushdo për tu gjendur i ingranuar nëse shkollat, ambientet e punës dhe ndërtesat publike janë të disponueshme ndërkohë që transporti publik jo? Është e mjaftueshme të pengosh diskriminimin e pa honepsur të aftësisë së kufizuar në punësim, apo a kemi nevojë ne për të garantuar mbulimin e më shumë formave më delikate ose “ të vullnetit të mirë” të diskriminimit? A mjafton kjo për të lejuar disa njerëz me aftësi të kufizuar të jetojnë jashtë institucioneve, ose a kemi nevojë ne që çdokush të jetojë jashtë? A kemi arritur ne barazinë nëse punëtorët me aftësi të kufizuar marrin të njëjtën rrogë si punëtorët e tjerë që nuk kanë të meta, por që në fakt kanë për të shpenzuar 60% të rrogës së tyre për shërbimet e asistencës personale gjë për të cilat të punësuarit e tjerë nuk e kanë këtë nevojë?

2. Ndryshimet e Larmishme të Koncepteve të Barazisë

Ndërsa ekziston një konsensus mbi bazat e parimit të barazisë si në ligjshmërinë e rangut kombëtar po ashtu edhe të atij ndërkombëtar, interpretimi i këtij parimi mbetet i diskutueshëm. Tre drejtimit kryesore të konceptit të barazisë janë (1) barazia zyrtare ose juridike, (2) barazia e rezultateve, dhe (3) shansi i barabartë ose barazia strukturore. Barazia juridike pengon në mënyrë të drejtpërdrejtë diskriminimin dhe ka për qëllim të shmangë fuqinë diskriminuese ndaj karakteristikave të tilla si raca, gjinia, aftësia e kufizuar, ose orientimi seksual. Qysh atëherë kur legjitimimi i trajtimit jo të barabartë mbi bazën e këtyre karakteristikave është i konsideruar si arbitrar, barazia juridike i kërkon shoqërisë të injorojë këto diferenca. Ky koncept ndesh me kërkesat e aktivistëve të të drejtave të aftësisë së kufizuar të cilët përpiqen të mposhtin modelin mjekësor të aftësisë së kufizuar duke vënë theksin mbi nocionin që aftësia e kufizuar nuk është burimi i problemit. Sidoqoftë, në rastet kur aftësisë së kufizuar i ofrohen disponibilitete, për të arritur barazinë, kërkohen të bëhen modifikime dhe përshtatje të ndryshme programesh. Dhënia e mundësive dhe ofertave në mënyrë të barabartë ndaj të gjithë anëtarëve të shoqërisë kërkon njohjen e diferencave të ndryshme që ekzistojnë midis të gjithë anëtarëve.

Martha Minow ka nxjerrë në pah dilemën morale që ka të bëjë me dallimet njerëzore të tilla si aftësia e kufizuar. Injorimi i dallimeve ndihmon në parandalimin e stereotipeve dhe stigmatizimeve por me çmimin e dështuar për të mos i dhënë drejtësi realitetit dallimor. Vënia në konsideratë të dallimeve i bën drejtësi realitetit të dallimeve por fuqimisht përjetëson presupozime të gabuara në lidhje me natyrën e dallimeve.

Barazia e rezultateve në thelb e shqyrton aftësinë e kufizuar nëpërmjet analizimit të të dhënave përfundimtare. Pra, sipas barazimit të rezultateve, punëtorët me aftësi të kufizuar të cilët marrin pagë të njëjtë me të tjerët por që në fakt përballojnë një kosto jetese jo të barabartë për shkak të ngarkesës

që kanë në nevoja personale, del që janë përkundrazi të diskriminuar. Teoria e të drejtave të njeriut sipas së cilës të gjithë qeniet njerëzore kanë vlerë dhe dinjitet të barabartë qëndron në thelbin e konceptit të barazisë. Ashtu siç mund të mos ketë justifikime që për qeniet në vetvete të barabarta të ketë burime të përbashkëta jo të barabarta, kjo teori legjitimon kërkesat për ndarje të barabartë të burimeve materiale, shpirtërore dhe intelektuale.

Sidoqoftë barazia e rezultateve paraqet disa probleme të mprehta. Së pari ky parim nxjerr një varg përgjegjësish. Kush përgjigjet për përmbushjen e këtyre nevojave? Është sektori shtetëror apo ai privat? Së dyti, barazia e rezultateve mund të kërkojë një shtet të fortë të mirëqenies e cila mund të ndërhyjë me ideologjinë e sistemit të tregut të lirë. Në të njëjtën kohë barazia e rezultateve në vetvete mund të përjetësojë padrejtësi, sepse përqendrohet më tepër në rezultatet se sa në trajtimin. Arsimimi i veçuar për studentët me aftësi të kufizuar për shembull mund të konsiderohet legjitim nëse këto shkolla të posaçme për studentët me aftësi të kufizuar sigurojnë të njëjtat mundësi arsimore dhe diplomimi që ekzistojnë në shkollat e rregullta. Për ta thënë troç, nëse ne pranojmë barazinë e rezultateve, si mënyrën e vetme të konceptimit të termit të barazisë, integrimi i studentëve me aftësi të kufizuar nëpër shkolla të rregullta do të mund të shikohesh si një objektiv i paligjshëm. Mënyra e tretë për të konsideruar barazinë si shans i barabartë, është më pak e ngurtë se sa dy konceptimet e tjera në të cilat për të ofruar shanse të barabarta nuk arrihen të sigurohen rezultate të barabarta. E parë nga ky këndvështrim shansi i barabartë përputhet më shumë me ekonominë e tregut. Kjo gjë përkon me historinë e diskriminimit të grupit dhe nxjerr në pah format klasike dhe tradicionale të diskriminimit. Teza e shanseve të barabarta i njeh si barrierat e përsëritshme po ashtu edhe ato strukturale si pengesa në përfshirje: nëse veprimet e përsëritshme janë baza për diskriminim atëherë fakti i aftësisë së kufizuar duhet të injorohet, veçse aftësia e kufizuar mund të merret në konsideratë atje ku normat mjedisore dhe sociale veprojnë si pengesa ndaj mundësive të mirëfillta dhe përfshirjes. Ky aspekti i fundit i shansit të barabartë është i përmbledhur në termin "sistemim i arsyeshëm" u vu në jetë në Shtetet e Bashkuara në vitet 1970. Qysh atëherë ideja është miratuar në mbarë botën, edhe pse në disa vende është modifikuar. Koncepti i shanseve të barabarta aktualisht aplikohet më së shpeshti në legjislacionin modern të aftësisë së kufizuar. Një arsye për këtë mund të jetë fakti që koncepti i barazisë është në përputhje me synimet afatgjata të ekonomisë të tregut të lirë, e cila tani është modeli ekonomik global. Qysh kur legjislacioni i të drejtave civile ofron mundësi të barabarta tek grupet apo minoritetet pak të përfaqësuara, ai i hap dyert për ata që nuk kanë qenë në gjendje të marrin pjesë domethënëse në treg, dhe në këtë mënyrë shton arkën e përbashkët të konsumatorëve po ashtu edhe të prodhuesve. Megjithatë, në mungesë të legjislacionit të mos-diskriminimit do të ketë gjithmonë instanca nëpërmjet të cilave veprimtaria e individëve të vet interesuar në tregun

e lirë do të prodhonte rezultate të pakënaqshme për personat me aftësi të kufizuar qoftë individualisht po ashtu edhe në grup. Edhe pse koncepti i shanseve të barabarta punon për të gjithë në lëmin e tregut të lirë, ai ka gjithashtu potencialin për të ndryshuar gradualisht nocionin e tregut kapitalist. Kjo mundësi e fundit mund të shpjegojë se pse ata të cilët nuk kanë qenë në të kaluarën përfitues të ekonomisë së tregut, përkrahin modelin e ndërmjetëm të barazisë.

3. Një proces reformash me shumë shtresa: Zhvillimet Kombëtare dhe Rajonale.

Procesi reformues në ligjshmërinë e aftësisë së kufizuar po vazhdon në mbarë botën. Shtetet e Bashkuara dhe Kanadaja ishin vendet e para që miratuan ligje kundër-diskriminuese dhe ligje të tjera të drejtave të njeriut për personat me aftësi të kufizuar, duke filluar qysh me daljen e dispozitave të barazisë të fushave të ndryshme në vitet 1970 të ndjekura më pas me ligjet më shumë gjithëpërfshirëse të viteve 1990. Veçanërisht vitet 1990 përbënë një dekadë suksesi për sa i përket ligjit të aftësisë së kufizuar; gjatë kësaj periudhe më shumë se 40 vende nxorën në pah ligjin e aftësisë së kufizuar. Dolën ligje të reja mbi barazinë me personat me aftësi të kufizuar në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. Sot ne kemi instrumente ndërkombëtare të detyrueshme ose jo që trajtojnë të drejtat e njeriut, të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara që shumë qartë mbrojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuar. Në nivel rajonal, Organizata e Shteteve Amerikane (OAS) dhe Bashkimi Evropian (EU) kanë kaluar ligje të fuqishme barazie mbi aftësinë e kufizuar. OAS është organizata e parë në rang mbarëqeveritar që ka arritur një marrëveshje të detyrueshme mbi të drejtat e njeriut me aftësi të kufizuar. Në vitin 1999, u miratua Konventa Mbarë-Amerikane për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Personave me Aftësi të Kufizuar (IACPWD). Ndonëse kjo konventë nuk i përkushtohet të drejtave individuale prapëseprapë ajo është marrëveshja e parë që e trajton aftësinë e kufizuar nën spektrin e diskriminimit.

Lëvizjet kombëtare mbi të drejtat e aftësisë së kufizuar, që me sa duket kanë qenë të afta për të mësuar shpejt prej njëra tjetrës po ashtu edhe për të bashkëpunuar midis tyre në rang ndërkombëtar, kanë qenë një forcë e madhe lëvizëse në funksion të ndryshimeve të mësipërme ligjore.

B. Të Drejtat Ndërkombëtare të Njeriut dhe Aftësia e Kufizuar: Ndryshime brenda Makinerisë së të Drejtave të Njeriut në Kombet e Bashkuara.

1. Zhvillimet e Politikave të Ligjshmërisë së Paqëndrueshme.

Edhe pse duke qenë një prej grupeve më të mëdha të pakicave në botë, e cila përllongaritet se ka rreth 600 milion persona (prej të cilëve në vendet e zhvilluara dy ndër tre veta), njerëzit me aftësi të kufizuar më tepër janë të injoruar gjatë tre dekadave të para të ekzistencës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Hartuesit e Projekt/ligjeve Ndërkombëtare mbi të Drejtat e Njeriut nuk parapanë personat me aftësi të kufizuar si një grup i veçantë që rrezikohesh për dhunimin e të drejtave të njeriut. Asnjë prej dispozitave të barazisë të ndonjë prej tri instrumenteve duke përfshirë këtu Projekt/ligjin (Deklarata Universale mbi të Drejtat e Njeriut (1948), Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike (1966) (ICCPR), dhe Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (1966) (ICESCR)) nuk e përmendin aftësinë e kufizuar si një kategori për tu mbrojtur. Nëse nëpër këto dokumente është ngritur aftësia e kufizuar si një problem, kjo është trajtuar vetëm si një politikë e ndihmës sociale dhe e mbulimit shëndetësor.

Vetëm në vitet 1970, me shpalljen e Deklaratës për të Drejtat e Personave me Vonesa Mendore (1971) dhe të Deklaratës mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizua (1975), këta u bënë subjekte të qarta të të drejtave të njeriut. Edhe të parapara kështu prapëseprapë, këto instrumente të hershme reflektojnë një nocion të aftësisë së kufizuar që bie brenda në modelin mjekësor sipas të cilit personat me aftësi të kufizuar shihen kryesisht si individë me probleme mjekësore që duhen siguruar me shërbime të veçanta sociale dhe institucionale përkatëse.

Atëherë gjatë kësaj kohe u bë e detyrueshme që Asambleja e Përgjithshme të pohonte në mënyrë të prerë se personat me aftësi të kufizuar janë të futur brenda një kategorie të "një statusi tjetër" e cila përfshihet në dispozitat e barazisë që gjenden në projektligjet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Gjatë viteve 1970 - 1980, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi një numër rezolutash që përfundimisht çuan në vitin 1982 në Programin Botëror të Veprimit ndaj Personave me Aftësi të Kufizuar (WPA), dhe në instrumentin udhëzues të Kombeve të Bashkuara për Personat me Aftësi të Kufizuar gjatë dhjetëvjeçarit 1982-1993

Dy synimet e para të WPA-së, pra parandalimi dhe rehabilitimi, pasqyruan një përjasje më shumë tradicionale karshi ligjshmërisë dhe politikave, por synimi i tretë, barazimi i shanseve, e çon ndryshimin në nivele ndërkombëtare.

"Barazimi i Shanseve" u përkufizua si:

Procesi nëpërmjet të cilit sistemi i përgjithshëm i shoqërisë si p.sh. mjedisi fizik dhe kulturor, strehimi dhe transporti, shërbimet sociale dhe shëndetësore, mundësimet arsimore dhe të punësimit, jeta kulturore dhe sociale, duke përfshirë këtu dhe ambientet sportive dhe të dëfrimit, vihen në dispozicion për të gjithë. Gjatë këtij dhjetëvjeçari, politikat dhe ligjshmëria e komponentit mbi barazinë e të drejtave tek aftësia e kufizuar u bënë objektivi kryesor i lëvizjes për ndërkombëtarizimin e të drejtave të aftësisë së kufizuar. Ndikime të tjera të mëdha që ndihmuan në zhvendosjen e tezave të aftësisë së kufizuar nga modeli mjekësor në atë të të drejtave të njeriut ishin dy raporte tematike, njëra për të drejtat e njeriut në fushën e shëndetit mendor dhe tjetra për dhunimin e të drejtave të njeriut ndaj personave me aftësi të kufizuar; të dy këto raporte të përgatitura nga Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut. Këto raporte ishin fillimet e njohjes së aftësisë së kufizuar në kuadrin e të drejtave të njeriut nga Kombet e Bashkuara, brenda kuadrit të së cilit, personat me aftësi të kufizuar të shiheshin tashmë jo vetëm si përfitues bamirësie por edhe si subjekte të cilëve mund tu dhunoheshin të drejtat e njeriut. Njëri prej raporteve rezultoi një instrument për mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuar jo i detyrueshëm për tu zbatuar nga institucionet, ndërsa rezultatet e raportit tjetër ishin të përcipta. Nuk u ndërморën aktivitete të rëndësishme për ndjekje në vazhdim nën kujdesin e Komisionit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut. U aprovuan standarde dhe udhëzime të tjera të rëndësishme gjatë dhjetëvjeçarit, por marrëveshje për një traktat të detyrueshëm në mbrojtje të të drejtave të njeriut ndaj personave me aftësi të kufizuar nuk u mbështet nga shumica e Komitetit të Tretë të Asamblesë së Përgjithshme si në vitin 1987 ashtu edhe në 1989, vite në të cilat përkatësisht Italia dhe Suedia e rritën mundësitë e arritjes së një marrëveshje të tillë. Si një alternativë kompensatore, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi përfundimisht në vitin 1993, Rregullat Standarde për Barazimin e Shanseve për Personat me Aftësi të Kufizuar

Rregullat Standarde të përpiluara vendosmërisht nga WPA ku në të cilat theksohet qartazi barazia e plotë, tashmë përkufizohet si më poshtë vijon:

Parimi i të drejtave të barabarta thotë se nevojat e secilit individ janë të një rëndësie të barabartë, dhe se këto nevoja duhet të bëhen bazë për planifikimet që bën shoqëria dhe se të gjithë burimet e shoqërisë si për fuqi punëtore apo intelektuale duhet ti sigurojnë çdo individ shanse të barabarta për pjesëmarrje në punësim. Personat me aftësi të kufizuar janë anëtarë të denjë të shoqërisë dhe kanë të drejtë për të qëndruar brenda komuniteteve të tyre vendore. Ata duhet të gjejnë mbështetje dhe kanë nevojë të përfshihen brenda strukturave normale të arsimit, shëndetësisë, punësimit dhe të shërbimeve sociale. Në kontrast me instrumentet e tjera ndërkombëtare jo të detyrueshme të aftësisë së kufizuar, këto rregulla standarde parashikojnë pasjen e një Raportuesi të Posaçëm dhe të një grupi specialistësh të cilët kanë mandatin për të promovuar dhe monitoruar zbatimin e rregullave. Grupi i

specialistëve përbëhet nga 10 përfaqësues nga 6 organizatat më të mëdha jo qeveritare ndërkombëtare të fushës së aftësisë së kufizuar. Raportet e tyre pasqyrojnë një orientim të qartë i të drejtave të njeriut përkundrejt monitorimit, edhe pse grupi i monitorimit është vënë në dispozicion të Komisionit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Social i cili më drejt do të ishte nën kujdesin e Komisionit për të Drejtat e Njeriut.

2. Zhvillime të Vështira të Ligjshmërisë: Mbrojtja sipas Instrumenteve të Përgjithshme të të Drejtave të Njeriut

Organizatat jo qeveritare që merren me aftësinë e kufizuar kanë pasur tradicionalisht një ndikim në rritje për sa i përket mënyrës së interpretimit dhe zbatimit të normave të të drejtave të njeriut po ashtu edhe për sa i përket hartimit të instrumenteve moderne të të drejtave të njeriut. Ndonëse aftësia e kufizuar ishte një kategori e harruar atëherë kur u hartuan ICCPR dhe ICESCR, këto traktate tashmë interpretohen në mënyrën për të mbështetur të drejtat e njeriut tek personat me aftësi të kufizuar. Komenti i Përgjithshëm Nr. 18 i ICCPR-së, e cila merret me të drejtën e barazisë (ICCPR, Art. 25), e refuzon qartazi konceptin e barazisë zyrtare sipas kontekstit të të drejtave të njeriut. Ky koment pohon se trajtimi i barabartë nuk nënkupton gjithmonë trajtimin e njëjtë dhe se detyra e shteteve është ndërmarrja e hapave për të shmangur kushtet që çojnë në diskriminim. Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore shkoi edhe më tej duke miratuar një koment të përgjithshëm mbi atë se si duhet interpretuar dhe zbatuar ICESCR -ja në lidhje me personat me aftësi të kufizuar. Komenti i Përgjithshëm Nr. 5, sipas së cilës komiteti i aprovuar në vitin 1994, është deri më sot i vetmi dokument ligjor i Kombeve të Bashkuara që gjerësisht përcakton raportet e aftësisë së kufizuar në lidhje me diskriminimin:

Si de jure po ashtu edhe de facto, diskriminimi ndaj personave me aftësi të kufizuar ka një histori të gjatë dhe merr forma të ndryshme. Ky lloj diskriminimi shkon nga diskriminimi i papëlqyeshëm i tillë si mohimi i shanseve të arsimimit e deri tek format më “të mprehta” të diskriminimit të tilla si veçimi dhe izolimi nëpërmjet vendosjes së barrierave sociale dhe fizike. Në funksion të Konventës, “aftësia e kufizuar-bazuar në diskriminim” mund të përkufizohet si përfshirja e dallimit, përjashtimit, kufizimit ose preferencës, ose mohimi i sistemimit të arsyeshëm bazuar në aftësinë fizike e cila ka efektin e zhvleftësimit ose të cungimit të njohjes, zotërimit apo ushtrimit të të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore.

Komenti gjithashtu thekson qëndrimin që duhet të mbajtur ndaj respektimit të të drejtave të njeriut ndaj aftësisë së kufizuar me anë të shtrimit të një kërkesë të qartë për legjislacionin anti-diskriminues:

Me qëllim përmirësimin e diskriminimit të mëparshëm dhe të tanishëm, dhe për të mos lejuar një diskriminim në të ardhmen, do të ishte e domosdoshme

të hartohet një legjislacion gjithëpërfshirës anti-diskriminues në pothuajse të gjitha shtetet pjesëmarrëse.

Në mënyrë të ngjashme, Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit të Grave ka miratuar Rekomandime të Përgjithshme që u kërkojnë Palëve Shtetërore dhënien informacioneve të posaçme mbi statusin e grave me aftësi të kufizuar, dhe ka ngritur çështjen e dhënies së rekomandimeve të tjera plotësuese për aftësinë së kufizuar.

Traktatet më të fundit e të drejtave të njeriut, të tilla si Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat e Fëmijëve, përmbajnë gjithashtu dispozita të posaçme në lidhje me personat me aftësi të kufizuar duke reflektuar me këtë rast një qasje edhe më të fortë ndaj të drejtave të njeriut.

3. Një Rend i Ri Dite: Drejt një Traktati të Ri ndaj Aftësisë së Kufizuar?

Mungesa e një ligji të nivelit botëror me efekte të detyrueshme për personat me aftësi të kufizuar fizike, ka bërë që aktivistët dhe studiuesit e këtyre të drejtave, të ngulmojnë për miratimin e një konvente të re për eliminimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuar.

Në fakt përkrashtimet e kësaj ideje pranojnë që Shtetet janë të gatshme të aprovojnë një marrëveshje të re mbi të drejtat e njeriut. Ata nxjerrin në pah shqetësimin që një bollëk aktual traktatesh mbi të drejtat e njeriut ka krijuar një " mbingarkesë lodhëse" të Shteteve Anëtare duke cenuar kështu përmbushjen e detyrimeve ekzistuese.

Sidoqoftë, mund të rendisim së paku 6 argumente kryesore që janë në favor të një traktati të ri mbi aftësinë e kufizuar. Së pari, arritja e një traktati të ri do të kishte qenë një përparim i rëndësishëm në krijimin e një ligji të detyrueshëm dhe në marrjen e masave të përshtatshme në parandalimin e diskriminimit të aftësisë së kufizuar. Në fakt standardet e tanishme ndërkombëtare paraqesin regjimin e një " tigris pa dhembë" në këtë kohë kur flitet shumë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Së dyti, një traktat i ri do të legjitimonte pretendimet në drejtim të shtimit të vëmendjes dhe rritjes së kontributeve në sektorin e të drejtave të njeriut të Kombeve të Bashkuara, të qeverive dhe organizatave të tjera. Së treti, një traktat për të drejtat e aftësisë së kufizuar do të ofronte shanse si për shtesat e veçanta në të drejtat e njeriut tek njerëzit me aftësi të kufizuar po ashtu edhe në drejtim të kapjes së aspekteve të pa njohura më parë, të tilla si p.sh. të së drejtës për tu konsideruar i dallueshëm nga të tjerët. Në dritën e zhvillimeve të fundit në fushën e Bioetikës dhe të Biomjekësisë, që lidhen me zbulimin e " trajtimit" të duhur sipas diferencave fiziologjike, del që e drejta për tu konsideruar i dallueshëm nga të tjerët mund të jetë po aq themelore sa edhe e vetë e drejta e barazisë për personat me aftësi të kufizuar. Së katërti, një traktat i tillë do të i kishte dhënë organizatave të të drejtave, një mjet të veçantë për promovimin e të drejtave të njeriut për personat me aftësi të kufizuar sipas konteksteve vendore dhe qeverive

përkatëse. Së pesti, një traktat i tillë do të shërbente si mjet nxitës drejt fuqizimit në rang botëror të lëvizjes së të drejtave të njeriut tek njerëzit me aftësi të kufizuar. Dhe së fundi, miratimi i këtij traktati do të vendoste aftësinë e kufizuar në programet e rendit të ditës të Kombeve të Bashkuara që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut.

Pra, një hap i tillë do ta theksonte idenë që aftësia e kufizuar është së pari çështje e të drejtave të njeriut dhe pastaj një problem i mirëqenies sociale.

Për këto arsye, Kombet e Bashkuara, shtetet anëtare dhe organizatat që merren me të drejtat e njerëzve me aftësi të kufizuar duhet të nisnin procesin e miratimit të një traktati ndërkombëtar që do të ketë të bëjë posaçërisht me të drejtat njerëzore të personave me aftësi të kufizuara.

Një rezolutë për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara është shtruar tradicionalisht në mbledhjet e Komisionit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut në Gjenevë.

Irlanda, ka marrë përsipër rolin kryesor në sponsorizimin e kësaj rezolute para pak vitesh nga Filipinet. Gjatë sesionit të 56 të Komisionit në Mars-Prill të vitit 2000, Irlanda paraqiti një rezolutë ku ndër të tjera bëhej thirrje për hartimin e një konvente ndërkombëtare dhe kryesisht lexohet se:

30. Konsideron se hapi tjetër logjik përpara drejt zotërimit efektiv të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara kërkon që Komisioni për Zhvillim Social duhet të shqyrtojë si çështje fundja edhe urgjente, përpilimin e një konvente ndërkombëtare për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar, forma e përmbajtja e së cilës kërkon kontributin dhe propozimet e palëve të interesuara duke përfshirë këtu veçanërisht grupin e ekspertëve [që do të ngrihesh për të ndihmuar Raportuesit e OKB-së duke respektuar Rregullat Standarde të OKB-së].

Irlanda mori një mbështetje të madhe në sesion, por jo të mjaftueshme për të siguruar kalimin e kësaj rezolute në të cilin duhet të ruhesh i paprekur paragrafi 30. Megjithatë, rezoluta do të shtrohet përsëri në vitin 2002 dhe Irlanda ka sinjalizuar se është rënë dakord për marrjen përsëri në shqyrtim të kësaj konvente.

C. Procesi Reformues në Ligjshmërinë Krahasuese

Gjatë dekadave të fundit, në nivel vendor, ligjshmëria mbi aftësinë e kufizuar në shumë vende të botës ka pësuar ndryshime të rëndësishme. Më shumë se 40 vende nga të 189 Shtetet Anëtare të Kombeve të Bashkuara tashmë kanë miratuar disa lloj ligjesh kundër-diskriminuese për personat me aftësi të kufizuara.

Krahasimi dhe analizimi i këtyre ligjeve në tërësi është një nismë e vështirë për disa arsye. Së pari, jo vetëm se këto vende kanë prejardhje të ndryshme historike, ekonomike dhe politike, porse ata aderojnë në sisteme të ndryshme

ligjore të kodit të zakonshëm apo civil. Së dyti, ligji mbi aftësinë e kufizuar si një degë e hulumtimit ligjor është në zhvillim e sipër në mjaft vende të botës. Kështu që, si literaturat e ligjshmërisë mbi aftësinë e kufizuar po ashtu edhe ato të studimeve krahasuese janë akoma të rralla. Shumica e literaturës krahasuese ligjore të botuar është përqendruar në vendet evropiane.

1. Modeli: Përdorimi i ADA-s dhe Rregullat Standarde si Modele Tërësore Ligjore.

Edhe pse me këto rezerva, prapëseprapë akoma mund të bëhen ca vërejtje në lidhje me ligjet e kundër-diskriminimit për personat me aftësi të kufizuar të mbarë botës. Shumica e këtyre ligjeve kundër diskriminimit u dekretuan gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, ndërsa në disa vende të tjera u miratuan qysh në vitet 80. Shtetet e Bashkuara të Amerikës ishin jashtëzakonisht herët në miratimin e Aktit të Rehabilitimit të vitit 1973 si një prej legjislacioneve të para kundër -diskriminuese për personat me aftësi të kufizuar. Ky ligj amerikan zanafillë e dobishme për evolucionin e ligjit të diskriminimit për aftësinë e kufizuar në shumë vende. Akti Amerikan i Aftësisë së Kufizuar (ADA) veçanërisht ai i vitit 1990 pati një efekt aq të madh në zhvillimet ligjore në arenën ndërkombëtare sa që njëri u tundua për të thënë se ndikimi i këtij ligji dominoi në përgjithësi tërë ligjshmëritë vendore. Një tjetër nxitje për miratimin e ligjeve diskriminuese për aftësinë e kufizuar erdhi prej Kombeve të Bashkuara me daljen e Rregullave Standarde për Barazimin e Shanseve në vitin 1993 (Rregullat Standarde) në paragrafin 15 të së cilave thuhet:

Shtetet janë përgjegjës për të krijuar bazën ligjore të masave që duhet të ndërmerren drejt arritjes së objektivave për pjesëmarrje të plotë dhe për barazi të personave me aftësi të kufizuara....Shtetet duhet të sigurojnë që organizatat që merren me personat me aftësi të kufizuara të mund të përfshihen në përpilimin e legjislacionit kombëtar që ka të bëjë me të drejtat e personave me aftësi të kufizuar, si dhe në dhënien në vazhdim të vlerësimeve ndaj këtij legjislacioni.....Çdo dispozitë diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuar duhet të shmanget. Legjislacioni kombëtar duhet të nxjerrë sanksionet e duhura në rastet e shkeljes së parimeve të mos diskriminimit.. . .

Historia e ligjit të diskriminimit të aftësisë së kufizuar vë në dukje se në një numër të caktuar vendesh as ADA po ashtu edhe Rregullat Standarde nuk kanë shërbyer si model për zhvillimet e mëtejshme të legjislacioneve kombëtare. Për sa i përket konstruktit ligjor të Rregullave Standarde, konstatojmë se ky model është një shembull interesant i ndikimit ndërkombëtar që do të kishte ky ligj i butë nëse do të merresh seriozisht prej qeverive të vendeve të ndryshme. Fakti që qeveritë e morën seriozisht aftësinë e kufizuar si një çështje e diskriminimit dëshmon se po lëvizin gjërat për trajtimin e aftësisë së kufizuar të çdo vendi. Ligjet mbi kundër-diskriminimin e personave me aftësi të kufizuar janë rezultat i përpjekjeve përcaktuese të një lëvizje të or-

ganizuar sociale të personave me aftësi të kufizuar dhe të avokatëve të tyre në mbarë botën. Personat me aftësi të kufizuara kanë kërkuar të drejtat e njeriut në vend të ligjeve që shprehnin ndihmë sociale duke treguar pjekuri dhe reflektim të gjallë ndaj politikave kombëtare dhe ndërkombëtare të aftësisë së kufizuar.

2. Një aspekt tematik: Ligji mbi Aftësinë e Kufizuar si një ligj për mëshirë në Evropë

Ligji i aftësisë së kufizuar para epokës së kundër – diskriminimit shpesh ka çuar në ndërtimin dhe përjetësimin e një modeli mjekësor të aftësisë së kufizuar. Historia evropiane e aftësisë së kufizuar e paraqet më së miri këtë fakt. Në Evropë, ligjshmëria moderne e aftësisë së kufizuar nëpër nivele kombëtare dallohet të ketë kaluar në tre periudha.

Periudha e parë nis pas Luftës së Parë Botërore, atëherë kur legjislacioni i ndihmave sociale për shkak të veteranëve të luftës ishte futur në shumë vende evropiane. Këto ligje të ndihmës sociale pasqyronin detyrimet që kishte shoqëria për të kompensuar veteranët e luftës nëpërmjet pensioneve të invaliditetit, përfitimeve rehabilituese dhe kuotave të punësimit. Periudha e dytë e ligjshmërisë së aftësisë së kufizuar filloi në vitet 60 me një legjislacion të zgjeruar të ndihmës sociale që mbulonte të gjithë njerëzit me aftësi të kufizuar dhe duke u përqendruar në disa vende veçanërisht tek fëmijët. Ky ligj i ndihmës sociale ndihmoi një grup akoma më të zgjeruar invalidësh. Ndërsa invalidët veteranë gjenden akoma (dhe vazhdojnë të jenë) të privilegjuar, dhe në këtë periudhë ligji mbi aftësinë fizike nuk u jepte rëndësi shkakut të dëmtimit. Qëllimi tashmë ishte që të rehabilitoheshin njerëz me aftësi të kufizuar pavarësisht nga shkakut i dëmtimit. Ligjet ishin miratuar në fusha të tilla si arsimimi i posaçëm, përfitime të rehabilitimit mjekësor dhe profesional, kuota punësimi dhe shërbime të përkujdesit institucional. Ligjshmëria e aftësisë së kufizuar si në periudhën e parë po ashtu edhe në atë të dytë pasqyronte modelin mjekësor të aftësisë të kufizuar. Personat me aftësi të kufizuar përfitonin ndihma sociale për shkak se aftësia e tyre e kufizuar shihesh si një problem mjekësor gjë që e len individin të paaftë për të përballuar të gjitha ose shumicën e aktiviteteve të jetës. Fëmijët me aftësi të kufizuar kishin të drejtë për tu arsimuar, por në shkollë të veçuara vetëm për ata me aftësi të kufizuar. Personat me aftësi të kufizuar përfitonin rehabilitim mjekësor dhe profesional por të administruar dhe nën kontrollin e ekspertëve mjekësor të rehabilitimit. Pra, ndonëse personat me aftësi të kufizuar trajtohen si subjekte me të drejtat e ndihmës sociale, këto të drejta u janë dhënë me çmimin e përjashtimit dhe të humbjes së të drejtës për vetëvendosje. Edhe ata ligje që tekstualisht citoheshin se kishin për qëllim integrimin e personave me aftësi të kufizuar në tregun e hapur të punës janë bazuar në modelin mjekësor. Kuotat e punësimit që detyronin

punëdhënësit për të marrë në punë një përqindje të caktuar njerëzish me aftësi të kufizuara u futën sepse individët me aftësi të kufizuara shiheshin si të paafte për të konkurruar sipas meritës në vendet e punës. Këto skema tradicionale punësimi nuk ndërtoheshin në bazë të teorisë tashmë të njohur të barazisë, as sipas konceptit të mos diskriminimit sistematik që gjallëron programe bindëse veprimi brenda një gare bashkëkohore ose një konteksti gjinor.

Pra, këto dy periudhat e para të ligjshmërisë së aftësisë së kufizuar ndihmuan për të ndërtuar dhe për të përjetësuar modelin mjekësor të aftësisë së kufizuar. Personave me aftësi të kufizuara iu mohua statusi i qytetarit nëpërmjet sistemimit të tyre nën komfortin e ligjit të ndihmës sociale. Një rast i ndodhur në Gjermani i jep një figurë më të qartë këtij procesi. Në vitin 1992 gjykata e rrethit të Flensburgut vendosi që turistët e zakonshëm të kishin të drejtë për të përfituar një ulje të çmimit të tyre të udhëtimit nëse ata përballohen me turistët me aftësi të kufizuara në hotelin e tyre.

Një çift me dy fëmijë rezervoi një paketë të plotë pushimesh me anë të një agjencie gjermane udhëtimi, dhe më pas ngriti një padi kundër agjencisë së udhëtimeve për shkak se dhjetë turistë me aftësi të kufizuara kishin kaluar pushimet e tyre në të njëjtin hotel me familjen. Në bazë të analizës së fakteve gjykata parashtrroi këtë deklaratë:

Për një javë rresht, hoteli u zu nga një grup prej dhjetë personash të ndryshëm me aftësi të kufizuara disa prej të cilëve qëndronin në karroca invalidësh. Këta persona me aftësi të kufizuara hanin në sallën e zakonshme të ngrënies të hotelit. Shumë prej tyre nuk mundnin të hanin si të tjerët në mënyrë normale sepse mbanin edhe grykashka në formë përparëseje që lidheshin përqark qafës. Ata ushqeheshin duke përdorur instrumente, që ndër të tjera ngjasonin me pamjen e shiringës. Kjo skenë përshtoste dhe dëmtonte komoditetin e çiftit paditës dhe të fëmijëve të tyre. Ata nuk mund ti shmangeshin kësaj situatë sepse ishin të detyruar të hanin në të njëjtën orë dhe në të njëjtën sallë ngrënie të hotelit sepse edhe vetë kjo sallë faktikisht kishte përmasa të vogla.

Pas kësaj gjykata bëri gjykimin e mëposhtëm ligjor:

Paditësit kanë të drejtë të marrin zbritje të çmimit të udhëtimit.....Shërbimi i kryer nga i pandehuri ishte jo i përshtatshëm....Pushimet e premtuara nuk u kryen ashtu siç duhej. Paditësit së bashku me fëmijët e tyre të vegjël nuk mundën të shijojnë ngrënien e ushqimeve në mënyrë të patrazuar. Ata në çdo vakt ngrënie nuk mund ti shmangeshin shikimit tek personat me aftësi të kufizuara për shkak të ambientit fizik shumë të vogël kështu që prej kësaj nuk arrinin ta shijonin siç duhet ngrënien e ushqimeve dhe për më tepër vazhdimisht ishin të detyruar të kujtonin efektin bezdisësh të vuajtjes njerëzore. Zakonisht, këto përjetime nuk përngjanin me rrjedhat normale të një periudhe pushimi. Nuk ka pse pushuesit të përjetojnë eksperiencë të tilla.

Nuk është konditë që një pushues domosdoshmërisht të tregohet altruist apo të ketë standarde të larta etike. Veçanërisht, në një hotel s'ka pse të cenohet normaliteti i ngrënies së ushqimit e cila është pjesë përbërëse e efektit relaksues të një pushimi. Reklamat e organizatorëve të këtyre pushimeve duhet të përkohet me të gjitha këto. Edhe pse ky vendim u kritikua së tepërmi në Gjermani, prapëseprapë vendime të tilla nuk janë të jashtëzakonshme për jurisprudencën gjermane. Në këtë rast personat me aftësi të kufizuar nuk shihen si qytetarë por si objekte. Ngjarje të tilla konsiderohen të së njëjtës kategori me WC-të e thyera apo me plazhet e pista – fenomene që me të drejtë në Gjermani konsiderohen shkelje të së drejtës së garantimit të kushteve të pushimit. Sipas këtij konceptimi, qytetarët e zakonshëm nuk kanë pse të ballafaqohen me personat me aftësi të kufizuar. Një perceptim i tillë ligjor mund të ketë zanafillat e saj gjatë historisë së Gjermanisë atëherë kur në periudhën e regjimit Nacional Socialist personat me aftësi të kufizuar përjashtoheshin dhe eliminoheshin.

Konstruksioni ligjor i aftësisë së kufizuar si çështje e ndihmës sociale dhe mëshiruese shmang trajtimin e kësaj çështje si e drejtë e njeriut.

Për sa i përket trajtimit të të drejtave të njeriut të personave me aftësi të kufizuara, në vendimin e Flensburg, gjykata deklaroi:

Në kundërshtim me pikëpamjen e të pandehurit, dinjiteti njerëzor i personave me aftësi të kufizuar, nuk konsiderohet i shkelur kur kërkohet nga dhënia e garancisë së pushimeve. Për më tepër në këtë rast nuk mund të flitet as për një rast përjashtimi të personave me aftësi të kufizuara. Këto procedura nuk prekin personat me aftësi të kufizuar as në mënyrë të drejtpërdrejtë as në mënyrë të tërthortë. Ky rast nuk ka të bëjë me të drejtat e tyre, por lidhet me gjetjen e përgjigjes së pyetjes se kush palë do të mbajë përgjegjësi për rrethanat që çuan në dëmtimin e pushimeve të paditësit. Veprime të tilla nuk prekin kënaqësinë e personave me aftësi të kufizuara, por këto janë mbingarkesa vetëm për paditësin. Mohimi i statusit të qytetarit për personat me aftësi të kufizuar nuk vjen nga legjislacioni i ndihmës ekonomike, por nga qenia e këtij grupi në një disavantazh dhe veçim të natyrshëm gjë që të bën të besosh se personat me aftësi të kufizuara janë disi të pabarabartë dhe me më pak vlera si qenie njerëzore dhe si anëtarë të shoqërisë.

Edhe në shtetet e pasura si Gjermania, të cilët i kanë mundësitë për të mbështetur gjerësisht një sistem social të përsosur të ndihmës ekonomike, prapëseprapë edhe mirëqenia e lartë mund të ketë një efekt frenues dhe ngadalësues në zhvillimin e politikave të aftësisë së kufizuar bazuar në perspektivat e së drejtës.

Periudha e tretë e ligjshmërisë së aftësisë së kufizuar nisi në vitet 90 atëherë kur disa vende Evropiane miratuan legjislacionin diskriminues për njerëzit me aftësi të kufizuar. Me këto ligje të reja, njerëzit me aftësi të kufizuar më së fundi fituan statusin e qytetarisë së plotë, sepse tezat u zhvendosen

nga përqendrimi në dëmtimin individual në atë të njohjes së përjashtimit shoqëror. Një element kyç i legjislacionit të diskriminimit të aftësisë së kufizuar është të kuptuarit se përjashtimi dhe veçimi i njerëzve me aftësi të kufizuara nuk vjen si rezultat i faktit se janë të dëmtuar por më tepër si rezultat i zgjedhjeve të politikave të bazuar në paragjykimet e gabuara për aftësinë e kufizuar.

Me futjen e këtyre ligjeve, diskriminimi më së fundi u njoh si pengesa kryesore për integrimin njerëzve me aftësi të kufizuar. Këto ligje po ashtu edhe ligjet e paraardhëse të aftësisë së kufizuar kanë arritur të miratohen si rezultat i fushatave dhe lobingjeve që bënë personat me aftësi të kufizuar dhe jo se u vendos nga specialistët e rehabilitimit se çfarë ishte më e mira për “sakatët”.

Ligjet e diskriminimit për aftësinë e kufizuar nuk erdhën ashtu pa prituri e pa kujtuar. Më tepër pararendësit e tyre ishin të ashtuquajturat ligjet e integritimit. Gjatë viteve 80 – epoka dhjetëvjeçare e Kombeve të Bashkuara për aftësinë e kufizuar – shumë vende miratuan ligjet themelore të integritimit dhe të deinstitutionalizimit. Vendet Skandinave janë të shquara në integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Italia mori rolin udhëheqës në lëvizjen Evropiane të deinstitutionalizimit me miratimin e Aktit të Reformës Psikiatrike qysh në fillimet e vitit 1978. Këto ligje ishin të rëndësishme se ndihmuan në dënimin e veçimit dhe përjashtimit të personave me aftësi të kufizuar nga shoqëria por këto ligje nuk e cilësuan diskriminimin si shkakun kryesor të përjashtimit dhe të marginalizimit.

3. Një Krahasim tërësor i Ligjeve – Kundër-diskriminuese.

Ligjet që ne analizuam vijnë nga 42 vende të botës, dhe ndryshojnë gjerësisht në lidhje me fushëveprimin, konceptin e diskriminimit dhe të barazisë, të asaj se kush po mbrohet, metodën e zbatimit etj. Disa prej ligjeve përcaktojnë aftësinë e kufizuar në bazë të diskriminimit dhe qartazi ndalojnë aktet diskriminuese, ndërsa disa ligjet e tjera ua lënë gjykatave ose trupave monitoruese interpretimin e diskriminimit. Disa ligje e mbështesin parimin e barazisë, por nuk japin një ide të qartë mbi atë se çfarë nevojitet për tu ndryshuar në shoqëri për të arritur këtë objektiv. Ndonëse probleme të kësaj natyre shpesh janë të trajtuara në rregullore dhe akte të veçanta prapëseprapë gjuha dhe mënyra e strukturimit të tyre ende kërkojnë qartësime të mëtejshme ligjore. Disa ligje të japin përshtypjen se edhe pse përmbajnë një gjuhë disi kundër-diskriminuese prapëseprapë në thelb ata janë ligje të mirëqenies sociale, të nxitjes së programeve përkujdesesh të cilat nuk kanë domosdoshmëri për qëllim plotësimin e barazisë sociale dhe të integritimit të personave me aftësi të kufizuar. Sidoqoftë, është e rëndësishme të kujtohet se ligji i kundër-diskriminimit për aftësinë e kufizuar është një zhvillim i ri në politikat e aftësisë së kufizuar në mbarë botën.

Këto ligje manifestojnë një zhvendosje të vërtetë bashkëkohore të tezave të aftësisë

së kufizuar nga modeli mjekësor tek ai social. Vetëm thjesht njohja ligjore e faktit që personat me aftësi të kufizuar përbëjnë një kategori të diskriminuar nxjerr në pah faktin tjetër që këta persona janë persona që kanë probleme me të drejtat e njeriut. Disa prej këtyre ligjeve kundër-diskriminuese janë të fuqishme, por të tjerat duken sikur janë tigras pa dhëmbë". Shpesh grupe vendore të aftësisë së kufizuar kanë luftuar shumë fort për ligjet e barazisë, dhe nuk janë kënaqur plotësisht ose aspak me aktet ligjore që më së fundi kanë kaluar legjislatorët e tyre. Historia e ligjit kundër-diskriminues në SHBA na informon në për një gjë se lufta legjislative për barazinë është e gjatë dhe se asnjë ligj tjetër nuk duhet miratuar para se të arrihet qëllimi i mbrojtjes së plotë kundër diskriminimit. Qysh prej orvatjeve të para për të përfshirë në Aktin e të Drejtave Civile në vitin 1964 deri në kalimin e ADA-s në vitin 1990, kanë kaluar disa dhjetëvjeçarë deri atëherë kur më së fundi së paku pesë akte federale të kundër-diskriminimit të aftësisë së kufizuar u kaluan nga Kongresi.

a. Një Larmi e Gjerë Qasjesh të Ndryshme Juridike.

Këto shtete që aktualisht kanë një lloj ligji kundër-diskriminues për aftësinë e kufizuar sot kanë zgjedhur qasje të ndryshme ligjore. Mund të dallohen katër qasje të ndryshme ligjore për miratimin e dispozitave kundër-diskriminuese në mbrojtje të personave me aftësi të kufizuar: (i) ligji penal; (ii) ligji kushtetues; (iii) ligji civil; dhe (iv) ligjet e mirëqenies sociale.

(i) ligji penal

Franca, Finlanda Spanja dhe Luksemburgu ndalojnë diskriminimin përkundërt personave me aftësi të kufizuara në ligjet e tyre penale. Ligji Spanjoll ndalon diskriminimin e personave me aftësi të kufizuar në vendimet për të marrë në punë apo gjatë kohës së kryerjes së punës në aspektin e asaj që ky person me aftësi të kufizuar është apo jo në gjendje për të kryer punën. Luksemburgu dhe Franca nxjerrin të paligjshme ato aktivitete biznesi, furnizim mallrash apo shërbimesh publike që diskriminojnë njerëzit me aftësi të kufizuar në punësimin e tyre. Ndëshkimi është një maksimum dy vjet burgosje ose gjobitje. Disa shtete të tjera që përgjithësisht kanë miratuar qasje ligjesh civile apo sociale për të penguar diskriminimin e njerëzve me aftësi të kufizuar prapëseprapë kanë marrë masa për të vendosur sanksione me karakter të gjerë penal apo administrativ. Për shembull, statuti australian e konsideron nxitjen e diskriminimit si të paligjshëm dhe si një vepër penale e dënueshme me gjashtë muaj burgim ose gjobitje. Viktimizimi i një personi i cili ushtron të drejtën e tij sipas ligjit përkatës është deklaruar si një krim. . Urdhërsa Diskriminuese e Hong Kongut përmban dispozita të tilla si: një person i cili bën sjellje që ngjallin urrejtjen, përgojimin, mospërfilljen, talljen, përbuzjen ndaj personave me aftësi të kufizuar konsiderohet se ka kryer një

vepër penale e cila dënohet me gjobë deri në dy vjet burg. Ligji i Mauricies imponon burgim ose gjobë administrative për disa shkelje të caktuara të rregullave kundër – diskriminuese të atij vendi. Të njëjtën gjë thonë edhe ligjet kundër – diskriminuese të Izraelit, të Filipineve, të Zambias, dhe të Zimbabve

Ndonëse Finlanda dhe Spanja i ka dispozitat anti-diskriminuese në fusha të tjera të sistemit të tyre ligjor, përkundrazi Franca dhe Luksemburgu rregullon diskriminimin e aftësisë së kufizuar vetëm në kodet e tyre penale. Nga kjo del që diskriminimi i aftësisë së kufizuar duhet ndaluar atëherë kur kjo të jetë konsideruar një shkelje penale, e cila anasjelltas kushtëzohet me atë që shkelësi i ligjit të ketë vepruar për qëllime të prapa.

Sidoqoftë, normalisht, diskriminimi i aftësisë së kufizuar shpesh kryhet për qëllime të mira.

Pronari i restorantit mund të mos i shërbejë personave që përdorin karroca invalidësh për faktin se hyrja nuk e lejon që të futet karroca dhe në fakt nuk ka ndërmend të qëndrojë larg personave me aftësi të kufizuar qëllimisht dhe ka gjasa të mos ketë ndjenja armiqësore ndaj tyre. As ai vetë nuk e fut veten tek diskriminuesit. Edhe pse nuk ka evidenca statistikore prapëseprapë duket se ndoshta ligji i diskriminimit të aftësisë së kufizuar rrallë e ka të bazuar ndjekjen penale.

(ii) Duke marrë parasysh Ligjin Konstitucional.

Një numër vendesh kanë dispozita kushtetuese kundër-diskriminuese të cilat në mënyrë të qartë trajtojnë aftësinë e kufizuar. Këto janë: Austria, Brazili, Kanadaja, Finlanda, Fixhi, Gambia, Gana, Gjermania, Malajvia, Zelanda e re, Afrika, Zvicra dhe Uganda. Në këto dispozita përgjithësisht ndalohet diskriminimi ndaj personave me aftësi të kufizuar porse në to nuk përcaktohet saktësisht se çfarë nënkuptohet me diskriminim. Në disa klauzola barazie përmenden forma të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të diskriminimit. Klauzola e barazisë në kushtetutën e Fixhi-t është jashtëzakonisht e zgjeruar me shpjegime të drejtpërdrejta dhe të tërthorta duke thënë se:

Çdo person ka të drejtën e tij për tu ingranuar, pa qenë i paragjykuar dhe i diskriminuar [ndërmjet të tjerash aftësia se kufizuar], në dyqanë, hotele, në shtëpitë me qira, në restorante publike, vende të argëtimit publik, në taksitë dhe vendet e tjera publike.

Gjithashtu edhe kushtetutat e Austrisë, Brazilit, Kanadasë, Gjermanisë, Ganës, Malajzisë, Afrikës së Jugut, Zvicrës dhe Ugandës mundësojnë ose u lënë për detyrë ligjvënësve të ndërmarrin hapa të qëndrueshme për të luftuar diskriminimin ndaj aftësisë së kufizuar. Hapa të qëndrueshme në drejtim të formave të trajtimit preferencial, qoftë në formën e përfitimit të kuotave ose me format e tjera të diskriminimit pozitiv apo krijimit të lehtësirave. Hapa të mëtejshme duhen bërë kundër diskriminimit strukturor, e cila është

pengesa më e madhe në arritjen e shanseve të barabarta për personat me aftësi të kufizuar. Në fushën e punësimit, shumë shtete kanë futur kuota në drejtim të punësimit të njerëzve me aftësi të kufizuar, me detyrimin për të respektuar një përqindje të caktuar në totalin e numrit të përgjithshëm të punonjësve. Kuotat e punësimit ndaj personave me aftësi të kufizuar u futën fillimisht pas Luftës së Dytë Botërore dhe funksionuan si masa të mirëqenies sociale. Ato u bazuan në idenë që personat me aftësi të kufizuar nuk mund të konkurrojnë realisht në jetën e përditshme. Me zgjerimin e lëvizjes për të drejtat civile në drejtim të racës dhe gjinisë, kuotat administrative fituan kuptime të reja për barazinë. Kjo gjë ndikoi në skemat kuotuese të fushës së aftësisë së kufizuar. Në këtë aspekt është interesante të shihet se disa kushtetuta sigurojnë skema në fushën e punësimit ndërsa të tjerat një gjë të tillë e bëjnë në kuadrin e përfaqësimit politik. Për shembull, kushtetuta e Malajvisë parasheh që Senati, i cili është një trupë legjislative, të përfshijë përfaqësues të grupeve të ndryshme të interesit mes tyre edhe grupet e njerëzve me aftësi të kufizuara. Në mënyrë të ngjashme, kushtetuta e Ugandës kërkon që parlamenti të ketë një numër të caktuar përfaqësuesish nga grupi i njerëzve me aftësi të kufizuar. Parlamenti i Ugandës ka pesë vende të rezervuara për përfaqësuesit e bashkësisë së njerëzve me aftësi të kufizuar dhe vlen të përmendet se nga ky grup është edhe kryeministri i këtij vendi (Znj. Florence Nanyiga Sekabiro). Bazuar në disa klauzola të kushtetutës, ligjvënësit e Ugandës kanë kaluar disa akte për të rritur përfaqësimin e personave me aftësi të kufizuara në sferën publike. P. Sh. „Akti i Pushtetit Lokal i vitit 1997, akordon një numër të caktuar vendesh për personat me aftësi të kufizuara në të gjitha nivelet e organeve të zgjedhura politike. Si rezultat i kësaj ka më shumë se 2000 zyrtarë të zgjedhur nga grupi i personave me aftësi të kufizuara në të gjitha nivelet e qeverisjes në rang komune dhe rrethi. Një tjetër karakteristikë interesante e këtyre kushtetutave është përfshirja e aftësisë së kufizuar në zonën e ndaluar për diskriminim nëpërmjet hartimit të projekteve origjinale apo amendamenteve për tu njohur atyre të drejtën për të folur edhe në gjuhën e shenjave. Finlanda Afrika e Jugut dhe Kanadaja ka dispozitat të tilla kushtetuese. Klauzolat kundër-diskriminuese kushtetuese duket se janë më tepër të efektshme se klauzolat kundër-diskriminuese penale në transformimin e shoqërisë. Për derisa në shumicën e vendeve, kushtetuta është ligji më i lartë i një vendi, dispozitat kushtetuese dhe amendamentet marrin një vëmendje më të madhe publike dhe mund të zhvlerësojë një ligj jo kushtetues. Ligjet kushtetuese gjithashtu i hapin rrugë gjyqësorit për të reformuar ligjet mbi aftësinë e kufizuar.

Megjithatë akoma ka shkaqe të ndryshme se përse edhe ligjet kushtetuese që flasin për aftësinë e kufizuar mund të kenë efekte të kufizuara.

Së pari, në varësi të sistemit ligjor, disa prej kushtetutave nuk arrijnë ti japin në mënyrë thelbësore qytetarit me aftësi të kufizuar të drejtën për tu paraqitur në gjyq. Së dyti, e drejta kushtetuese aplikohet vetëm në të ashtuquajturat

ligje vertikale publike. Kjo do të thotë se dispozitat kushtetuese mbrojnë diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara karshi entiteteve kombëtare dhe lokale, por jo karshi punëdhënësve privatë. Së fundmi, dispozitat kushtetuese kanë një konkretizim të pasaktë. As aftësia e kufizuar po ashtu edhe diskriminimi nuk janë të përcaktuara mirë përveçse në ligjin kushtetues të Zelandës së Re. Kjo gjë u lë liri të gjerë veprimi gjykatave dhe vendimet e tyre arrijnë të merren në bazë kulturave të ndryshme interpretuese ligjore.

Për shembull në Gjermani, ku nuk ka histori legjislativ për të drejtat civile, klauzolat kushtetuese kundër-diskriminuese janë bërë si tigra pa dhëmbë nga Gjykata Kushtetuese Federale. Në një rast që i ndodhi në vitin 1996 një vajze që përdorte karrocë invalidi dhe së cilës vazhdimisht i mohohesh frekuentimi i një shkollë të rregullt, Gjykata mori vendim se autoritetet e shkollës nuk dhunuan klauzolat kushtetuese kundër-diskriminuese. Arsyetimi i Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane të kujton rastin e një vendimi të marrë prej më shumë se 150 vjet më parë nga Gjykata e Lartë e SHBA-së që mbështeste ndarjen raciale nëpër shkolla. Ashtu si në Plessy kundër Ferguson në 1886, Gjykata Gjermane nxori arsyetimin që veçimi arsimor i fëmijëve me aftësi të kufizuara nuk është diskriminuese por barazi. Vendimi, i veçuar por i barabartë i Plessy-t u godit në SHBA në vitin 1954 me vendimin e Brown kundër Bordit të Arsimit të Topeka-s, në të cilën më së fundi Gjykata e Lartë pranoi se objektet e ndara arsimore në thelbin e tyre janë të pabarabarta. Sidoqoftë, Gjykata Federale Gjermane ka qenë shumë ngurruese për ta konsideruar këtë gjë si përjashtim nga arsimimi në kontekstin e diskriminimit të aftësisë së kufizuar. Ndonëse gjykata pranoi se do të kishte qenë diskriminuese moslejimi i atyre studentëve me aftësi të kufizuar të cilët nuk paraqisnin ndonjë nevojë sistemimi apo shërbimi të veçantë, nga ana tjetër nuk është e drejtë mosdhënia e këtij interpretimi edhe për ato studentë me aftësi të kufizuara që shtrojnë kërkesa për platforma të pjerrëta, për ashensorë, për interpretues të gjuhës së shenjave, për formate alternative leximi apo shërbime të tjera të posaçme edukative.

Edhe pse mangësitë e dispozitave kushtetuese kundër – diskriminuese mund të çojnë drejt konkluzionit që amendamentet kushtetuese në thelb janë të pafektshme, nga ana tjetër shembulli i Irlandës mbështet në mënyrë të tërthortë konkluzionin e kundërt. Për shkak se klauzola e barazisë në Kushtetutën e Irlandës të vitit 1937 ishte jashtëzakonisht e cekët, Gjykata e Lartë e Irlandës në vitin 1997 goditi dy pjesë të legjislacionit kundër-diskriminues të cilat e fusnin aftësinë e kufizuar midis terrreneve të tjera të ndaluara të diskriminimit. Gjykata vendosi që kërkesa ligjore për tu angazhuar në sisteme të arsyeshme shkelte të drejtat pronësore të punëdhënësve dhe të dy ligjet duheshin riprojektuar në respekt të të drejtave të aftësisë së kufizuar. Prandaj, nëse mungesa e një dispozite të fortë kushtetuese mund të ketë efekte frenuese në miratimin e ligjit civil kundër-diskriminues, nga ana tjetër ekzistenca e dispozitave të forta kushtetuese kundër-diskriminuese mund të shërbejë si

një bazënisje e rëndësishme dhe e nevojshme për nxjerrjen e ligjeve përkatëse kundër-diskriminuese. Së fundmi, një shembull pozitiv mbi mënyrën e interpretimit të klauzolave të paqarta kushtetuese të barazisë është gjetur në vendimin e Gjykatës së Lartë të Kanadasë të vitit 1997. Në Eldridge kundër British Columbia, paditësit sollën rastin e tyre para Gjykatës së Lartë të British Columbia, për shkak se krahina nuk ofronte shërbime mjekësore interpretuese ndaj pacientëve të shurdhër. Robin Eldridge nuk kishte mundur të komunikonte me mjekun e saj, dhe Xhon dhe Linda Warren kishin pësuar një përvojë të hidhur me lindjen e binjakëve të tyre duke mos qenë në gjendje të kuptonin plotësisht atë çfarë mjekët dhe infermierët u kishin thënë atyre. Paditësit e ngritën padinë e tyre duke u bazuar në klauzolat e barazisë (Seks. 15) të Kartës Kanadeze të të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, dhe deklaruan se legjislati i spitaleve krahinore i diskriminonte shurdhët nga që nuk u mundësonte shërbime interpretative të gjuhës së shenjave në një kohë kur komunikimi i efektshëm duhet konsideruar si komponent i natyrshëm dhe i nevojshëm i ofrimit të ndihmës mjekësore. Ndonëse gjykatat e niveleve të ultë refuzuan paditë e tyre, përkundrazi Gjykata e Lartë Kanadeze gjeti se ishte shkelur dispozita e barazisë. Me anë të interpretimit të dispozitës së barazisë e cila u njeh disa grupeve nevojën për të qenë të sistemuar në mënyrë që të gëzojnë parimin e barazisë, Eldridge së paku hap mundësinë që në bazë të Seks. 15 të Kartës tu kërkohet qeverive që të ndërmarrin hapa pozitive dhe thelbësore për të siguruar që personat me aftësi të kufizuara po ashtu edhe grupet e tjera që përjetojnë diskriminim, të marrin “një mbrojtje të barabartë dhe përfitime të barabarta” sipas ligjit.

Sidoqoftë, pavarësisht këtyre komenteve inkurajuese, Gjykata e Lartë e Kanadasë ka vazhduar të lerë të hapur çështjen e detyrimeve pozitive prej ligjit të barazisë.

(iii) Nxjerrja e Ligjeve Kundër-Diskriminuese Civile

Një përjasje e tretë është miratimi i ligjeve kundër-diskriminuese për personat me aftësi të kufizuara. Një numër vendesh kanë miratuar ligje të tilla dhe shumë vende të tjera po shkojnë drejt kësaj rruge. Vendet me orientime ligjore për të drejtat civile dhe kundër diskriminuese ndaj njerëzve me aftësi të kufizuara janë: Australia, Kanadaja, Kili, Kosta Rika, Etiopia, Gana, Guatemala, Hong Kongu, Hungaria, India, Irlanda, Israeli, Korea, Madagaskari, Mauricja, Namibia, Nigeria, Filipinet, Afrika e Jugut, Spanja, Sri Lanka, Suedia, Mbretëria e Bashkuar, SHBA-ja, Zambia, dhe Zimbabve. Me përjashtim të ligjit kilian, të gjitha ligjet e tjera mbulojnë punësimet që kanë lidhje me diskriminimin e njerëzve me aftësi të kufizuara. Disa prej këtyre ligjeve kanë lidhje vetëm me fushën e punësimit; Në vende të ndryshme këto ligje kanë diferenca të mëdha për sa u përket mbulimit të gjithë fushave. Këto ligje të diskriminimit të njerëzve me aftësi të kufizuara trajtohen më në hollësi në

Australi, Kanada, Filipine, Mbretëri e Bashkuar dhe në SHBA.

Akti Australian i Diskriminimit të Aftësisë së Kufizuar i vitit 1992 ndalon diskriminimin në sektorin e punësimit, strehimit, arsimimit, pronësimit, e furnizimit me të mira materiale, e përfitimit të shërbimeve, dhe në atë të frekuentimit të ambienteve, klubeve, sporteve etj. Akti Kanadez i të Drejtave të Njeriut i vitit 1985 mbulon diskriminimin në furnizimin me të mira materiale, në sigurimin e shërbimeve publike (përfshirë dhe transportin), në frekuentimin e ambienteve publike etj. Për më tepër ky ndalon diskriminimin në punësim dhe në frekuentimin e ambienteve tregtare si dhe në strehim. Urdhëresa e Hongkongut mbi Diskriminimin e vitit 1995 mbulon fushat e punësimit, arsimimit, lokalet, mallrat dhe shërbimet, ambientet publike, dhomat e avokatisë, klubet dhe sportet dhe aktivitetet qeveritare. Karta e Madhe për Njerëzit me Aftësi të Kufizuar e vitit 1992 e Filipineve ndalon diskriminimin e njerëzve me aftësi të kufizuar në fushat e punësimit, transportit, sistemimit publik dhe në të mirat materiale, dhe shërbimet. Akti Britanik i Diskriminimit të Aftësisë së Kufizuar i vitit 1995 mbulon diskriminimin në punësim, në furnizimin me të mira materiale, në ambiente dhe shërbime, dhe në një farë mase mbulon edhe fushat e arsimimit dhe të transportit publik. Më së fundi, Akti Amerikan i Aftësisë së Kufizuar i vitit 1990, ndalon diskriminimin në fushën e punësimit, në aktivitetet shtetërore dhe lokale qeveritare (përfshirë këtu arsimimin, transportin, shërbimet sociale, të telekomunikacionit etj.).

Ligjet civile të vendeve të tjera kanë gjithashtu një shtrirje të gjerë nëpër shumë aktivitete të jetës së përditshme, por dispozitat kundër-diskriminuese nuk mbulojnë çdo fushë veprimi që parashikon ky ligj. Për shembull Akti i Shanseve të Barabarta për Njerëzit me Aftësi të Kufizuara i vitit 1996 i Kosta Rika-s ligjëron arsimimin, punësimin, përfitimin e transportit publik, shërbimeve publike, informacionin dhe komunikacionin, shërbimet kulturore, të sporteve dhe aktivitetet dëfryese. Por, diskriminimi shprehet shumë në punësim, në shërbimet publike shëndetësore, në frekuentimin e aktiviteteve kulturore, sporteve dhe dëfryese.

Akti Indian për Njerëzit me Aftësi të Kufizuar (Shanse të Barabarta, Mbrojtje e të Drejtave dhe Pjesëmarrje e Plotë) i vitit 1995 ndryshon nga ligjet e tjera të të drejtave civile të cilat ndërtohen prej dispozitash të lehta jo diskriminuese, sepse bën thirrje për kuota në fusha të ndryshme. Dispozitat jo diskriminuese mbulojnë transportin, rrugët, mjedisin e ndërtuar dhe punësimin qeveritar (duke përjashtuar procesin e marrjes në punë). Sidoqoftë, detyrimet për integrimin e personave me aftësi të kufizuara zbatohen "brenda mundësive ekzistuese të kapaciteteve ekonomike dhe të zhvillimit". Një 3% kuota zbatohet për punësimin, për institucionet arsimore dhe për skemat për zbutjen e varfërisë. Qeveria rezervon një kuota punësimi prej 1% për njerëzit me lloje të ndryshme dëmtimesh kryesisht ata të shikimit, dëgjimit dhe ato

fizike. Një aspekt i veçantë interesante e ligjit është se çdo mungesë nën 3% e kuotës së kërkuar në punësimin qeveritar është për tu mbledhur përpara për vitin e ardhshëm. Teorikisht, kjo mund të çojë drejt një situatë të tillë që çdo agjenci qeveritare që ka shmangur kuotën e saj të kërkesës, mund të punësojë ose të nxisë punonjësit me aftësi të kufizuara. Shumë prej ligjeve të tjera të huaja gjithashtu kanë dispozita kuotash në fushën e punësimit publik. Pavarësisht kësaj, duke i bërë një vështrim të shkurtër krahasues ligjeve Evropiane të aftësisë së kufizuar, në seksionin C.2 shihet se skemat e kuotimit të punësimit kanë një traditë të gjatë dhe jo domosdoshmërisht kanë të bëjnë me parimin e kundër-diskriminimit.

Krahasuar me ligjet kundër-diskriminuese penale dhe kushtetuese, legjisla-cioni civil i aftësisë së kufizuar ka tendencën për të qenë më i qartë dhe më i detajuar për sa i përket aspektit ligjor; shumica e ligjeve jep një përkufizim mbi atë se çfarë nënkuptohet me termin praktikë diskriminuese apo me barazi. Përveç kësaj, të gjitha ligjet e diskriminimit civil përmbajnë disa dispozita për zbatimin e tyre. Si termi i diskriminimit po ashtu edhe ai i barazisë dhe mekanizmat përkatëse të zbatimit të tyre do të diskutohen më poshtë.

(iv) Ligjet e Mirëqenies Sociale dhe të Aftësisë së Kufizuar.

Më së fundi, disa vende mbajtën qëndrime rreth çështjes së diskriminimit të aftësisë së kufizuar nëpërmjet aprovimit të ligjeve tradicionale të mirëqenies sociale për personat me aftësi të kufizuara. Vendet që e kanë bërë këtë janë: Bolivia, Kina, Kosta Rika, Finlanda, Koreja, Nikaragua, Panamaja, dhe Spanja. Në këto ligje, dispozitat kundër-diskriminuese janë gjetur pranë dispozitave më tradicionale të parandalimit dhe rehabilitimit të aftësisë së kufizuar. Me përjashtim të Finlandës, ku në Aktin mbi Statusin dhe të Drejtat e Pacientëve i vitit 1992 në të cilin parashihet që çdo banues në Finlandë ka të drejtë pa dallim për të marrë kujdes shëndetësor dhe mjekësor, këto ligje janë përqendruar më tepër në miratimin dhe në zbatimin e shërbimeve sociale dhe në parimet integruese se sa në dispozitat që bazohen në kundër-diskriminimin. Dispozitat jo diskriminuese të gjetura në legjisla-cionin e mirëqenies sociale kanë tendencë për të qenë të pasakta dhe të kufizuara në fushat e tyre të veprimit dhe njëkohësisht të përqendruara në fushën e punësimit publik ose në atë të arsimimit. Për shembull: Akti spanjoll mbi Integrimin Social të Aftësisë së Kufizuar (1982) është tipik, sepse ka të bëjë me parandalimin, diagnostikimin dhe vlerësimin e aftësisë së kufizuar, me krijimin e një sistemi të përfitimeve në para dhe në lloje të tjera të rehabilitimit mjekësor, profesional, të shërbimeve komunitare, të integritimit në punë, etj. E vetmja dispozitë kundër-diskriminuese në këtë akt thotë se çdo dispozitë diskriminuese ndaj aftësisë së kufizuar që gjendet në rregulloret e punës, në marrëveshjet kolektive, në kontratat individuale apo në vendimet e njëanshme do të jetë e pavlefshme.

Ligji kinez i Republikës Popullore të Kinës për Mbrojtjen e Personave të Aftësisë së Kufizuar i vitit 1990 përmban një ndalim të përgjithshëm i diskriminimit të njerëzve me aftësi të kufizuar por nuk e specifikon kuptimin që do të merrte duke marrë parasysh se si është e organizuar shoqëria. Një analizë tekstuale e ligjit të jep përshtypjen se modeli tradicional mjekësor i aftësisë së kufizuar, pra institucionalizimi dhe veçimi, formon kornizën e aktit. Për shembull Artikulli 29 përcakton “punë të përqendruar” për personat me aftësi të kufizuara si një parim udhëzues. Kjo do të thotë që mundësitë për punësim janë të parashikuara nëpër ndërmarrjet e veçanta të mirëqenies sociale dhe nëpër institucione. Brenda këtyre institucioneve të veçanta, është i ndaluar diskriminimi ndaj njerëzve me aftësi të kufizuar në lidhje me rekrutimin, me punësimin, me promovimin, në lidhje me dhënien e titujve profesionale ose teknike, me pagesën, me mirëqenien dhe me aspekte të tjera të punësimit.

Duke qenë se kjo është e vetmja dispozitë kundër-diskriminuese në tërësinë e këtij akti, ligji përcjell një aspekt mjaft karakteristik dhe të kufizuar të barazisë. Në rrënjët mjekësore të modelit të këtij ligji duken gjithashtu disa dispozita mbi detyrimet e njerëzve me aftësi të kufizuara. Sipas nenit 10, personat kinezë me aftësi të kufizuar “ duhet të shfaqin një frymë optimiste dhe nismëtare” për të kundërshtuar idenë se këta persona ushqejnë qëndrime negative dhe depresion. Disa vende, si p.sh. Filipinet, kanë ligje të tilla që mund të karakterizohen si ligje të mirëqenies sociale po ashtu edhe si ligje të së drejtës civile. Sidoqoftë Karta e Madhe e Filipineve, vë qartazi në dukje qëllimin e ligjvënësve për të lëvizur nga modeli mjekësor në modelin e të drejtave të njeriut për njerëzit me aftësi të kufizuar. Titulli i I Kreu I Seksioni 2 thekson se të drejtat e personave me aftësi të kufizuara kurrë nuk duhen parë nga qeveria si shërbime sociale.

Historia e ligjit amerikan të diskriminimit të aftësisë së kufizuar tregon se shpesh shtetet fillojnë nisjen e dispozitave kundër-diskriminuese për njerëzit me aftësi të kufizuara në kuadrin e legjislationit të mirëqenies sociale. Këtu së pari ka tendencë të zhvillohet fusha ligjore për njerëzit me aftësi të kufizuara. E para ishte SHBA-ja që ndaloi disa forma diskriminimi ndaj njerëzve me aftësi të kufizuara me anë të Aktit të Rehabilitimit të vitit 1973. Seksioni i famshëm 504 parashikon që çdo person që merr ndihmë financiare federale, ose që i drejtohet një agjencie federale, nuk duhet të diskriminohet ndaj “ cilësimit si njeri me aftësi të kufizuar”. Amendamenti i Aktit Strehim i Ndershëm, i vitit 1988, e cila ndalon diskriminimin në çështjet e strehimit, ishte hapi i parë drejt përfshirjes së aftësisë së kufizuar, në terrenet kundër-diskriminuese të legjislationit të përgjithshëm të të drejtave civile të SHBA-së. Hapi final ishte me miratimin në vitin 1990 të ADA-s. Në një rrugë të ngjashme, edhe Kosta Rika po ashtu edhe Spanja kanë miratuar dispozita kundër-diskriminuese në kuadrin e legjislationit të mirëqenies sociale po ashtu edhe në atë të ligjeve civile.

Me një fjalë dispozitat diskriminuese të përfshira në legjislacionin e mirëqenies sociale kanë prirje për të qenë më pak tërësore dhe më pak të përgjithësuara. Zhvendosja e tezave nga modeli mjekësor i aftësisë së kufizuar drejt modelit të të drejtave të njeriut duket se është më i natyrshëm.

b. Grupet e Mbrojtura: Përqasja e Veçantë e Aftësisë së Kufizuar ose Përqasja ndaj Trans-Grupit.

Disa prej ligjeve kundër-diskriminuese që janë për personat me aftësi të kufizuar kërkojnë barazi për grupe të shumta, ndërsa ligjet e tjera përqendrohen vetëm në aftësinë e kufizuar. Ligjet për grupe të shumta mbrojnë minoritetet ose grupet e tilla si gratë, homoseksualët, fëmijët, të moshuarit, pakicat gjuhësore, fetare të cilët historikisht kanë qenë objekt i praktikave diskriminuese. Me përjashtim të Ganës, të gjithë dispozitat kundër-diskriminuese kushtetuese mbrojnë personat me aftësi të kufizuar si një entitet i veçantë. Po kjo gjë ndodh edhe për dispozitat diskriminuese në ligjet e punësimit dhe ato penale. Ligjet e diskriminimit për aftësinë e kufizuar që janë projektuar si ligje civile dhe sociale priren të jenë të drejtuara vetëm për personat me aftësi të kufizuar.

Përveç mbrojtjes së personave të cilët aktualisht kanë aftësi të kufizuara, disa ligje gjithashtu mbrojnë personat të cilët u bënë me aftësi të kufizuar në të kaluarën (Australi, Kanada [Akti i të Drejtave të Njeriut], Hong Kong, Zelanda e Re, Filipinet, Britania e Madhe dhe SHBA-ja), mund të bëhen me aftësi të kufizuar në të ardhmen (Australi, Hong Kong, Suedi) ose që janë të konsideruar me aftësi të kufizuar (Australi, Hong Kong, Zelanda e Re, Filipinet, SHBA). Për më tepër, disa ligje gjithashtu mbrojnë edhe anëtarët e familjes ose bashkëpunëtorët e njerëzve me aftësi të kufizuara (Australia, Hong Kongu, Zelanda e Re, Filipinet, SHBA.), po ashtu edhe personat të cilët janë viktimizuar për shkak të ndonjë ankese të bërë në lidhje me diskriminimin ose për të ushtruar të drejtat e tyre kundër-diskriminuese (Australi, Kanada [Akti i të Drejtave të Njeriut], Zelanda e Re, Britania e Madhe).

Shumë prej ligjeve diskriminuese që figurojnë në legjislacionin civil ose social e japin një përkufizim të aftësisë së kufizuar. Zakonisht përkufizimi ka karakter mjekësor dhe konsiderohet si një dëmtim fizik apo mendor me pasojat e një kufizimi të shprehur funksional.

c. Ndryshueshmëria e Barazisë dhe Konceptet mbi Diskriminimin në Lojë

Konceptet themelore të Barazisë në ligjet e diskriminimit të aftësisë së kufizuar të shqyrtuara këtu ndryshojnë gjerësisht. Disa ligje mbështesin një model barazie më zyrtare, në të cilën garancia e trajtimit të barabartë të tyre kushtëzohet qartazi në një përmbushjen të plotë pa dallim kulture apo shoqërie. Disa klauzola kushtetuese kundër-diskriminuese lexohen sipas

kësaj mënyre, ashtu siç tregohet në rastin arsimor gjerman. Gjithashtu modeli zyrtar i barazisë mund të shihet edhe pas atyre ligjeve që qartazi përmendin se diskriminimi mundet që në disa rrethana të justifikohet nga faktori aftësi e kufizuar. Për shembull, Akti i Punës i Namibisë i vitit 1992 parashikon që një person nuk do të konsiderohet si i diskriminuar padrejtësisht nëse për shkak të gjymtimit të tij nuk mund të kryejë punën. Akti i Personave me Aftësi të Kufizuar i Zimbabvesë i vitit 1992 parashikon që aftësia e kufizuar mund të jetë një justifikim legjitim për diskriminimin e punësimit. dhe mohimi i punësimit në një shërbim publik duket i justifikuar nëse “ ky motivim vjen nga një shqetësim i vërtetë për sigurinë vetjake të këtij personi me aftësi të kufizuar”. Ndërsa Ligji Special i Arsimit i Koresë i ndryshuar në vitin 1994 ndalon diskriminimin ndaj studentëve me aftësi të kufizuara në të gjitha shkollat, vetëm se drejtorët e shkollave të veçanta “ duhet të marrin masat e duhura që fëmijët me aftësi të kufizuara më para se të pranohen në shkolla të ekzaminohen për ti mundësuar sigurimin e komoditetit të duhur në bazë të llojeve dhe shkallës së aftësisë së kufizuar”. Kështu, drejtorët në shkollat e rregullta janë të kufizuar në mënyrë të qartë në përgjegjësitë e tyre për heqjet diskriminuese kur një student me aftësi të kufizuar nuk mund të shkollohet në “komoditetin e duhur”.

Sidoqoftë rreth një e katërta e ligjeve të shqyrtuara këtu, janë të bazuara në konceptin e barazisë strukturore. Për këtë i kërkohet shoqërisë që të zotohet për të ndryshuar për të garantuar shanse me të vërtetë të barabarta për personat me aftësi të kufizuara. Theksi në këtë rast qëndron në masat për një sistemim të arsyeshëm që duhet të ndërmarrin punëdhënësit, ata që sigurojnë shërbime, administrata shtetërore apo ndonjë entitet tjetër në mënyrë që të respektohen detyrimet kundër-diskriminuese. Vendet e mëposhtme kanë nxjerrë dispozita të tilla ligjore kundër-diskriminuese edhe pse jo gjithmonë këto ligje nuk mbulojnë në të gjitha aspektet ndalimet kundër-diskriminuese: Australia, Kanadaja, Hong Kongu, Hungaria, Irlanda, Israeli, Zelanda e Re, Filipinet, Suedia, Britania e Madhe, SHBA-ja, dhe Zimbabve..

Një tjetër tregues që flet se koncepti i barazisë strukturore nënvizohet në një ligj diskriminues mund të gjendet në brendësi të dispozitave të veprimit pohues duke lënë të kuptohet se për të arritur barazinë e vërtetë duhet të ndërmerren veprime pozitive. Gjashtëmbëdhjetë vende kanë dispozita të veprimit pohues në ligjet e tyre, shumica e të cilave kanë lidhje me skemat e kuotimit. Shumica e ligjeve kundër-diskriminuese përqendrohet në fushën e diskriminimit në punësim. Kjo mund të shpjegohet me faktin se kjo është zonë në të cilën ligji diskriminimit që lidhesh me grupet e minoritetit në përgjithësi u zhvillua pikë së pari; ligjet kundër-diskriminuese që lidheshin me racën dhe gjininë u miratuan fillimisht në sektorin e punësimit. Kjo gjë la të kuptohet që edhe për personat me aftësi të kufizuara të ndiqesh po kjo rrugë. Sidoqoftë, ne na duhet të rrisim vëmendjen ndaj faktit që e drejta e punësimit lidhet direkt me të drejtat njerëzore ekonomike, sociale dhe kul-

turore. Ky është ai takëm i të drejtave të njeriut që tradicionalisht ka qenë e aplikuar brenda kontekstit të aftësisë së kufizuar, ndërsa të drejtat civile dhe politike zakonisht janë lënë pas dore në politikat e aftësisë së kufizuar. Është parë se disa prej statuseve të diskriminimit të aftësisë së kufizuar të shqyrtuara këtu garantojnë qartazi mos-diskriminimin e të drejtave civile dhe politike të personave me aftësi të kufizuara. Ligjet e tjerat nuk përmenden qartazi të drejtat civile dhe politike, por këtë gjë e mbulojnë nëpërmjet miratimit të dispozitave kundër-diskriminuese të cilat synojnë sigurimin e frekuentimit të ambienteve publike, shërbimeve dhe sistemimeve.

Koncepti themelor i diskriminimit i bazuar në një ligj mund të dalë nga përkufizimi i statusor i diskriminimit të aftësisë së kufizuar (nëse është një), dhe nga qëllimi i mbulimit të ndalimeve të diskriminimit. Këto që i kemi diskutuar deri më tani, po ashtu edhe për afërsisht gjysma tjetër që ka mbetur, do të përqendrohen në përkufizimin e diskriminimit.

Shumica e këtyre përkufizimeve e përcaktojnë diskriminimin si një trajtim i pafavorshëm ndaj aftësisë së kufizuar, ndërsa një pakicë statusesh e përcaktojnë diskriminimin si një diferencim i pajustificuar. Disa prej ligjeve arrijnë të dallojnë format e drejtpërdrejta dhe ato të tërthorta të diskriminimit, dhe kjo e fundit zakonisht ka lidhje në përgjithësi me zbatimin e kërkesave apo kushteve me të cilat personat me aftësi të kufizuara përballohen më në vështirësi. Frazja themelore e sipërpërmendur në konceptin e barazisë strukturore është mishëruar qartazi në konceptin diskriminues të 12 statuteve, e cila e konsideron diskriminuese “ mohimin e sistemimit të arsyeshëm”. Interesante është se disa akte diskriminuese kanë dispozita që kërkojnë frekuentimin e vendeve publike, të ndërtesave, të transportit etj., por për faktin e mundësive mosrealizuese nuk përcaktohen si praktika diskriminuese. Nga kjo del që, frekuentimi i tyre duket që do të jepet si një shërbim social ndërkohë që është e formuluar si një e drejtë individuale.

Disa prej ligjeve diskriminuese i karakterizojnë aktet e ngacmimeve dhe të viktimizimit si forma të ndaluara diskriminuese. Akti Kanadez i të Drejtave të Njeriut, ndalon komunikimet diskriminuese publike, publikimet dhe mesazhet e urrejtjes. Një tjetër gjetje interesante është ajo që një numër i konsiderueshëm ligjesh diskriminuese trajtojnë gjithashtu çështjen e shfrytëzimit dhe të abuzimit të personave me aftësi të kufizuara.

Ndërkohë kur disa prej ligjeve kundër-diskriminuese në të vërtetë mbështesin parimin e arsimit të ndarë për studentët me aftësi të kufizuara, vetëm një pakicë e akteve përmbajnë një deklaratë të qartë se arsimit i ndarë është i pabarabartë dhe një formë klasike e diskriminimit të aftësisë së kufizuar. Përkufizimet më të plota të diskriminimit mund të gjenden në ligjet e Australisë, Kanadasë, Hong Kongut, Zelandës së Re, Filipineve, Britanisë së Madhe, dhe të SHBA-së. Këto ligje e përcaktojnë diskriminimin në lidhje me të gjitha fushat që mbuloohen nga ligji, përfshirë këtu punësimin, sistemimin publik,

të mirat materiale dhe fushën e shërbimeve. Brenda çdo fushe, përkufizimet japin një listë të gjatë të veprimeve që do të konsiderohen diskriminuose, dhe duke specifikuar aspekte të tilla diskriminuose si mohimin e pjesëmarrjes, dhënien e pjesëmarrjes në kushte të pabarabarta, ose dhënien e përfitimeve të veçanta. Përveç vetë faktorit të aftësisë së kufizuar, disa prej ligjeve përfshijnë qartazi përdorimin ose shoqërimin e ndihmave të tilla si udhërrëfyes ose si përkthyes gojor si shkaqe jo ligjore për trajtim diskriminues (p. sh. Australia, Hong Kongu).

d. Një Shumëllojshmëri Mekanizmesh Zbatimi

Zbatimi i legjislacionit zakonisht është detyrë e agjencive të administratës publike dhe e gjykatave. Legjislacioni që synon transformimin e shoqërisë nëpërmjet një shtrirjeje të tillë ligjore si ligjet e të drejtave të njeriut dhe ato kundër-diskriminuose, zakonisht krijon një trupë të veçantë zbatimi. Kjo do të kishte qenë një komision i të drejtave të njeriut apo i shanseve të barabarta, një person i avokatit të popullit, një këshill kombëtar, ose një agjenci publike. Nëpërmjet legjislacionit të aftësisë së kufizuar në shqyrtim, vetëm statutet ligjore civile ose sociale përmbajnë dispozita të veçanta për zbatimin ose monitorimin e ligjit.

Kështu pra, Akti Australian i Diskriminimit të Aftësisë së Kufizuar ngre Komisionin e të Drejtave të Njeriut dhe atë të Shanseve të Barabarta dhe një Komision të Diskriminimit të Aftësisë së Kufizuar. Akti Kanadez i të Drejtave të Njeriut detyron krijimin e Komisionit për të Drejtat e Njeriut dhe një Gjykatë për të Drejtat e Njeriut. Ligji Izraelit i të Drejtave të

Barabarta për Personat me Aftësi të Kufizuara u beson disa ministrive zbatimin e ligjit, dhe detyron krijimin e Komisionit për të Drejtat e Barabarta. Në Mbretërinë e Bashkuar, një Komision për të Drejtat e Aftësisë së Kufizuar shërben si mbikëqyrës i zbatimit të Aktit të Diskriminimit të Aftësisë së Kufizuar.

Një numër i madh aktesh u besojnë monitorimin e ligjit organizatave që përfaqësojnë aftësinë e kufizuar. Për shembull, Ligji i Republikës Popullore të Kinës për Mbrojtjen e Njerëzve me Aftësi të Kufizuar detyron krijimin e Federatës Kineze të Personave me Aftësi të Kufizuara, e cila ngarkohet me përgjegjësinë e përfaqësimit dhe të mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të personave me aftësi të kufizuara në Kinë. Akti Hungarez i Diskriminimit detyron krijimin e Këshillit Kombëtar për Çështjet e Aftësisë së Kufizuar në të cilën duhet të përfaqësohen organizatat e aftësisë së kufizuar. Ligji Indian kërkon hartimin më së miri të një mekanizmi monitorues dhe planifikues shumë-sektorial: krijimin e një Komiteti Koordinues Qendror të kryesuar nga Komisioneri Përgjegjës për Personat me Aftësi të Kufizuara, dhe të disa Komiteteve të tjera Koordinuese Shtetërore të cilat kanë për detyrë të administrojnë problemet e aftësisë së kufizuar në nivel shtetëror. Ligji kërkon

gjithashtu që të plotësohen disa vende me njerëz me aftësi të kufizuara në secilin prej këtyre komiteteve. Ligji Nigerian i diskriminimit lejon të krijohet një Komision Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuar, të kryesuar nga një njeri me aftësi të kufizuar, dhe ku brenda të cilit duhet të jenë të përfaqësuar të gjitha grupet kryesore të njerëzve me aftësi të kufizuara. Në mënyrë të ngjashme, edhe Akti i Personave me Aftësi të Kufizuara i Ganës krijon një Këshill Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara në të cilin gjashtë vende janë të rezervuar për organizatat përfaqësuese të aftësisë së kufizuar. Ligji i Zimbabve krijon Bordin e Aftësisë së Kufizuar në të cilin të paktën gjysma e vendeve duhet të jetë i mbushur me përfaqësues të organizatave të aftësisë së kufizuar. Kërkesa të ngjashme i ka imponuar edhe Ligji Zambian i Diskriminimit, Agjencisë së Zambias për Personat me Aftësi të Kufizuara, duke e ngarkuar atë me detyrën e organit zbatues..

Funksionet e këtyre organeve të monitorimit janë të shumta dhe ndryshojnë nga këshillimi dhe mbledhja e informacionit për qeverinë, për rritjen e ndërgjegjësimit publik, për hetimin dhe ngritjen e padisë. Bordi i Aftësisë së Kufizuar i Zimbabvesë dhe Agjencia Zambiane për Personat me Aftësi të Kufizuar kanë gjithashtu mandatin për të nxjerrë “porosi rregulluese”, duke kërkuar prej pronarëve kryerjen e veprimeve të veçanta në mënyrë që ambientet që kanë dhe shërbimet që kryejnë të mundësohen për personat me aftësi të kufizuara.

e. Konkluzionet që Dalin në Bazë të Prirjeve të së Drejtës Krahasuese

Ligjet kundër diskriminimit të aftësisë së kufizuar në mbarë botën kanë përqsasje të ndryshme. Njerëzit me aftësi të kufizuara mund të mbrohen ndaj diskriminimit me anë të ligjeve kushtetuese, penale, civile dhe ato sociale. Në bazë të analizave tona del që përqsaja më e plotë ligjore për të parandaluar dhe mbrojtur diskriminimin e aftësisë së kufizuar duket se gjendet në miratimin e legjislacionit të të drejtave civile. Sidoqoftë, nuk duhet të harrohet që metoda jonë kryesore për vlerësimin e këtyre ligjeve ishte analiza tekstuale e legjislacionit në vetvete. Ato pak raste që u analizuan dhe që u cituan më lart tregojnë se efekti që mund të ketë një ligj kundër-diskriminues në shoqëri varet në një masë të konsiderueshme nga interpretimi gjyqësor krahas përkushtimit politik për zbatim dhe pa nënvleftësuar vetë përpilimin e tekstit.

Sot aktualisht nuk ka ndonjë përkufizim universal për diskriminimin e aftësisë së kufizuar, dhe as për konceptin universal mbi atë se çfarë përfshihet në entitetin shanse të barabarta për personat me aftësi të kufizuar. Përkufizimet e diskriminimit shkojnë përgjatë diferencave të pajustificuara midis trajtimeve të pafavorshme të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të gjendura në listat e stërholluara të praktikave diskriminuese.

Sidoqoftë, ne mund të konkludojmë që ligjet moderne të diskriminimit të

aftësisë së kufizuar në përgjithësi duhet t'u përmbahen parimeve të heqjes së dallimeve, të deinstitutionalizimit, dhe të realizimit të sistemimeve të arsyeshme, të cilat së bashku aktivisht çojnë në heqjen e diskriminimit strukturor dhe të hapur. Përveç një përkufizimi të prerë të diskriminimit, ligjet duhet të ofrojnë mekanizma zbatimi të qarta dhe efektive në të cilat personat me aftësi të kufizuar si individualisht po ashtu edhe në grup luajnë një rol të madh.

Në këtë material nuk janë analizuar të gjithë ligjet e aftësisë së kufizuar të cilët veprojnë në përmirësimin e kushteve jetësore dhe në integrimin social të njerëzve me aftësi të kufizuar. Shumë vende kanë ligje të cilat ushtrojnë një efekt përparimtar për integrimin e personave me aftësi të kufizuara brenda bashkësisë dhe në jetën publike. Për shembull, shumë ligje të ndërtimeve të banesave të reja për publikun në tërësi kërkojnë që projektet e tyre të jenë të pranueshme edhe për njerëzit me aftësi të kufizuar. Në kuadrin e zbatimit të parimeve themelore të politikave arsimore, në këtë rast ligjet arsimore shpesh e inkurajojnë arsimimin e integruar. Në Skandinavi, ligjet e mirëqenies sociale sigurojnë një minimum të tillë të ardhurash që shërben në drejtim të lehtësimit të pavarësisë së tyre ekonomike. Vende të tjera kanë dispozita ligjore të forta të cilat kontribuojnë qartazi në krijimin e shërbimeve të pavarura sociale për njerëzit me aftësi të kufizuara. Akti finlandez i Shërbimeve dhe Asistencës për Njerëzit me Aftësi të Kufizuar i vitit 1978 është veçanërisht i njohur për dhënien ndaj disa personave me aftësi të kufizuara të së drejtës për të pasur shërbime të tilla sociale si të transportit, të strehimit, të shërbimeve përkthyes dhe në një farë mase edhe në drejtim të dhënies së disa shërbimeve personale. Për shkak se qëllimi kryesor i këtij akti është dhënia e mundësisë që personat me aftësi të kufizuara të jetojnë si anëtarë të pavarur të shoqërisë mbi një bazë barazie me të tjerët, akti është quajtur Akti i Barazisë me Personat me Aftësi të Kufizuar. Sidoqoftë, këto ligje të aftësisë së kufizuar nuk janë shqyrtuar këtu sepse ata nuk bien brenda konceptit të ligjeve të kundër-diskriminimit. Edhe pse këto ligje kanë për qëllim arritjen e shanseve të barabarta për njerëzit me aftësi të kufizuara, prapëseprapë ata nuk identifikojnë, as nuk ndalojnë moslejimet, veçimet, apo mohimet e jetesës së pavarur si aspekte të zakonshme diskriminuese. Duhet të mbahet mend që ligji i kundër-diskriminimit nuk është rruga e vetme për vënien e barazisë ndaj personave me aftësi të kufizuara, por një prej metodave më të mira të përdorura sot në shumë vendeve të botës të cilat edhe sot janë subjekt i përmirësimeve të vazhdueshme.

Ky rishikim i përgjithshëm i ligjeve të diskriminimit për njerëzit me aftësi të kufizuara jep një rritje të shpresës dhe gjithashtu edhe të shqetësimit. Shqetësimi është se jo çdo rast i gjuhës kundër-diskriminuese i përdorur në këtë legjislacion aktualisht mund të realizojë të drejtat e barabarta për personat me aftësi të kufizuara. Organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare duhet të veprojnë si vëzhgues të rreptë për të siguruar që ligjvënësit e tyre të mos e përdorin gjuhën kundër-diskriminuese në mbështetje thellësisht të

modelit mjekësor të politikave të aftësisë së kufizuar. Por ka një dëshmi të qartë se legjislacioni kundër-diskriminimit për njerëzit me aftësi të kufizuar shënon rritje në të gjithë botën. Prej kësaj del që personat me aftësi të kufizuara mund të shpresojnë që politikat e aftësisë së kufizuar më së fundi do të mund të arrijnë idealet e të drejtave të njeriut dhe ato të barazisë strukturore.

RAST STUDI MI

Përdorimi i Ligjit Rajonal të shërbejë si një Nxitës për Ndryshim – drejt “ një Akti Evropian për të Drejtat e Njerëzve me Aftësi të Kufizuara”.

Kjo pjesë përqendrohet në një analizë globale në drejtim të një zhvillimi më të madh të të drejtave të njeriut në lëmin kundër-diskriminues në zonën e Evropës me pikësynimin gjetjen e mundësive reale për arritjen e miratimit të një akti Evropian të ngjashëm në thellësi e përmbajtje me Aktin Amerikan të Aftësisë së Kufizuar (ADA).

Pas Luftës së Dytë Botërore, dy organizata shumë të ndryshme rajonale dhe që ende plotësojnë njëra tjetrën, janë themeluar në Evropë: Këshilli i Evropës (1949) dhe Komuniteti Ekonomik Evropian ose EEC (1957), njohur tani si Bashkimi Evropian (BE). Kompetencat zyrtare e të dyja këtyre organizatave shtrihet në çështjen e aftësisë së kufizuar.

Në fakt të dyja organizatat kanë marrë një interes aktiv në ligjin e aftësisë së kufizuar dhe politikave ndaj saj gjatë dekadave të fundit, dhe veçanërisht qysh prej fillimeve të viteve 1990 e tutje. Kalimi prej tezave të mirëqenies sociale tek ato për të drejtat e njeriut që është aq karakteristike tek ADA e vitit 1990, dhe e cila u ratifikua në një nivel ndërkombëtar në Rregullat Standarde të OKB –së në vitin 1993, është gjithashtu tepër e goditur në ndryshimet që së pari u zhvilluan në politikën kombëtare dhe rajonale evropiane gjatë dekadës së fundit.

Fakti që idetë e reja dhe ato të reformimit të kësaj fushe duhet të vijnë nga Këshilli i Evropës nuk është ndonjë çudi për deri sa arsyeja e të qenit i këtij organi është që të avancojë dhe të mbrojë të drejtat e njeriut. Që Bashkimi Evropian duhet të merret me këtë çështje është e një normë fillimi qysh kur ky organ është i njohur mirë për suksesin e tij në krijimin e një tregu të brendshëm të përbashkët midis tregjeve kombëtare të shteteve të tij anëtare. Megjithatë, interesi i tij gjetur rishtazi në këtë temë është e një rëndësie tepër domethënëse. Hapja e BE-së drejt perspektivave të reja ndaj aftësisë së kufi-

zuar ndoshta mund të shpjegohet me tendencën e tij për të parë strategjinë e barazisë si një «faktor produktiv» në një ekonomi tregu të përparuar. Ne sjellim ndërmend se ky treg i racionalizuar dhe perfekt ishte gjithashtu një prej impulseve më të fuqishme pas miratimit të ADA-s. E parë thjeshtë në aspektin ligjor, përfshirja e BE-së është e rëndësishme në atë që ka në dispozicion një armë ligjore shumë më të fuqishme në krahasim me ato që janë ushtruar nga ana e Këshillit të Evropës. Në të vërtetë, BE-ja potencialisht mund të miratojë Aktin Evropian për Aftësinë e Kufizuar për të rivalizuar ADA-n si në përmbajtje ashtu edhe në gjerësi. Siç do të shihet, hapat e para drejt këtyre nismave gjithëpërfshirëse tashmë janë ndërmarrë në Bruksel. Ligjet dhe politikat përkatëse të Këshillit të Evropës dhe të Bashkimit Evropian pasqyrojnë si modelin e ndryshimeve që po ndodhin brenda Shteteve të tyre Anëtare përkatëse, po ashtu ndihmojnë edhe në çuarjen më tej të procesit të përgjithshëm të reformës në të gjithë kontinentin.

Etika kryesore që gjallëron këtë proces reformues buron direkt nga nocione të gjera të barazisë dhe mos-diskriminimit, megjithëse manifestimi specifik i kësaj agjende në nismat ligjore dhe të politikave të këtyre dy organizatave është mjaft trulllosësh, madje edhe për kuadrot më me përvojë të këtyre institucioneve. Megjithatë, këto nisma mund të grupohen për tu shfrytëzuar në temat e mëposhtme.

Së pari, sepse ky proces reformues synon të respektojë dinjitetin e njeriut, ajo synon të rivendosë praninë e personit, sidomos në ato kontekste ku ata janë më të pambrojtur. Një shembull i mirë i një nisme që përkon me këtë temë është procesi reformues i ligjit të shëndeti mendor që duhet të përfshijë tërë Evropën. Kjo kërkon rivendosjen e perspektivës njerëzore nëpërmjet zgjerimit të përfitimeve që mund të rezultojnë prej rregullimeve dhe mbrojtjes ligjore për ata që janë të arrestuar aksidentalisht. Vëmendje e barabartë i është kushtuar kushteve të dënimit, për të siguruar të drejtat e duhura për trajtimin dhe ndalimin e veprimeve të caktuara që degradojnë dinjitetin e personit. Në themel kësaj prirje është etika për një vlerësim të barabartë ndaj çdo njeriu, duke shkuar mjaft natyrshëm drejt një politike të qëllimshme që rivendos perspektiva të barabarta për të gjithë njerëzit. Këshilli i Evropës luan një rol udhëheqës në këtë drejtim.

Së dyti, procesi i reformave po i vendos në një vetëdije të re të drejtat e atyre personave të cilët janë të paaftë për të vënë në vend të drejtat dhe interesat e tyre, dhe të cilët kanë nevojë për përgjigje të duhura ligjore. Një shembull i mirë është reforma radikale që sot po aktualizohet në të gjithë Evropën ndaj ligjshmërive jo kompetente. Parlamenti Evropian (një organ i Bashkimit Evropian), ka luajtur edhe në të kaluarën një rol aktiv në këtë fushë, por Këshilli i Evropës ka ndërmarrë gjithashtu një rol kryesor për të ndihmuar në nxitjen e procesit të reformimit të ligjshmërisë së brendshme. Asnjë nga këto nuk mund të bëhet pa një strategji të përgjithshme të barazisë.

Së treti, procesi i reformave është zhvilluar në bazë të një pranueshmërie graduale duke marrë parasysh mostjetërsimin e barazisë midis qytetarëve dhe në bazë të motos që jeta e kësaj bote duhet të ndërtohet duke respektuar shanset e barabarta për gjithkënd. Një shembull i mirë është lëvizja e gjerë për të bërë ligje që pranojnë mundësitë barabarta dhe jo-diskriminuese dhe që inkurajojnë programe që ndihmojnë njerëzit për të marrë në dorë fatet e jetës së tyre dhe që i lejojnë ata për të marrë pjesë në aktivitete që i shërbejnë të drejtave të tyre. Kjo gjë po çon drejt përhapjes së ligjeve jo-diskriminuese në fusha të veçanta si, arsimi punësimi, transporti, telekomunikacioni, etj. Këshilli i Evropës dhe Bashkimit Evropian kanë treguar një interes shumë aktiv në këtë dimension procesi reformues. Bashkimi Evropian tregohet i gatshëm për të miratuar masa të forta ligjore për të garantuar të drejtën e mos-diskriminimit (duke përfshirë këtu edhe konceptin e lidhur me sistemet e arsyeshme) në kontekstin e rëndësishëm të punësimit.

Së katërti, procesi reformues është duke u udhëhequr me vetëdijen se programet ekonomike dhe sociale që tradicionalisht kanë qenë pjesë e problemit mund të bëhen pjesë e zgjidhjes në qoftë se këta do të ri-orientoheshin për të lehtësuar pjesëmarrjen dhe zgjedhjen. Kjo vetëdije është e pasqyruar në reformën e modelit social evropian e cila është aktualisht në zhvillim e sipër dhe që mbizotëron veçanërisht brenda Bashkimit Evropian. Ashtu si krijuesit e politikave amerikane që po vijnë drejt atij realizimi sipas së cilës liritë formale duhet të shtohen me mbështetje sociale për të bërë lirinë e vërtetë, po ashtu edhe krijuesit e politikave evropiane po vijnë drejt atij realizimi sipas së cilës mbrojtja sociale nuk i shërben qëllimit nëse kjo nuk është e lidhur me një strategji të tillë që çliron njerëzit dhe që i siguron atyre të drejtat civile.

Mbetet për tu analizuar fakti se si modelet e shanseve të barabarta dhe ato të mos-diskriminimit që zbatohen nga administratat përkatëse Evropiane janë të pasqyruara në Këshillin e Evropës dhe në Bashkimin Evropian. Pasi u kemi hedhur nga një sy ligjeve përkatëse dhe politikave të këtyre dy organizatave, unë do të përfundoja me vlerësimin e disa fillesave analitike që do të çonin në mundësinë e miratimit të një Akti Evropian mbi Aftësinë e Kufizuar.

A. Këshilli i Evropës dhe Aftësia e Kufizuar.

1. Sfondi: Mjetet Ligjore dhe Instrumentat Administrative të Këshillit.

Këshilli i Evropës është themeluar në vitin 1949 dhe është më i vjetri prej të dy organizatave. Anëtarësimi i saj është shumë më i zgjeruar se ai i BE-së, dhe aktualisht ka 41 anëtarë. Duke marrë në konsideratë shtrirjen e konsiderueshme të aktiviteteve që lidhen me aftësinë e kufizuar, anëtarësimi i tij përfshin shumicën e vendeve të Evropës Lindore; Gjeorgjia është shteti i fundit anëtar. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kanadaja dhe Meksika kanë një status konsultativ.

Objekti kryesor i Këshillit është siç thuhet në nenin 1 të statutit të saj themelues:

1. (a) ... për të arritur një unitet më të madh midis Anëtarëve të tij me qëllim garantimin dhe realizimin e idealeve dhe parimeve që janë trashëgimi e përbashkët dhe lehtësimin e progresit të tyre ekonomik dhe social.

Këto qëllime janë ndjekur nëpërmjet organeve të Këshillit nga:

1. (b) ... diskutimi i çështjeve të interesit të përbashkët dhe me marrëveshje dhe veprim të përbashkët në çështjet ekonomike, sociale, kulturore, shkencore, ligjore dhe administrative dhe në mbajtjen e realizimin e mëtejshëm e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Filozofia bazë e Këshillit të Evropës kërkon që të shtohet me anë të shtet-komb në mënyrë që të shmanget çdo përsëritje të një rrëshqitje në totalitarizëm dhe si rrjedhim i lindjes së ndonjë konflikti mes shteteve evropiane. Prandaj Këshilli tradicionalisht ka vënë theks të fortë në ruajtjen (edhe pse jo saktësisht uniforme) e të drejtave të njeriut nëpër Evropë.

Për sa i përket karakterit të tij ligjor, Këshilli është një organizatë klasike ndërqeveritare. Kjo gjë në kuptim të asaj që, ai nuk ka pushtet mbi shtetet, përveç asaj që autoritetet e shteteve shprehin gatishmërinë për ta pranuar atë vullnetarisht. Ky theks mbi ndër-qeveritarizmin është e pasqyruar në organet e Këshillit. Organi kryesor politik është Komiteti i Ministrave, i cili ka një Kryesi që ndërrohet me rotacion çdo gjashtë muaj. Këshilli ka Sekretariatin e vet të ekspertëve (nëpunësit e përhershëm civilë ndërkombëtarë), që kryesohet nga Sekretari i Përgjithshëm.

Këshilli gjithashtu ka një Asamble Parlamentare (e quajtur më parë një Kuvendi Konsultativ), anëtarët e të cilit janë tërhequr sipas një rregulli të caktuar nga parlamentet kombëtare të Shteteve Anëtare. Ngandonjëherë Kuvendi debaton lidhur me çështje të rëndësishme të aftësisë së kufizuar.

Kompetencat e Këshillit janë të gjëra, edhe pse çështjet e mbrojtjes kombëtare janë përjashtuar shprehimisht në bazë të Nenit 1 (d) të Statutit themelues. Në përputhje me karakterin e Këshillit, instrumentet e përdorura nga ai janë të natyrës ndër-qeveritare. Mjeti më i rëndësishëm në dispozicion të tij është miratimi i konventave apo traktateve ligjërishet detyruese që janë të hapura për nënshkrim për të gjitha shtetet anëtare. Disa konventa janë në fakt të hapura për nënshkrim edhe ndaj shteteve jo anëtare. Të paktën 177 traktate kanë përfunduar në këtë mënyrë për tema që renditen nga trans-kufitar televizioni tek tregtimi i brendshëm në një gamë të gjerë të të drejtave të njeriut. Deri tani më i rëndësishmi i këtyre konventave me famë botërore është Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (ECHR), edhe pse pothuajse të gjitha konventat e të drejtave të njeriut kanë një rëndësi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në kontekstin e aftësisë së kufizuar, duke përfshirë këtu diskriminimin e aftësisë së kufizuar.

Komiteti i Ministrave mund të miratojë rekomandimet drejtuar qeverive të shteteve anëtare, që kanë të bëjnë me formulimin e politikave të tyre. Edhe pse Rekomandimet e tilla janë ligje jo-detyruese prapëseprapë ato mund të kenë influencë të jashtëzakonshme. Ndonjëherë frymëzimi për miratimin e një Rekomandimi vjen nga vendimet e marra nga rastet gjyqësore kryesore në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Shpesh, këto raste të zbulojnë boshllëqe të gjerë që evidentohen në ligjshmërinë evropiane që mund të adresohen në mënyrë efektive nëpërmjet reformës ligjore uniforme. Siç do të shihet, disa prej këtyre rasteve kryesore kanë nxitur Rekomandime të rëndësishme në fushën e shëndetit mendor. Shpesh shtysa për të nxjerrë një Rekomandim vjen si një përgjigje e një procesi reformues të iniciuar spontanisht dhe që flasin për shenja të ndërrimit të kursit dhe që kërkon një orientim të qëndrueshëm konceptual nga Strasburgu.

Së fundi, Këshilli i Evropës pret një varg trullësesh ndër-qeveritar që ofrojë aktivitete dhe forume për diskutimin e një gamë të gjerë çështjesh. Kur një problem nuk duket se bie taman brenda kompetencave të Këshillit, ose kur vetëm pak shtete anëtare dëshirojnë të ndjekin një çështje të caktuar të politikës, Këshilli megjithatë mund të lehtësojë diskutimin e çështjes duke përfunduar atë që quhet një Marrëveshje e Pjesshme. Sipas marrëveshjeve të tilla të pjesshme, makineria e Këshillit u vihet në dispozicion atyre Shteteve Anëtare që dëshirojnë të përdorin atë për qëllimet e marrëveshjes. Sipas një marrëveshjeje të tillë të pjesshme, Marrëveshja e pjesshme në fushën e shëndetit publik dhe në atë shoqëror dhe shumë çështje që kanë të bëjnë me Aftësinë e Kufizuar (duke përfshirë këtu diskriminimin e aftësisë së kufizuar) janë diskutuar dhe studiuar. Këtyre aktiviteteve u janë dhënë vazhdimisht orientime nga ana e Komisionit për rehabilitimin dhe integrimin e njerëzve me Aftësi të Kufizuara (CD-P-RR).

Një rezultat interesant ishte fakti që qysh nga fundi i Luftës së Ftohtë, Këshilli i Evropës, e pa të nevojshme, të fillonte të rishikonte opinionin e vet. Ai nuk e pa më veten si një «klub demokratik», por denjoi të veprojë edhe si një «shkollë demokratike», sidomos në lidhje me Shtetet e reja Anëtare, nga ish-blloku sovjetik. Rënia e Murit të Berlinit çoi në shfaqjen e demokracive të reja nga ish-blloku komunist. Me nevojat urgjente që domosdoshmërisht lindën prej politikave që dolën nga pranimi i këtyre shteteve të reja, Këshilli konkludoi se roli i tij gjithashtu duhej të ndryshonte. Është kërkuar që puna të mos përqendrohet vetëm në administrimin e standardeve por edhe për ti promovuar ato dhe për të lehtësuar në mënyrë aktive demokratizimin e regjimeve të reja. Për të arritur këto synime, Këshilli ka realizuar mjete dhe organizma të reja të tilla si p. sh. Programi ADACS.

ADACS mbështet veprimtaritë për zhvillimin dhe konsolidimin e stabilitetit demokratik. Programet e saj aktuale përfshijnë Demosthenes (ndërtimi i institucioneve përmes trajnimit të kuadrove administrues), Themis (trajnim

i kuadrove të gjyqësorit), dhe lode (zhvillimi i demokracisë lokale). 2000 ADACS Programi që ka të bëjë me çështjet sociale, mbështet një numër projektesh që lidhen me aftësinë e kufizuar. Interesante është që një projekt i tillë ka të bëjë me trajnimin e zyrtarëve në Bosnjë, në hartimin e legjislacionit të së drejtës së aftësisë së kufizuar. Projekte të tjera përfshijnë një program për de-institucionalizimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në Rusi. Çuditërisht, Këshilli i fundit i Strategjisë së Evropës me orientimin social nuk duket se e përmend aftësinë e kufizuar.

Këshilla të tjera përkatëse të dalin prej zhvillimeve evropiane të pas Luftës së Ftohtë përfshijnë Komisionin e Venecias për Demokraci nëpërmjet Ligjit, Zyrën e Komisionarit për të Drejtat e Njeriut, dhe krijimin e një procesi brenda Sekretariatit për monitorimin e gjendjes së të drejtave të njeriut në Shtetet Anëtare, etj Të gjitha këto organe ngjallin interesa në fushën e aftësisë së kufizuar.

Për të qenë më të saktë, këto forume, duke ju përmbajtur natyrës së tyre ndër-qeveritare, tradicionalisht nuk përfshijnë aktivisht në shqyrtimet e tyre organizatat joqeveritare (OJQ) ose organizatat joqeveritare ndërkombëtare (d.m.th., ato OJQ-të që ndërtojnë ura ndërmjet disa vendeve evropiane). Sidoqoftë, aktualisht edhe për shkak se midis tyre ekziston një sasi jo e vogël filozofie të përbashkët, Këshilli konsultohet në mënyrë aktive me OJQ-të që trajtojnë aftësinë e kufizuar.

2. Konventat e Këshillit të Evropës në kontekstin e aftësisë së kufizuar.

Këshilli i Evropës ka miratuar një sërë konventash që mbrojnë një gamë shumë të gjerë të drejtash, përfshirë këtu të drejtën për të qenë të lirë nga diskriminimi. Shumica e këtyre konventave ose kanë një rëndësi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në kontekstin e aftësisë së kufizuar.

a. Konventa mbi Aftësinë e Kufizuar e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (1950) (ECHR).

Kjo konventë është konventë Evropiane rajonale e njëjtë me Paktin Ndërkombëtar të OKB-së mbi të Drejtat Civile dhe Politike. Ajo përcakton një listë të plotë dhe të detajuar të të drejtave civile dhe politike, dhe – i të një rëndësie të njëjtë – e cila krijon një proces të përpunuar të zbatimit gjyqësor përmes Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Deri në vitin 1994, Komisioni Evropian i të Drejtave të Njeriut ka ndihmuar Gjykatën.

Protokolli nr 11 të vitit 1994 shpërndau Komisionin, por juridiksioni i tij mbetet bindës para Gjykatës. Në thelb, Gjykata jep një «sistem të jashtëm» mbikëqyrje gjyqësore që ka për qëllim të zërë një vend zëvendësues në sistemet kombëtare gjyqësore, të cilat ende konsiderohen si primare.

Procedurat para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut duhet të fillohen brenda gjashtë muajve pas një vendimi përfundimtar gjyqësor kombëtar.

Vendimi është bërë së pari mbi bazën e pranueshmërisë, dhe pastaj mbi atë të meritës. Gjykimet negative janë «zbatuar» politikisht nga Komiteti i Ministrave, që «mbikëqyr zbatimin e tyre».

Disa të drejta nga KEDNJ janë shënuar mjaft të dukshëm në praktikën gjyqësore të Gjykatës që ka trajtuar aftësinë e kufizuar. Në veçanti, të drejta e lirisë (neni 5), gjykimi i drejtë (neni 6) dhe mbrojtja nga tortura, trajtimi çnjerëzor ose degradues (neni 3) i kanë dhënë rritje një jurisprudence shumë të pasur të kontekstit të aftësisë së kufizuar mendore, dhe të angazhimit civil në veçanti.

Neni 5.1 (e) i KEDNJ-së në mënyrë specifike lejon për «ndalimin e ligjshëm të një të çmenduri» (d.m.th. angazhimi civil si një përjashtim nga e drejta e përgjithshme për liri), por një seri e vendimeve të rëndësishme kanë përpunuar këtë fuqi të jashtëzakonshme. Kjo është e rëndësishme që nga procesi i angazhimit tradicional civil ishte tepër e pafavorshme, madje edhe në krahasim me procesin përkatës penal. Ndryshe nga procesi penal, baza e burgimit në një angazhim civil thjesht mund të çojnë në një gjendje si i tillë, dhe jo në një gjendje si manifestohet në një sjellje të caktuar. Procesi i vendimmarrjes ka qenë përgjithësisht reflektiv dhe jo reflektiv. Shumë pak të drejta substanciale apo procedurale u lejuan tek personi i burgosur. Zgjatja dhe shkalla e humbjes së lirisë ishte e papërcaktuar, dhe efekti i logjikshëm për të drejtat e mbetura ishte i ashpër. Në fakt, angazhimi civil në të kaluarën çoi në një humbje disi të plotë të kapacitetit civil.

Një shembull se si Gjykata e të Drejtave të Njeriut ka kufizuar keqpërdorimin e fortë të përjashtimit të angazhimit civil në GJEDNJ është gjetur në Winterwerp v Holandë. Në vendimin e saj, Gjykata refuzoi t'i përmbahet ndonjë përkufizimi të veçantë të sëmundjes mendore, dhe nga ana tjetër e lidhi përkufizimin me përparimet në shkencën mjekësore. Ajo këmbënguli se termi «çmenduri» nuk duhet të përdoret si një dredhi për të burgosur ata që thjesht u devijojnë konventave shoqërore ose që kanë pikëpamje politike të pa përshtatura. Gjykata gjithashtu ka hartuar edhe një jurisprudence të përpunuar mbi kriteret e «ligjshmërisë», siç kërkohet për ndalimin e një personi sipas nenit 5.1 (d). Prova duhet të jetë e besueshme dhe objektive. Grupi që solli propozimin nuk duhet të jetë e njëjtë me grupin marrës (ose institucionin). Ligji vendor duhet të jetë në pajtueshmëri të plotë me të, dhe çdo mos pajtueshmëri do të shndërrohet në një shkelje të veçantë të Konventës. Për më tepër, neni 5 (4) kërkon një rishikim periodik të angazhimit, dhe neni 6 garanton të drejtën për të ju drejtuar ndonjë gjykate të zakonshme për të paraqitur ndonjë kërkesë të përgjithshme civile ose për të kundërshtuar ligjshmërinë e paraburgimit. Fakti i angazhimit civil nuk është në vetvete e mjaftueshme për të garantuar mohimin e kapacitetit ligjor të një personi. Vendosja e një personi i arsyeshëm në një institucion mendor ngre çështje si sipas nenit 5 (1) (e) ashtu edhe sipas nenit 3. Gjithashtu, duke vendosur

një person «të çmendur» në një burg pa e trajtuara ngre po të njëjtat çështje. Në përgjithësi, neni 5 (i vetëm, si dhe në kombinim me nenet 6 dhe 3) i ka dhënë rritje të ashtuquajturës «zvarritje të kriminalizimit» në ligjin e angazhimit civil në Evropë. Frazja i referohet mënyrës se si shumë prej masave themelore dhe procedurale që normalisht ndjekin procedurën penale të burgosjes gradualisht shartohen me procesin e angazhimit civil.

Deri tani dobësia më serioze e GJEDNJ në kontekstin e aftësisë së kufizuar ka të bëjë me pasaktësinë e dispozitave të mos-diskriminimit. Norma kryesore e Konventës barazi/mos-diskriminim është e përfshirë në nenin 14, i cili thotë:

Arritja e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet pa bërë diskriminim prej ndonjë faktori të tillë si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, opinioni politik apo tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, prona, lindja apo ndonjë statusi tjetër.

Kufizimi i parë i përgjithshëm rrjedh nga fakti se kafshimi kritik i nenit 14 është e rezervuar vetëm për zotërimin e të drejtave që përmbahen në vetë këtë Konventë. Kjo sepse, ajo nuk parashikon një klauzolë të përgjithshme kundër diskriminimit që mund të zbatohet, për shembull, në fushën e transportit publik. Së dyti, baza mbi të cilat diskriminimi është i ndaluar nuk përfshin qartazi aftësinë e kufizuar. Natyrisht, është plotësisht e mundur interpretimi i frazës «status tjetër», frazë e cila bastis personat me aftësi të kufizuara. Por kjo do të kishte qenë më e kollajshme për të bërë një rast për reportazh në KEDNJ nëse paaftësia do të kishte qenë përmendur qartazi.

Dobësitë e nenit 14 janë universale dhe pranuarë sinqerisht. Kjo gjë mund të zgjerohet nëse përmenden arsyetimet e tjera që bëjnë më lart. Një gjë e tillë mund të thellohet edhe më tej në qoftë se zgjerohesh shtrirja përtej të drejtave të vetë konventës duke ndaluar diskriminimet në një gamë edhe më të gjerë fushash. Në fakt, kohët e fundit janë rritur shanset për një zgjerim të mëtejshëm të mbrojtjes që duhet të japë neni 14. Impulsi kryesor i këtij procesi reformues ka ardhur nga personat dhe organizatat e interesuara kryesisht me çështjet e gjinisë dhe racës. Nga perspektiva gjinore, nevoja për një reformë u rrit nga shqetësimi se neni 14 nuk mund të mbështeste as edhe masat e buta të veprimit pohues. Nga pikëpamja racore, nevoja për reformë u rrit për shkak të horizontit jo të gjerë që kishte neni 14 e cila nuk arriti të sigurojë barazi të vërtetë në ato kontekste të rëndësishme ku mund të përfshihen fushat e punësimit dhe shërbimet sociale.

Produkti final i këtij procesi reformues ishte Protokollin 12 i kësaj Konvente, në Nenin1 të së cilës lexohet:

1. Zotërimi me ligj i një sërë të drejtave mund të sigurohet pa bërë asnjë diskriminim që rrjedh nga gjinia, raca, ngjyra, gjuha, besimi fetar, opinioni politik apo ndonjë opinioni tjetër, origjina kombëtare dhe sociale, qenia minoritet kombëtar, prona, lindja apo ndonjë status tjetër.

Është e rëndësishme të theksohet që Protokollin Nr. 12 është një shtojcë e KEDNJ-së. Kjo nuk e zëvendëson Nenin 14 të Konventës por ajo mbetet si një opsion i ndarë. Për ato shtetet anëtare që zgjedhin për të mos e ratifikuar atë, Protokollin thjesht i shtohet Nenit 14. Për ato shtete që nuk kanë ratifikuar atë, vlen zbatimi vetëm i Nenit 14 (dhe asgjë tjetër).

Teksti i nënvizuar në nenin 1 të protokollit nr 12, më sipër, është ndryshimi i vetëm nga origjinali i nenit 14. Si i tillë, Protokollin ka qëllim të qartë për të kryer mbulimin mbrojtës të Nenit 14 përtej të drejtave të siguruar nga vetë konventa, por kjo nuk shton as nuk zgjeron bazat e ndalimit të diskriminimit ashtu siç ka qenë e hartuar fillimisht. Prandaj aftësia e kufizuar nuk është ende i mbuluar qartazi nga Këshilli i Evropës si një armë kryesore ligjore kundër diskriminimit. Kjo situatë qëndron në kontrast të gjallë me këtë në Bashkimin Evropian, shihni më poshtë, dhe vetëm nëse për shkak të krahasimit të pafavorshëm me BE-në, mangësitë aktuale të ECHR-së me siguri duhet ta rendisin në ndër telendisjet e qëndrueshme të Këshillit të Evropës.

Disa të drejta të tjera shpesh për ata që janë të përcaktuara në konventën origjinale janë shtuar nga Protokollin Shtesë. Me interes të veçantë në kontekstin e aftësisë së kufizuar është e drejta për arsimim që përmbahet në Protokollin e Parë (1952). E drejta lexon si më poshtë:

2. Asnjë personi nuk mund t'i mohohet e drejta për arsimim. Në ushtrimin e çfarëdo funksioni, ajo duhet të jetë në përshtatje me arsimimi; shteti duhet të respektojë të drejtën e prindërve për tu siguruar fëmijëve të tyre këtë edukim dhe arsimim në përputhje me bindjet e tyre fetare dhe filozofike. Deri diku kjo nuk ka qenë problem për dy arsye kryesore.

Para së gjithash, në një fushë ligjore ose në rrethana ku ka dykuptimësi, interpretimi i KEDNJ-së do të varet pjesërisht nga gjendja e ligjshmërisë në secilin vend të mbarë Evropës. Kjo sepse, zhvillimi i normave lidhet me gjendjen aktuale të së drejtës evropiane në përgjithësi. Gjykata Evropiane nuk përdor në mënyrë origjinale apo të lehtë normat e Konventës për t'ju drejtuar me guxim dhe për t'ju kërkuar aprovim tërë shteteve Anëtare. Realiteti i ashpër është se arsimiti në Evropë, ka tentuar të jetë tepër përjashtues dhe diskriminues në të kaluarën. Ishte ndoshta e pashmangshme që organet e KEDNJ-së të ta kishin pasqyruar këtë me interpretimin e druajtur të së drejtës për një edukim të barabartë.

Së dyti, çdo zbatim i njëmendët i së drejtës do të kërkonte një shqyrtim kritik të sistemeve aktuale evropiane arsimore, dhe në mënyrë të pashmangshme do të rezultonte në gjykime negative që do të influencenin mbi atë se si janë ndarë dhe përdorur burimet shtetërore.

Me fjalë të tjera, për t'ju përshtatur plotësisht gjykimin të pafavorshëm do të kërkoresh një planifikim më i mirë, një legjislacion i ri dhe një përtëritje rezervash. E thënë troç, këto kërkesa do të kërcënonin ose të paktën do të jepnin përshtypjen që do të kufizonin kompetencat ekzekutive të shtetit.

Në të paktën dy aplikime, Komisioni Evropian për të Drejtat e Njeriut mund ta merrte një linjë të guximshme në lidhje me diskriminimin arsimor ndaj nxënësve me aftësi të kufizuara, por zgjodhi të mos marrë në konsideratë çështjet thelbësore duke refuzuar pranueshmërinë.

Ndonëse ndarja strikte e kompetencave nuk kanë qenë pengesë për pranueshmërinë për Komisionin apo Gjykatën në të kaluarën, kur ata kishin pasur prirje për të qenë aktivë drejt një Shteti Anëtar, mesa duket se ata kanë zgjedhur për të mos qenë aktivist në këtë çështje.

Megjithatë, lloji duhur i testit të strategjisë së rastit ende mund të krijojë disa jurisprudenca pozitive për çështjet arsimore në të ardhmen, për arsye e thjeshtë se ligji kombëtar dhe politikat në këtë fushë po ndryshojnë në shtetet anëtare dhe Gjykata është e detyruar që në këtë drejtim të marrë përgjegjësitë e veta.

b. Aftësia kufizuar dhe Karta Sociale Evropiane (1961), Protokolli Shtesë i Kartës Sociale Evropiane përshtatur për një sistem Ankesash Kolektive (1995), dhe Karta Sociale Evropiane e Rishikuar (1996)

Të Drejtat civile dhe politike nuk është se mbulojnë plotësisht fushën e të drejtave të njeriut. Në të vërtetë do të ishte ideale që në fushën e mosdiskriminimit të viresh theksi në mbështetjet ekonomike dhe sociale po dhe aq sa bëhet për zotërimin e të drejtave klasike civile dhe politike. Të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore janë të përfshira në tërë gjerësinë e nocionit të të drejtave të njeriut dhe janë në një rezonancë të veçantë me kontekstin e aftësisë së kufizuar. Në të vërtetë, aftësia e kufizuar është një nga fushat më të mira ku mund të ndërtohen (jo vetëm të pohohen) ndërvarësitë dhe pandashmëritë i këtyre dy grupeve të të drejtave.

Karta Sociale Evropiane të vitit 1961 është ekuivalenti rajonal Evropian i Paktit Ndërkombëtar të OKB-së mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (1966). Titulli i statutit është çorientues pasi ai në fakt është një traktat ligjërish detyrues, ndonëse qysh në fillim të formulimit ishte mjaft i dobët.

Pjesa I përshkruan 19 parimet e përgjithshme nëpërmjet të cilave palët kontraktuese zotohen për të respektuar në formulimin e politikave përkatëse kombëtare ekonomike dhe sociale. Pjesa e dytë shpall në detaje të drejtat (nenet 1-19) të cilat i korrespondojnë këtyre parimeve. Pjesa III (neni 20) ka të bëjë me llojet e «marrëveshjeve» që Palët Kontraktuese marrin përsipër për ratifikimin e tekstit të tyre. Pjesa IV (nenet 21-29) detajon kërkesën e raportuar që shoqëron marrëveshjet e marra nga Palët e veçanta Kontraktuese. Sipas Pjesës 1:

Palët Kontraktuese pranojnë si qëllimin e politikës së tyre, ndjekjen me anë të gjitha mjeteve përshtatshme, në karakter kombëtar dhe ndërkombëtar,

të arritjes së kushteve të mëposhtme në kuadrin e të cilave do të mund të realizoheshin efektivisht të drejtat dhe parimet: [19 parimet për të ndjekur]. Shumica e parimeve kanë një rëndësi të përgjithshme për të gjitha të drejtat dhe një rëndësi të konsiderueshme të tërthortë në kontekstin e aftësisë së kufizuar. Ato përfshijnë parime të tilla si mundësia për të fituar një jetesë nëpërmjet ushtrimit të një profesioni të lirë (Parimi 1), e drejta për kushte të mira të punës (parimi 2), e drejta për të shfrytëzuar mundësitë për trajnimin profesional (parimi 10), e drejta për përfituar nga masat që i mundësojnë personit të gëzojë standardin më të lartë të mundshëm të shëndetit (parimi 11), dhe e drejta për të përfituar nga shërbimet sociale (parimi 14). Personat me aftësi të kufizuara janë të përmendur qartazi në të dy nenet 9 dhe 10, si dhe Parimi 15 dhe neni 15 zbatohet specifikisht për rastin e personave me aftësi të kufizuara.

Karta ishte subjekt i tre dobësive strukturore që ia vlen të përmendet. Dobësia e parë kishte të bënte me një ngrënie normash. Normat përkatëse të Kartës origjinale ishin mjaft të zbrazura, dhe dukeshin më tepër të projektuara për të vepruar në një kohë të caktuar si shërbim jo i përshtatshëm ndaj realitetit bashkëkohor të politikës sociale në Evropë, sesa si një motor nxitës ndaj çdo lloj proces ndryshimi të vërtetë shoqëror.

Një dobësi e dytë kishte të bënte me detyrimet që jepeshin aty. Përveç nga të qenit e nevojshme për të vepruar në përputhje me të drejtat themelore të caktuara (të cilat nuk përfshijnë nenin 15), çdo Palë Kontraktuese kishte liri veprimi për ti pranuar nenet e mbetura në bazë të një marrëveshje. Rezulton bile që një Palë Kontraktuese mund të zgjedhë edhe jashtë nenit origjinal 15.

Akoma edhe një dobësi e tretë kishte të bënte me «mekanizmin e zbatimit» të Kartës Sociale, e cila thjesht linte me detyrim dhënien e raportimeve periodike në Këshillin e Evropës dhe tek një komision ekspertësh të pavarur (dikur i quajtur Komitetit të Ekspertëve të Pavarur për Kartën Sociale Evropiane dhe tani Komiteti Evropian i të Drejtave Sociale). Sidoqoftë, edhe pse Komitetit i mungon kompetenca për të nxjerrë ligje «të detyrueshme», prapëseprapë ai ka ndërtuar një trup të konsiderueshëm «rastesh ligjore» që përgjithëson interpretime të Kartës. Komiteti i Ministrave miraton një rezolutë në fund të çdo cikli mbikëqyrës duke interpretuar Nene dhe vende të caktuara. Ai gjithashtu ka fuqinë për të nxjerrë rekomandime të shumta specifike që i drejtohen Palëve të veçanta Kontraktuese të cilat nuk arrijnë të realizojnë përmbushjen e detyrimeve e tyre sipas Kartës.

Duke ju referuar veçanërisht Parimit 15 që flet mbi aftësinë e kufizuar, del se: 15. Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë për tu aftësuar, për tu riaftësuar profesionalisht dhe për tu sistemuar, pavarësisht origjinës dhe natyrës së tyre të aftësisë së kufizuar.

Theksi mbi trajnimin profesional u bë në përshtatje me opinionin e kohës. Në Nenin përkatës 15 lexohet:

15. Me synimin e sigurimit të ushtrimit efektiv të së drejtës së njerëzve me aftësi të kufizuar fizike ose mendore në drejtim të riaftësimin profesional, të rehabilitimit dhe të sistemimit të tyre, Palët Kontraktuese marrin përsipër:

(1) të merren masa e nevojshme në drejtim të sigurimit të mjeteve për trajnim, nëse është e nevojshme nëpërmjet angazhimit të institucioneve të specializuara, publike ose private;

(2) të merren masat e nevojshme në drejtim të punësimit të personave me aftësi të kufizuar, të ngritjes së shërbimeve të specializuara, të nxitjes së punësimit të përkujdesur, të nxitjes së punëdhënësve të pranojnë në punë personat me aftësi të kufizuara.

Natyrisht si Parimi 15 po ashtu edhe neni 15, dolën si të konceptuara fillimisht nga një mentalitet social, dhe jo të nisura prej një mentaliteti që zbaton parimet e të drejtave të njeriut apo e shanseve të barabarta. Në të vërtetë kështu ishte pavarësisht se në fakt Neni 15 u hartua gjoja për t'ju kushtuar të drejtave të njeriut. Nuk kishte asgjë të pazakontë këtu për deri sa Karta që shtronte tezat për të drejta të barabarta tek njerëzit me aftësi të kufizuara, nuk datonte as në një horizont të largët. Lejimi i qasjes për mirëqenie dhe rehabilitim u pa si faktor që i kishte ezauruar të drejtat e njeriut ndaj grupit të aftësisë së kufizuar.

Sidoqoftë, prapëseprapë Komiteti Evropian i të Drejtave Sociale ka interpretuar bujarisht nenin 15. Në ciklin e tij të parë të konkluzioneve (raportet mbi implementimin e Kartës që janë të lëshuara në mënyrë periodike nga Komiteti) Komiteti e komentoi nenin 15 si më poshtë vijon: Për një kohë të gjatë ndihma ndaj të gjymtuarit ishte klasifikuar së bashku me ndihmën ndaj të moshuarit; që nga lufta e dytë botërore, ndihma për personat e gjymtuar është trajtuar në linja të ndara, nën ndikimin e legjislacionit anglo-sakson. Politikat tradicionale të asistencës tashmë ka dalë mode dhe legjislacioni për këtë kategori e vë theksin në drejtim të trajnimeve profesionale dhe në atë të rehabilitimit dhe të integritimit të tyre brenda shoqërisë.

Sipas interpretimit të mësipërm, qëllimi thelbësor i Nenit 15 ka qenë për të mundësuar personat në fjalë që të punojnë dhe të jenë të pavarur. Në përgjithësi Karta e pasqyron këtë prirje, dhe pasi i referohet njerëzve të gjymtuar në nenet 9 dhe 10, shtron të drejtën e personave me aftësi të kufizuara fizike dhe mendore për aftësim, riaftësim profesional dhe për rivendosjen sociale në nivelin e të qenit me të drejta të ndara shoqërore. Të drejtat e tilla janë të imagjinueshme nëse do të mungonin mjetet për ti bërë ato efikase, dhe për këtë Karta ka rekomanduar disa dispozita të përfshira tashmë në Organizatën përkatese Ndërkombëtare të Punës (ILO).

Sipas Nenit 15 të Kartës së, Palët Kontraktuese zotohen për tu garantuar personave me aftësi të kufizuara:

- Objektet e trajnimit, duke përfshirë këtu, kur është e nevojshme, të institucioneve të specializuara (paragrafi 1);

- . Se ngritja e tyre do të zhvillohet nëpërmjet organizimit të shërbimeve të specializuara, të punësimit të përkujdesur dhe masave për të inkurajuar punëdhënësit të pranojnë në punë personat me aftësi të kufizuara si fizike po ashtu mendore (paragrafi 2)

Edhe pse synimi mund të ketë qenë zgjerimi drejt qasjes tradicionale, mbetet fakti që teksti fsheh një kontradiktë midis mbështetjes në masat e specializuara, të ndara dhe/ose të synuara me masat tërësore. Për më tepër, funksionimi aktual i Nenit 15 nuk ka sukses në mbajtjen e ritmit me një varg të çështjeve të diskriminimit të aftësisë së kufizuar që mund të dalin në pah. Për shembull, në analizën e raporteve të Shteteve, të bërë nga ana e Komitetit Evropian për të Drejtat Sociale, një problem që doli në pah ishte trajtimi njerëzve me aftësi të kufizuara që nuk kanë qytetarinë.

Italia u gjet në kundërshtim me nenin 15 për shkak të sasisë së tepërt dhe të pashpjegueshme të personave me aftësi të kufizuara të cilët ishin të papunë, dhe që e kërkonin me zell hyrjen në tregun e punës.

Ishte e qartë se qysh nga mesi i viteve 1990 Karta mjerisht kishte dalë mode. Por një gjë rezultonte që shumë kushtetuta evropiane deri atëherë kishin futur në legjislacionin e tyre të paktën disa prej të drejtave ekonomike dhe sociale. Ndoshta shembulli më i mirë është Kushtetuta fundit finlandeze i vitit 1995. Dalja e demokracive të reja nxjerr në pah nevojën për tu përqendruar më shumë në zotërimin e vërtetë së këtyre të drejtave dhe në largimin prej retorikës.

Dy rezultate konkrete pasuan qysh nga procesi i reflektimit të filluar në fillim të viteve 1990. Rezultati i parë ka të bëjë me «zbatueshmërinë». Një Protokoll Shtesë i hartuar në vitin 1995, i cili sapo të ratifikohej prej një shteti anëtar të veçantë, do të mundësonte ndonjë Organizatë Ndërkombëtare Jo Qeveritare (që gëzon një status konsultativ me Këshillin e Evropës) për të paraqitur një «ankesë kolektive» kundër atij shteti para Komitetit Evropian të të Drejtave Sociale (neni 1). Së paku tri organizata joqeveritare ndërkombëtare evropiane që mbulojnë aftësinë e kufizuar kanë këtë të drejtë për momentin. Për këtë status mund të aplikojnë edhe Organizata të Tjera Jo Qeveritare. Sipas nenit 2 të protokollit shtesë, Palët Kontraktuese mund të zgjedhin për të pasur këtë të drejtë thjesht OJQ-të kombëtare (p.sh., Forumi i Personave me Aftësi të Kufizuara, e cila është thjesht një organizatë kombëtare për aftësinë e kufizuar në Irlandë). Ratifikimet mjaftueshme janë mbledhur tashmë për të mundësuar atë që ky Protokoll Shtesë të bëhet operativ në lidhje me ato Shtete Anëtare që e kanë nënshkruar atë. Në të vërtetë, tetë ankesa kolektive tashmë janë depozituar. I pari në fjalë ka të bëjë me punën e fëmijëve, dhe është bërë nga Komisioni Ndërkombëtar i Juristëve (me seli në Gjenevë) kundër Portugalisë. Asnjë prej ankesave nuk është lidhur deri më tani me aftësinë e kufizuar, por ndoshta kjo është vetëm një çështje kohe para se ata ta bëjnë. Kjo konventë, mund të shërbejë gjithashtu si një forum i dobishëm

për OJQ-të ndërkombëtare dhe ato të tjera për të diskutuar diskriminimin në lidhje me të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore dhe për ndërtimin e programeve përkatëse.

Rezultati i dytë konkret ka të bëjë me thelbin. Normat janë ripunuar tërësisht, dhe rezultati ishte Karta Sociale Evropiane e rishikuar e vitit 1996 Më e rëndësishme për qëllimet tona, është Parimi 15 që është modernizuar plotësisht dhe riformulohet për të përfaqëuar filozofinë e shanseve të barabarta (megjithëse jo aq perfekt). Ajo tani lexon:

Parimi 15.

Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë për pavarësi, integrim social dhe pjesëmarrje në jetën e komunitetit.

Neni përkatës 15 tani lexon:

15. Me synimin për të siguruar personat me aftësi të kufizuara, pavarësisht nga mosha dhe natyra dhe origjina e aftësisë së kufizuar të tyre, ushtrimin efektiv të së drejtës për pavarësi, integrim social dhe pjesëmarrje në jetën e komunitetit, Palët angazhohen, në veçanti:

1. për të marrë masat e nevojshme për të siguruar personave me gjyftime orientim, arsim dhe trajnim profesional në kuadrin e skemave të përgjithshme kur është e mundur ose, kur kjo nuk është e mundur, nëpërmjet organeve të specializuara, publike ose private;

2. për inkuadrimin e tyre në punësim nëpërmjet të gjitha masave që tentojnë për të inkurajuar punëdhënësit për ti punësuar dhe mbajtur personat me aftësi të kufizuara në mjedisin e zakonshëm të punës dhe për ti përshtatur kushtet e punës në bazë të kushteve të gjymtimit të tyre ose, kur kjo nuk është e mundur për shkak të pengesave të veçanta të aftësisë së kufizuar, duke e sistemuar në kushtet e punësimit të përkujdesur në përputhje me nivelin e aftësisë së kufizuar. Në disa raste, këto masa mund të kërkojnë sigurimin kushteve dhe shërbimeve mbështetëse të veçanta;

3. për arritjen e integritit të tyre të plotë social në jetën në bashkësi veçanërisht nëpërmjet marrjes së masave që përfshijnë ndihmën teknike të cilat kontribuojnë në drejtim tejkalimit të pengesave në komunikim dhe në lëvizje dhe duke i mundësuar shfrytëzimin e shërbimeve të transportit, ambienteve të strehimit, aktiviteteve kulturore dhe të dëfrimit.

Është mjaft e qartë se hartuesit e nenit të rishikuar¹⁵ morën përgjegjësitë për tu zbatuar në të gjithë botën tezat e së drejtës të cilat më parë bazoheshin në mirëqenien.

Përveç një reference në parathënien e saj, Karta origjinale e vitit 1961 nuk përmbante asnjë dispozitë ligjore që lidhesh me diskriminimin. Është interesante, një dispozitë e re dhe specifike që iu shtua Kartës së Rishikuar Sociale (1996) për të garantuar mos-diskriminimin në lidhje me të drejtat e parashtruara të Kartës (Pjesa e V, Neni E). Teksti kopjon pothuajse fjalë për

fjalë Nenin 14 të KEDNJ-së. Prandaj ajo nuk e liston qartazi aftësinë e kufizuar tek gjërat që nuk duhen diskriminuar. Megjithatë, Komiteti Evropian i të Drejtave Sociale ka theksuar në ligjshmërinë e tij se shkaqet e renditura në klauzolat e Kartës për mos-diskriminimin nuk janë të plota.

Prandaj është e mundshme që nëse u prezantua një rast i vet, Komiteti Evropian i të Drejtave Sociale do të interpretonte frazën «status tjetër» të përfshirë si persona me aftësi të kufizuara.

Po me të njëjtën rëndësi, Protokollin Shtesë do ti kërkojë Kartës së Rishikuar Sociale për ato shtete që të ratifikojnë të dy instrumentet (Pjesa e IV, neni D i Kartës së Rishikuar). Karta e Rishikuar në kombinim me Protokollin Shtesë mund të jetë me vlerë të madhe.

Kjo mundësohet plotësisht nëpërmjet llojit të duhur të ratifikimit që OJQ-të dhe OJQ-të ndërkombëtare të aftësisë së kufizuar, të cilët janë tashmë në vijën e parë të monitorimit të abuzimeve të të drejtave, të jenë në gjendje të përdorin mekanizmin e ankesave kolektive në argumentimin e çështjeve të mos-diskriminimit para Komisionit Evropian për të Drejtat Sociale. Kjo do të thotë se çështjet e diskriminimit të cilat mbulojnë një gamë të gjerë fushash të politikës sociale do të mund të ajrosen në Strasburg, pasi në të kemi zberthyer në detaje mënyrën se si zhvillohet mekanizmi dhe saktësisht çfarë ratifikimesh duhen bërë.

c. Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Dinjitetin e Njeriut në lidhje me zbatimin e Biologjisë dhe të Mjekësisë: Konventa mbi të Drejtat e Njeriut dhe Biomjekësinë (1997)

Kjo konventë është shumë e rëndësishme në kontekstin e aftësisë së kufizuar për një numër arsyes. Para së gjithash, shkenca mund të marrë informacion i cili mund të përdoret në dëm të individëve. Gjëja interesante në lidhje me faktet «objektive» shkencore është se ata kanë tendencë që të përshtaten me determinizmin social. Prandaj, janë të nevojshme disa mekanizma që kanë të bëjnë me përdorimet dhe abuzimet e një informacioni të tillë.

Së dyti, brishtësia njerëzore sjell shumë rreziqe. Ajo mund të përkeqësojë edhe rreziqet «normale» që vijnë nga marrëdhëniet e natyrshme të pabarabarta midis pacientit dhe mjekut. Ajo tenton ti shmangë individët nga proceset vendim-marrëse që kanë të bëjnë me ata, dhe kjo nga ana tjetër për fat të keq tenton të ketë pasoja drastike në qëndrimet që do të mbanin njerëzit që janë në pozitat e pushtetit dhe të përgjegjësisë. Në rastin më të keq të nxjerrë prej historisë, brishtësia e personave me aftësi të kufizuara është shfrytëzuar për të justifikuar sjelljen e eksperimenteve të mbrapshta dhe në çuarjen e personave me aftësi të kufizuara nëpër gjyqe të pakuptimta apo të këqija klinike. Pra, kontrolle të kujdesshme janë kërkuar, për mbrojtjen e të drejtave dhe

interesave të personave vulnerabël, edhe kur procedurat në fjalë fuqimisht mund të çojnë në përparime të trajtimeve dhe teorive mjekësore

Roli i ligjit është në këmbënguljen për një dinjitet dhe për një vlerë të barabartë e të pandarë ndër të gjitha qeniet njerëzore.

Konventa Biomjekësore e Këshillit të Evropës për fat të keq nuk ja ka arritur këtij qëllimi. Ajo vetëm sa i prek disa parime të rëndësishme për të drejtat e njeriut, për shembull, duke deklaruar në nenin 1 që palët do të:

mbrojnë dinjitetin dhe identitetin e të gjitha qenieve njerëzore dhe të garantojnë secilit, pa dallim, respekt për integritetin e tyre, për liritë themelore dhe për të drejtat e tjera në lidhje me aplikimin e biologjisë dhe mjekësisë. [theximi është shtuar]

Megjithatë, Konventa nuk ka sukses për të mbrojtur të drejtat njerëzore të personave me aftësi të kufizuara në kontekstin e kërkimeve gjenetike dhe eksperimentimit mjekësor. Në veçanti, Konventa Biomjekësore lejon që të kryhet eksperimentim mjekësor jo-terapeutik për personat që nuk mund të informojnë pëlqimin e tyre. Grupet e të drejtave të njeriut, të tilla si Komisioni Ndërkombëtar i Juristëve, dhe të tjera organizata joqeveritare, të tilla si Njerëz Ndërkombëtarë me Aftësi të Kufizuara, e kritikuan traktatin në kohën kur ajo po përpilohesh nga Asambleja Parlamentare për shkak të këtyre apo të tjera mangësive. Disa grupe kombëtare të aftësisë së kufizuar, veçanërisht organizata të njohura në Gjermani, i bindën qeveritë e tyre që të mos nënshkruajnë traktatin pas miratimit të saj në vitin 1997. Në një takim ekspertësh të OKB-së për normat dhe standardet ndërkombëtare që lidheshin me Aftësinë e Kufizuar, e cila u zhvillua 13-17 dhjetor 1999, në Hong Kong (Rajon i veçantë administrativ në Republikën Popullore të Kinës), Konventa Evropiane Biomjekësore u rishikua në bazë të perspektivave të të drejtave të aftësisë së kufizuar. Në veçanti, dispozita e lidhur me eksperimentimin jo-terapeutik u veçua për faktin se u pa në mospërputhje me nenin 7 të ICCPR-së dhe me Kodin e Nyrembergut të vitit 1947. Të dyja këto dokumente të fundit të të drejtave të njeriut deklarojnë që hulumtimet mjekësore nuk do kryhen asnjëherë pa informimin e pëlqimit.

d. Aftësia e kufizuar dhe Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin Çnjerëzor ose Degradues apo Ndëshkimit (1987) (CPT)

Ndalimi zyrtar i torturës, i trajtimit çnjerëzor dhe degradues përmbahet në Nenin 3 të ECHR-së. Miratimi i një konvente të tërë që trajtonte aspektin në fjalë, u nënkuptua nëpërmjet shtimit të Nenit 3 që zhvillonte një mekanizëm nxitës (jo-të ligjshëm) i cili do ti mundësonte bashkësisë ndërkombëtare së pari të pengonte dukjen e torturës.

Kjo konventë ka aplikime të dukshme dhe të rëndësishme në kontekstin

e personave me aftësi të kufizuara të cilët janë të privuar nga liria nga një autoritet publik. Ajo mbulon personat me aftësi të kufizuara që janë mbajtur për pyetje nga policia, i burgosur në sistemin penal, apo i burgosur në një institucion mendor apo ndonjë vend tjetër të kujdesit komunitar.

The Convention establishes a European Committee for the Prevention of Torture, Inhuman and Degrading Treatment (CPT). Article 1 asserts that the Committee shall:

Konventa krijon një Komitet evropian për Parandalimin e Torturës, Trajtimin Çnjerëzor dhe Degradues (CPT). Neni 1 thotë që Komisioni:

me anë të vizitave, do të shqyrtojë trajtimin e personave në heqje lirie me qëllim, nëse është e nevojshme, forcimin e mbrojtjes së këtyre personave kundër torturës dhe trajtimit apo dënimit çnjerëzor apo degradues.

Anëtarët e KPT-së janë ekspertë të pavarur dhe të paanshëm nga një shumëllojshmëri profesionesh të ndryshme, duke përfshirë jurisprudencën, mjekësinë dhe politikën në sektorin publik. Ata kryejnë vizita periodike në vendet e paraburgimit të aprovuara prej Palëve Kontraktuese dhe mund të kryejnë vizita të rastësishme; 72 vizita periodike dhe 32 vizita të rastësishme kishin bërë deri në gusht 2000. Njoftimi paraprak i një vizite duhet t'i jepet Palës Kontraktuese, dhe menjëherë pas kësaj nis vizita (neni 8). Pala Kontraktuese në fjalë duhet ti disponohet Komitetit në të gjitha mundësitë, duke përfshirë këtu lejimin e monitorimit në të gjitha ambientet e paraburgimit. Komisioni ka të drejtë të intervistojë privatisht çdo person të ndaluar; gjithashtu ka të drejtë të marrë informacion nga çdo person tjetër të cilin ai beson se mund të ofrojë informatat e duhura (p.sh., anëtarë të OJQ-ve përkatëse). Një Palë Kontraktuese mund të nxjerrë ndonjë pengesë në pranimin e ndonjë vizite, por vetëm për shkaqe të tilla të jashtëzakonshme që kanë të bëjnë me sigurinë kombëtare, me sigurinë publike ose me frikën e trazirave publike, me gjendjen shëndetësore të personit të përfshirë, dhe mund të lejojë vetëm për të kryer në pyetje urgjente (Neni 9.1). Asnjë prej këtyre justifikimeve (përveç ndoshta shkaqeve mjekësore) nuk do të përbënin pengesa në rastet e personave me aftësi të kufizuara. E drejta për të penguar vizitat nuk është absolute, dhe Komiteti është i autorizuar për të hyrë në negociatë për të bërë përpjekje drejt arritjes së një marrëveshjeje për tu lejuar.

Komiteti punon në baza konfidencialiteti. Pas çdo vizite përpilohet një raport në bazë të gjetjeve faktike krahas dhënies së ndonjë rekomandimi për përmirësim. Këto raporte shkëmbehen me palën kontraktuese dhe nuk publikohen nëse pala tjetër e kërkon një gjë të tillë. Shumica e raporteve - së bashku me përgjigjet e Palës Kontraktuese në fjalë, janë botuar në fakt me kërkesën e Palëve Kontraktuese. Nëse një Palë Kontraktuese nuk do të bashkëpunojë ose nuk bën reformat e duhura, Komiteti mund të bëjë një deklaratë publike me këtë rast. Në pajtim me kufizimet e konfidencialitetit, Komiteti bën çdo vit një raport të përgjithshëm drejtuar Komitetit të Ministrave të Këshillit të

Evropës. Ky raport i është dërguar Asamblesë Parlamentare dhe është publikuar (neni 12). Ajo përmban një përshkrim të hollësishëm të aktiviteteve të KPT-së në vitin e mëparshëm, duke bërë gjithashtu një përshkrim të thelbit të vëzhgimeve të tij dhe duke dhënë rekomandimet në një seksion të pavarur që trajton një temë e zgjedhur. KPT-ja gati gjithmonë viziton institucionet psikiatrike gjatë çdo vizite periodike. Në të paktën dy raste janë përfshirë çështjet e aftësisë së kufizuar në seksionet tematike. Raporti i tretë Vjetor , që mbulon vitin 1992, përmban një seksion të detajuar mbi shërbimet e kujdesit shëndetësor në burgje, duke përfshirë këtu një pjesë të rëndësishme që trajton standardet e duhura të kujdesit psikiatrik dhe rregullimet për të burgosurit. Raporti i tetë Vjetor, i cili mbulon vitin 1997, përmban një seksion të veçantë dhe të detajuar mbi vizitat që ka bërë Komiteti në vendet e ndalimit psikiatrik.

Ajo trajton çështje të tilla si për parandalimin e keqtrajtimit, për kushtet e jetesës dhe trajtimit të pacientëve, për personelin, për mjetet e forcës, si dhe për masa mbrojtëse në kontekstin e angazhimit civil .

Për sa i përket keqtrajtimit, në Raport pjesërisht thuhet:

Autoriteti moral i Rregullave Standarde të OKB ka ndihmuar për të legjitimuar zhvendosjen (nga qëndrimi social në atë të së Drejtës) dhe miratimi i ADA-s ka treguar fuqimisht që ky ndryshim është i mundur dhe i dobishëm si për individët po ashtu edhe për komunitetet e tyre. Nëse ka një mesazh të gjerë në lëvizjen e të drejtave të aftësisë së kufizuar, ky është se qytetari do të thotë qasje të barabartë dhe të efektshme në të gjitha dimensionet e jetës.

Së dyti, duke pranuar tezën e zhvendosjes në nivelin e ideve është një gjë, dhe për ta bërë atë një realitet është krejt tjetër. Studimi ynë krahasues gjendet në një shumëllojshmëri të gjerë të metodave ligjore. Deri në një shkallë, kjo është mjaft e kuptueshme duke pasur parasysh diversitetin e kulturave dhe sistemeve ligjore në botë. Bota është aq e larmishme sa që kjo gjë vihet re edhe tek popullsia e njerëzve me aftësi të kufizuara. Megjithatë, edhe në mes të këtij diversiteti, del në pah një faktor thelbësor. Legjislacioni më i mirë (i çfarëdo shumëllojshmërie) ka tendencë të jetë ai që krijon hapësirë sociale, ekonomike dhe publike për diferencat e aftësisë së kufizuar. Domethënë, ligji duhet të njohë se trajtimi i çështjeve rigorozisht në mënyrë të njëjtë, në vetvete, i vë një zgjedhë pabarazisë mbi njerëzit me aftësi të kufizuar. Për më tepër, kjo pabarazi nuk mund të hiqet pa nevojshmërinë e një sistemimi në diferencën e aftësisë së kufizuar. Këtej del domethënia kryesore e konceptit të «sistemim i arsyeshëm». Kjo, arritja e kurorëzimit të ADA-s, është elementi kritik që përshkon të gjithë legjislacionin efektiv.

Është e qartë se, punë e rëndësishme duhet të bëhet në edukimin e njerëzve me kultura të ndryshme ligjore në lidhje me natyrën dhe funksionimin e këtij koncepti, pa të cilat legjislacioni ose mund të dështojë ose do të mund të mos arrinte aq objektiva sa duhej.

Së treti, organizatat rajonale – si Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian - mund të veprojnë si bartës të fuqishëm të besimit për fitore. Ata mund të lehtësojnë në krijimin e shanseve të barabarta dhe në arritjen e të drejtave të njeriut nëpërmjet ndjekjes së linjave kombëtare të veprimit. Dhe ata mundet që brenda sferës së tyre të kompetencave, të miratojnë masa për arritjen e ndryshimeve.

Cilado strategji që synon ndryshimin duhet të ketë parasysh rolin (katalitik apo ndryshe) të organeve të tilla rajonale që kërkojnë për të shfrytëzuar autoritetin e tyre moral përveç atij ligjor dhe politik.

Konkluzioni ynë i katërt është se axhenda e diskriminimit - edhe pse kjo është e rëndësishme - nuk shter spektrin e plotë të çështjeve që ndikojnë në zotërimin e plotë të drejtave të njeriut nga personat me aftësi të kufizuara. Ligji kundër diskriminimit është një mjet i domosdoshëm, por ajo duhet të pranohet sinqerisht se edhe pse legjislacioni në fuqi mund të hapë dyert, ajo nuk mund të lehtësojë njerëzit që hyjnë përmes këtyre dyerve, nëse nevojat e tjera nuk janë plotësuar. Me fjalë të tjera, një shqetësim për liri formale duhet të kombinohet me shqetësimin tjetër pikërisht të atyre mjeteve me të cilat kjo liri është e ushtruar. Me këtë rast nuk duhet të harrohet rëndësia e arritjes së të drejtave aktuale ekonomike, sociale dhe kulturore për personat me aftësi të kufizuara. Me këtë, nuk kemi parasysh ndjekjen e një agjende të politikës sociale që efektivisht i fut njerëzit në kurthin e një kafazi të praruar të mirëmbajtjes pasive, ashtu siç ka ndodhur në të kaluarën. Përkundrazi, bëhet fjalë për një politikë sociale që synon për të dhënë mbështetje pozitive në mënyrë që tu mundësohet njerëzve maksimumi i lirive të tyre formale.

Së fundi, legjislacioni më përparimtar i aftësisë së kufizuar është komercializuar politikisht mbi bazën e faktit se ajo është një «faktor produktiv» në ekonominë e tregut. Me fjalë të tjera, një legjislacion i tillë kontribuon në më shumë vendime racionale të tregut të punës dhe për një aktivitetet më të madh të përgjithshëm ekonomik. Ne për këtë biem dakord fuqimisht. Por ne gjithashtu mendojmë se një legjislacion i tillë vepron si një “faktor civilizimi «në çdo shoqëri që respekton ndryshimet dhe ka për qëllim të krijojë shoqëri që janë me të vërtetë të hapura për të gjithë.

PJESA E DYTË

*Sistemi i burgjeve dhe karakteristikat
e pergjithshme te zhvillimit***Hyrje**

Sistemi i Burgjeve Shqiptare është pjesë e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri, i cili përfshin një numër të konsiderueshëm institucionesh dhe organizatash.¹ Këto organizma veprojnë brenda një kuadri rregullash kushtetues dhe ligjorë, që përcaktojnë jo vetëm kompetencat e tyre, por edhe kufijtë ndarës dhe rastet e bashkëveprimit institucional midis tyre në funksion të dhënies dhe zbatimit të drejtësisë. Pas pothuajse 21 vitesh pluralizëm politik, është mjaft interesante të analizohet se si shërbimet që ofrohen në Sistemin e Burgjeve janë materializuar dhe kanë ndikuar në rritjen e aksesit në drejtësi, trajtimin e personave me liri të kufizuar dhe cili është kontributi i këtij sistemi në zhvillimin e shoqërisë shqiptare, nëpërmjet nxitjes e përshpejtimin në integrimin evropian. Burgjet dhe paraburgimet janë vende ku personit i privohet liria dhe i kufizohet komunikimi me botën e jashtme. Ky komunikim është i kufizuar, pasi mungon organizimi i aktiviteteve të përditshme dhe rituale që bëheshin më parë dhe bëhet përshtatje me rregullat e burgut, të cilat përcaktojnë limitet e sjelljes së një personi në burg. Vendimet për sistemin e burgjeve shqiptare nuk janë të lehta, pasi investimet dhe strategjitë në këtë sistem shihen gjithmonë në dy kahe; fleksibiliteti në trajtimin dhe komunikimin e të burgosurve që i siguron çdo personi hapësirën dhe dinjitetin personal dhe krijimin e një sistemi të sigurt për shoqërinë e lirë. Të punosh dhe të menaxhosh një burg nuk është e lehtë. Stafet që janë të punësuar në këtë sistem duhet të veprojnë me inteligjencë, të

¹ Gjykatat; Këshilli i Lartë i Drejtësisë; Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor; Konferenca Gjyqësore Kombëtare; Shkolla e Magjistraturës; Ministria e Drejtësisë; Prokuroria; Komisioni i Reformës Ligjore; Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve; Sistemi i Përmbarimit Gjyqësor; Qendra e Publikimeve Zyrtare; Komiteti Shqiptar i Birësimeve; Profesionet e Lira; Avokatura e Shtetit; Instituti i Mjekësisë Ligjore.

jenë të pajisur me aftësi të larta profesionale, e për më tepër duhet të njihin në përpikmëri rregullat funksionale dhe ligjore të një burgu. Në manualin e drejtimit të lartë në burgje, vlerësohet puna e bërë nga personeli i burgut dhe vihet në dukje se publiku duhet të rikujtohet herë pas herë se puna në burg është një shërbim i rëndësishëm publik. Siç theksohet dhe në raporte të ndryshme ndërkombëtare në menaxhimin e sistemit të burgjeve, specifikohet se është organizata më komplekse dhe problemet janë disa nga më të vështirat.² Nisur nga aksiomat e komunikimeve ndërpersonale, niveli i përmbajtjes së mesazhit dhe niveli i marrëdhënies midis stafeve, janë elementë shumë të rëndësishëm në këtë sistem, pasi dështimi në komunikim në këto dy nivele, cenon integritetin dhe sigurinë e gjithë sistemit të burgjeve.

Pas viteve '90 zhvillime të reja politike e sociale ndodhën në Shqipëri. Një rëndësi e veçantë iu dha luftës kundër krimit të organizuar dhe ndërtimit të një shteti demokratik, në të cilin ekzistonte një sistem eficient i së drejtës penale dhe demokratizimit të organeve përbërëse të saj. Duke qenë se një nga dokumentet kryesore ku bazohet drejta penale ishte Kodi Penal, u pa e arsyeshme ndryshimi i këtij kodi. Me miratimin e Kodit të ri Penal (1 qershor 1995) politika ndëshkimore në Shqipëri ndryshoi tërësisht. Si fillim u hoq dënimi me vdekje dhe filloi aplikimi i dhënies së masave të tjera si burgim i përjetshëm, ose gjobë të cilat nuk ishin shumë lehtësuese.³ Nëse do t'i referohemi historisë së viteve të regjimit komunist në Shqipëri, burgjet shiheshin si vende ndëshkimi çnjerëzore, ku të dënuarit trajtoheshin dhe torturoheshin në mënyra të papërshtueshme. Me rrëzimin e sistemit komunist dhe ardhjen e demokracisë në vend, instancat ndërkombëtare i dhanë një rëndësi të veçantë, përpos zhvillimeve të tjera, respektimit të drejtave të njeriut, në të cilin bënin pjesë dhe burgjet. Sipas Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve "sistemi i institucioneve të vuajtjes së dënimit, është një nga organizmat ku reformat demokratike kanë sjellë një ndryshim tërësor. Ndryshimet kanë ardhur paralelisht me ndryshimet konceptuale, logjistike, financiare dhe infrastrukturore. Në ditët e sotme, jemi duke punuar që institucionet penale të mos shihen vetëm si vende ndëshkimi, por si mjete për ri-integrimin e të dënuarve në shoqëri."⁴ Në Shqipëri ndodhen 22⁵ institucione penale, prej të cilave:

5 Institucione të sigurisë së lartë

5 Institucione të sigurisë së zakonshme

9 Institucione paraburgimi

² Drejtimi Human i Burgjeve, Manual për Drejtimin e Lartë të Sistemit të Burgjeve, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, prill 2009, fq. Kapitulli III, fq. 1-2.

³ Analizë e Drejtësisë Penale në Shqipëri- Prezenca e OSBE në Shqipëri, 2006

⁴ Sistemi Penitenciar Shqiptar, Manual Informues, fq. 3

⁵ Tiranë (Jordan Misja, Mine Peza, Ali Demi), Vaqarr, Durrës, Kavajë, Peqin, Lezhë, Burrel, Tepelenë, Vlorë, Sarandë, Berat, Tropojë, Kukës, Korçë, Krutë, Fushë-Krutë, Spitali i Burgut, Rrogozhinë, Lushnjë dhe Elbasan

Institucione të veçanta

1 Qendër Spitalore e Burgjeve

1 Institut i të Miturve në Kavajë

1 Institucion i Veçantë në Krujë

Institucionet janë të klasifikuara në burgje të sigurisë së lartë, sigurisë së zakonshme dhe sigurisë së ulët, institucione të veçanta dhe qendra paraburgimi. Kapacitetet maksimale janë për 4537 persona.⁶ Moshë dhe cilësia e institucioneve penitenciare ndryshojnë nga njëri-tjetri. Institucionet e reja të hapura gjatë viteve 2008-2012,⁷ përputhen plotësisht me të gjitha standardet ndërkombëtare.⁸ Të gjitha institucionet që janë trashëguar nga sistemi i kaluar kanë një infrastrukturë të dobët dhe nuk përmbushin standardet optimale për trajtimin e personave me liri të kufizuar. Për përmirësimin e infrastrukturës së burgjeve dhe paraburgimeve, në vitin 2003 – 2004, u hartua Master Plani për Sistemin Shqiptar të Paraburgimit, si një projekt Binjakëzimi i BE-së ndërmjet Ministrisë Shqiptare të Drejtësisë dhe Ministrisë Federale Austriake të Drejtësisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve të Republikës Sllovaqe. Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Dënimin Çnjerëzor ose Poshtëruar (CPT) ka rekomanduar që: “Duhet të përpilohen plane për ndërtimin e ambienteve të burgjeve të reja krahas zhvillimit të një politike strategjike që trajton një gamë të çështjeve që mundësojnë kushtet e ndalimit, duke pasur parasysh kushtet klimaterike, menaxhimin e përshtatshëm të burgjeve dhe një mundësi për rehabilitimin e të burgosurve. Politika strategjike duhet të trajtojë marrjen e masave dhe mjeteve për aktivitetet e përbashkëta jashtë qelisë, ambientet e vizitave (të hapura dhe të mbyllura), njësitë e pranimit dhe një gamë të njësisë të tjera që lejojnë klasifikimin e përshtatshëm të burgosurve”.⁹ Numri dhe lloji i qelive paraqitet si më poshtë:

Kushtet e institucioneve penale në Shqipëri mund të ndahen në dy kategori: Institucione të cilat janë të trashëguara nga sistemi i kaluar si psh. 302 tek Mine Peza, Tepelena, Burreli, Jordan Misja, etj, si dhe institucione të cilat janë ngritur pas viteve '90. Në një intervistë dhënë për gazetën Shqip, Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve thekson se “Ndërtesat në burgjet e vjetër dhe veçanërisht qendrat e ndalimit të policisë që vazhdojnë të përdoren, janë në standarde nën nivel. Megjithatë, vit pas viti janë bërë ndërhyrje rikonstruk-

⁶ Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, janar 2012

⁷ Durrës, Kavajë, Fushë-Krujë, Korçë, Vlorë dhe Elbasan

⁸ Po aty, fq 11

⁹ Raporti i CPT-së për Qeverinë shqiptare mbi vizitën në Shqipëri të realizuar nga Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Dënimin Çnjerëzor ose Degradues (CPT) nga data 16 deri në 20 qershor 2008

sioni për përmirësimin e situatës dhe adaptimin e ambienteve".¹⁰ Raporti i vitit 2011 i Avokatit të Popullit, identifikonte disa probleme të tjera të sistemit të burgjeve, ku veçohej përmirësimi i standardit të jetesës së të dënuarve dhe paraburgosurve duke investuar në mirëmbajtje, infrastrukturë dhe ndërtimin e ambienteve të reja të sigurisë.¹¹ Veçanërisht në institucionet e vjetra, ka pak ambiente të përbashkëta dhe të kohës së lirë brenda dhe jashtë zonave të ndalimit, ku të burgosurit mund të bashkohen me të tjerët. Neni 78 i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, ka parashikuar hartimin e planeve të dënimit, duke synuar individualizimin e programeve për çdo të burgosur. Qëllimi këtyre planeve është specifikimi i trajtimit të personave të privuar nga liria, bazuar në nevojat, prirjet, moshën, personalitetin, edukimin social dhe kulturor, duke synuar eliminimin e sjelljeve delikuede dhe në të njëjtën kohë ri-integrimin në familje dhe shoqëri.

Bazuar në të dhënat e vitit 2012 të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, numri mesatar i të burgosurve të trajtuar është 4750, prej të cilëve 1651 të paraburgosur.¹² Krahasimi i popullatës së burgjeve me popullatën e Shqipërisë¹³, jep një normë burgimi prej 151 të burgosur për 100 000 shtetas. Përqindja e të paraburgosurve në popullatën e burgjeve është 34%. Tendenca e popullatës së burgjeve prej vitit 2001 deri në 2011, paraqitet si në tabelën e mëposhtme: Nëse do t'i referohemi zhvillimeve më të fundit të sistemit të burgjeve, vihet re se janë bërë përpjekje për instalimin e një sistemi edukues dhe integrues, nëpërmjet zbatimit të një game të gjerë programesh sociale dhe edukuese, me synim uljen e numrit të recidivistëve, përgatitjen për lirim dhe ri-kthimin në shoqëri. Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione të tjera shtetërore, sikurse ajo e lidhur me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, me qëllim futjen e ciklit shkollor 9-vjeçar brenda sistemit të burgjeve, apo memorandumit e mirëkuptimit me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për certifikimin e kurseve të formimit profesional që zhvillohen në institucionet penitenciare, shihen si përpjekje pozitive për instalimin e një sistemi edukues në sistemin e burgjeve, duke e shndërruar këtë sistem në një mundësi riedukimi dhe emancipimi për personat me liri të kufizuar.

Analiza e hollësishme empirike bazohet në intervistat e marra të grupeve kampion të intervistuar, të cilët mund t'i ndajmë në dy kategori, përfaqësues të sistemit të burgjeve dhe ekspertë të pavarur. Metodologjia e përdorur është ajo e zgjedhjes së një rasti studimor, siç është rasti i shërbimeve dhe praktikave që zbatohen në sistemin e burgjeve shqiptare, i cili do të zbulojë

¹⁰ Gazeta Shqip, 22/02/2009

¹¹ Avokati i Popullit, Raport Vjetor 2011

¹² Analiza Vjetore e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve

¹³ Sipas të dhënave nga Instituti i Statistikës të Republikës së Shqipërisë, (maj 2007) numri i banorëve është 3,17 milionë.

programet rehabilituese që zbatohen në institucionet e mbyllura të dënimit në përgatitjen dhe përballjen e të dënuarve me botën jashtë mureve të burgut, si dhe përjasjen me rekomandimet e ndërkombëtarëve. Burimet statistikore të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, shfrytëzimi dhe analiza e akteve ligjore dhe nënligjore që kanë të bëjnë me funksionimin e sistemit dhe trajtimin e personave me liri të kufizuar, si dhe rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare për respektimin e të drejtave themelore në vendet e vuajtjes së dënimit, ndihmuan në rrumbullakimin e këtij studimi.

Intervistat e grupit kampion të përzgjedhur do të jenë në qendër të analizës së tekstit që do të kryhet duke i dhënë formë kërkimit empirik. Jam munduar t'i mbetem besnike parimit për të lundruar në mënyrë të balancuar, për të sjellë formulën e përfaqësimit objektiv në zbulimin e praktikave rehabilituese që zbatohen në sistemin e burgjeve. Për këtë u përzgjedhën si grup kampionimi 20 persona, prej të cilëve 10 ekspertë të pavarur dhe 10 punonjës socialë të punësuar në sistemin e burgjeve. Duke qenë se ky punim synonte për të mbledhur të dhëna për të kuptuar praktikatat që implementohen në sistemin e burgjeve shqiptare për rehabilitimin e personave me liri të kufizuar, nuk u synua të bëhej një ndarje e barabartë për sa i takon gjinisë së të intervistuarve. Kështu, në mënyrë rastësore u intervistuan 6 meshkuj dhe 14 femra, prej të cilëve, 3 i përkisnin moshës 25-30 vjeç, 10 i përkisnin moshës 30-35 vjeç dhe 7 i përkisnin moshës 35-40 vjeç. Lloji i intervistës së përdorur është intervistë e standardizuar me pyetje të mbyllura.

Funksionimi i Sistemit të Burgjeve

Kuadri ligjor i trajtimit të personave me liri të kufizuar

Reformimi i sistemit të komunikimit në burgje erdhi si rezultat i dy faktorëve: 1. Ratifikimi i Konventave dhe Traktateve mbi të Drejtat e Njeriut; 2. Aspekti moral, etik dhe human, në të cilin burgjet shndërrohen nga një vend ku individit ndëshkohej dhe denigrohej fizikisht dhe psikologjikisht, në një vend ku individit përfshihet në programe rehabilituese, për t'u bërë në të ardhmen pjesë aktive dhe e dobishme e shoqërisë. Implementimi i reformave në fushën legjislativë dhe institucionale ka qenë një proces që ka njohur përmirësim të ndjeshëm dhe rezultate të matshme vitet e fundit, sidomos për sa i takon hartimit dhe zbatimit të programeve rehabilituese për të burgosurit që synojnë arsimimin, formimin profesional, punësimin dhe përfshirjen në aktivitete të ndryshme edukuese dhe krijuese. Veç rolit të ekzekutuesit të vendimeve, në sistemin e burgjeve, objektiv i rëndësishëm është dhe trajtimi në mënyrë humane, ligjore dhe jo-diskriminuese i të gjithë të burgosurve. Sistemi shqiptar i burgjeve rregullohet me ligjin nr. 8331, datë 21.04.1998 "Për ekzekutimin e dënimeve penale", ligjin nr. 8328 datë 16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të burgosurve", i ndryshuar. Bazuar dhe në vijimësi të këtyre ligjeve janë miratuar disa rregullore të rëndësishme

që plotësojnë kuadrin e funksionimit të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale në Shqipëri ku përfshihen: Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 96, datë 09.03.2000 “Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve”, Urdhri i Ministrit të Drejtësisë nr. 3705/1, datë 11.05.2006 “Rregullorja e paraburgimit”, Urdhri i Ministrit të Drejtësisë nr. 4595, datë 15.07.003 “Rregullorja e Brendshme e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Urdhri i Ministrit të Drejtësisë nr. 3052/1, datë 25.05.2005 “Kodi i etikës për stafin e burgjeve, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 327, datë 15.05.2003 “Rregullorja për policinë e Burgjeve”.¹⁴ Reforma në legjislacionin penitenciar vazhdoi me miratimin e Ligjit Nr. 9888, datë 10.3.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8328, datë 16.4.1998 “për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, të ndryshuar. Ky ligj solli ndryshime, duke përmirësuar garantimin e të drejtave bazë të dënuarve për trajtimin e tyre human dhe dinjitoz në përputhje me standardet evropiane. Për të bërë të mundur zbatimin dhe monitorimin e këtyre të drejtave, ky ligj vendosi rregulla për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Një risi e këtij është ligji ishte dhe krijimi i Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës dhe kompetencat e tij si një strukturë e veçantë e Avokatit të Popullit.¹⁵

Sipas nenit 32 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve trajtimi i personave me liri të kufizuar realizohet në bazë të karakteristikave individuale të çdo të dënuari. Fokus kryesor është rehabilitimi i tyre, si dhe zhvillimi i aktiviteteve me karakter çlodhës dhe social, si dhe një sërë aktiviteteve të tjera argëtuese me qëllim ri-integrimit të tyre në shoqëri. “Trajtimi i të dënuarve bëhet duke siguruar mjediset e përshtatshme dhe në përputhje me të dhënat e personalitetit të tyre. Objektivat e trajtimit përfshijnë arsimimin, formimin profesional, zhvillimin e aftësive të tjera individuale, veprimtaritë kulturore, çlodhëse e sportive, punën, asistencën shpirtërore dhe veprimtari të tjera në grup që kanë si qëllim rikrijimin e aftësisë për ti integruar në shoqëri.”¹⁶ Trajtimi social-edukativ i të dënuarve zhvillohet me anë të programeve individuale dhe të aktiviteteve formuese, që realizohen nga ana e personelit të burgjeve të aftësuar posaçërisht në fushën e shkencave sociale, në bashkëpunim me punonjësit e tjerë të institucionit. Kontaktet me botën e jashtme dhe familjen inkurajohen dhe sigurohen sipas programeve individuale dhe grupore. Individualizimi kryhet duke verifikuar nevojat individuale dhe duke marrë parasysh kushtet dhe mjedisin social në të cilin i dënuari ka jetuar, shkaqet edukative dhe shoqërore që e kanë larguar atë nga jeta normale. Vëzhgimi bëhet në fillim të trajtimit dhe rezultatet e tij verifikohen vazhdimisht gjatë ekzekutimit, duke bërë përshtatjen e duhur.

¹⁴ Të drejtat e njeriut në Sistemin e Paraburgimit në Shqipëri 2007, Shoqata Përthyerje dhe Penal Reform International Romania, TARTARI, Tiranë 2008

¹⁵ Shih faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve

¹⁶ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 96, datë 09.03.2000 “Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve” Neni 32

Zbatimi i rekomandimeve të ndërkombëtarëve për rehabilitimin e të burgosurve

Rregullat Evropiane të Burgjeve përcaktojnë disa kërkesa në lidhje me regjimin e burgjeve. Sipas Rregullave Evropiane të Burgjeve regjimi i burgjeve u lejon të gjithë të burgosurve të qëndrojnë jashtë qelive të tyre aq orë në ditë sa janë të nevojshme për një nivel të përshtatshëm për ndër-veprimin njerëzor dhe social.¹⁷ Ky Rregull nënvizon që autoritetet e burgut nuk duhet të përqendrohen vetëm në rregullat specifike, si ato që kanë të bëjnë me punën, edukimin dhe ajrimin, por edhe të rishikojnë regjimin në tërësi të burgut për të gjithë të burgosurit për të parë që ata përmbushin kërkesat bazë për dinjitetin njerëzor. Padyshim që këto kërkesa bazë kanë ndikuar në aplikimin e një sërë strategjish dhe plan masash për standardizimin e shërbimeve në sistemin e burgjeve. Me nënshkrimin e akteve të rëndësishme ndërkombëtare si Konventa Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut dhe Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, Shqipëria merr përsipër të bëhet garant për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të individit. Nënshkrimi i këtyre marrëveshjeve si dhe rekomandimet e dhëna nga Këshilli i Evropës dhe organizata jo qeveritare që asistojnë në ndihmë të përmirësimit të sistemit të drejtësisë në Shqipëri kanë vënë përpara përgjegjshmërisë Qeverinë Shqiptare për ndërmarrjen e një reforme të mirëfilltë për të siguruar një trajtim sa më njerëzor e jo denigrues të personave me liri të kufizuar.

Protokolli Opsional i Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve të tjera Çnjerëzore dhe Degraduese (OPCAT), parashikonte ngritjen e një strukture kombëtare për parandalimin e torturës, atashuar pranë Avokatit të Popullit. Si rrjedhojë në janar të vitit 2008 u krijua Mekanizmi Kombëtar i Parandalimit të Torturës, i cili përfaqëson një profil institucional të përshtatshëm, i kompletuar me kapacitetet financiare dhe njerëzore të nevojshme për mbarëvajtjen e aktivitetit të kësaj strukture. Gjithashtu, neni 19/1, i ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, autorizon një veprimtari monitoruese dhe hetimore të pavarur, të gjithanshme dhe të plotë për çdo rast torture, trajtimi çnjerëzor dhe degradues, duke garantuar akses në çdo ambient apo zyrë, ndaj çdo zyrtari pa imunitet dhe mbi çdo dokumentacion, qoftë dhe të klasifikuar të organeve të administratës publike. Ndryshimet e kryera në mars të vitit 2010 në ligjin nr. 8328 datë 02.04.1998, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", bën të mundur shfrytëzimin e një hapësire më të madhe të Mekanizmit Kombëtar të Parandalimit të Torturës (MKPT) për të kryer detyrat e tij gjatë kontrollit të shërbimeve penitenciare. Në nenin 74 të këtij ligji, Avokatit të Popullit në rolin e MKPT-së, i njihet e drejta si subjekt i veçantë për mbikëqyrjen e zbatimit dhe realizimit të ligjit për të dënuarit dhe paraburgosurit. Ai gëzon kompetenca për të vëzhguar rregullisht trajtimin e individëve, që u është hequr liria në

¹⁷ Rregulli 25/3

vendet e ndalimit, arrestimit ose burgosjes, me qëllim që të forcohet, kur është e nevojshme, mbrojtja e individëve nga tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues. Gjithashtu, në këtë dispozitë njihet e drejta që ky institucion të paraqesë në mënyrë specifike raporte dhe rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura dhe trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues. Për të garantuar komunikimin e personave të privuar nga liria me Avokatin e Popullit, me mbështetjen e OSBE-së, në vitin 2008 u instaluan kuti postare, në institucionet penale. Për ish ambasadorin e OSBE-se, Robert Gosh projekti i Avokatit të Popullit ka një rëndësi të veçantë pasi “e konsideron këtë institucion si një agjenci kyçe, për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në Shqipëri dhe për arsye se këtij institucioni, i është dhënë statusi i mekanizmit ndërkombëtar të mbrojtjes kundër torturës nga Konventa e Kombeve të Bashkuara.”¹⁸

Në kuadrin e përbushjes së rekomandimeve të lëna nga ndërkombëtarët, rëndësi të veçantë merr plotësimi i detyrimeve që lind në kuadër të integritimit evropian të vendit. Sistemi i Burgjeve Shqiptare është pjesë e këtij procesi zbatimi i masave të cilat parashikohen në Rekomandimin 12.¹⁹ Zbatimi i ligjshmërisë në vendin e vuajtjes së dënimit, përmirësimi i trajtimit të të burgosurve përmes zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, përmirësimi të kushteve infrastrukturore të institucioneve dhe ofrimit të aktiviteteve edukuese dhe rikrijuese për personat me liri të kufizuar, kanë qenë disa prej angazhimeve kryesore në këtë kuadër. **“Kushtet e përgjithshme të burgjeve në Shqipëri, veçanërisht gjatë viteve të fundit, kanë pësuar ndryshime pozitive, duke ndikuar në përmirësimin e jetës së personave që mbahen në burgje dhe paraburgime, por në të njëjtën kohë dhe sigurinë e gjithë sistemit. Ndryshimet kanë ardhur paralelisht me ndryshimet konceptuale, logjistike, financiare dhe infrastrukturore.”**²⁰ Të gjitha këto ndryshime, janë reflektuar dhe në konkluzionet e raportit përfundimtar të Komisionit Evropian, datë 10.10.2012, ku citohet se “ka pasur progres në lidhje me Sistemin e Burgjeve, duke zbatuar në mënyrë të vazhdueshme programe trajnimi, rritje në numrin e aktiviteteve të ofruar për të burgosurit, si dhe përmirësimin e kushteve të përgjithshme të trajtimit të dënuarve dhe paraburgosurve. Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, e cila ka ardhur në rritje, ka pasur një impakt pozitiv në kushtet e dënimit.”²¹ Për ruajtjen e dinjitetit njerëzor gjatë kohës së vuajtjes së dënimit, zbatimi i detyrimeve që rrjedhin nga Rregullat Evropiane të Burgjeve, mbeten aspekte

¹⁸ “Kutia postare, të dënuarit mundësi të shprehin ankesat”, Gazeta Koha Jonë, 19 nëntor 2008

¹⁹ Ministria e Integritimit, mie.gov.al

²⁰ Sokol Çobo, “Amnistia për 100-vjetorin e Pavarësisë? Stimulim dhe rehabilitim për të burgosurit”, Gazeta Shqip, 4 prill 2012

²¹ European Commission, Commission staff working document, Albania 2012 Progress Report, 2012-2013 {com(2012) 600} Brussels, 10.10.2012 sëd(2012) 334, fq. 16

themelore. Në takimin e 15-të të Komitetit të Ministrave, aspekt themelor përbënte ingranimi i Rregullave Evropiane në sistemet e burgjeve. Sipas përshkrimeve të rekomandimit 2, përmirësimi i kuadrit ligjor, standardet dhe praktikat që aplikohen në trajtimin e personave me liri të kufizuar, konsiderohen themelore për respektimin e të drejtave të njeriut.²² Pikërisht, reforma në legjislacionin penitenciar shqiptar u bazua në këto rregulla, duke rishikuar konceptet e rehabilitimit social të personave me liri të kufizuar, të drejta këto që i sigurohen nëpërmjet ligjit. Ndryshimet në ligjin 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të burgosurve” dhe Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, përpos të tjerave synonin përmirësimin e dispozitave ligjore zbatimi i të cilave siguron një trajtim njerëzor të dënuarve dhe të paraburgosurve, duke theksuar këtu ri-edukimin e të dënuarve në këto institucione dhe zgjerimin e konceptit për mosdiskriminimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve. Ligji i ndryshuar «Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve» hyri në fuqi në prill të vitit 2008, ligji i Policisë së Burgjeve hyri në fuqi në dhjetor 2008, dhe «Rregullorja e Përgjithshme të Burgjeve» u miratua në mars 2009. Miratimi i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve në mars 2009 ka përcaktuar marrëdhëniet e punësimit të dënuarve në institucionet penitenciare. Komisioni i Vlerësimit të Punës së të paraburgosurve dhe të dënuarve përbërë nga përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Ministrisë së Drejtësisë ka përgatitur organikat e punësimit për 606 të burgosur, të cilat janë në proces miratimi. Organika jep një përshkrim të detajuar të vendeve për punësimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve.

Drejtësia për të miturit dhe trajtimi i tyre në vendet e vuajtjes së dënimit, si një ndër kategoritë më vulnerabël në sistem është në prioritetet e programeve të monitorimit të mekanizmave ndërkombëtarë për sistemin e burgjeve. Me mbështetjen e organizatës ndërkombëtare “Save the Children”, dhe UNICEF faza e dytë e projektit “Mbështetje për të miturit që ndodhen në Institutin e Riedukimit në Kavajë”. Ky projekt synon ofrimin e shërbimeve për përmirësimin e aktiviteteve trajnuese, trajnimin e stafit mbi zgjidhjen e konflikteve, si dhe mbështetjen e institucionit në krijimin e një rrjeti bashkëpunues, i cili do të sigurojë integrimin e të miturve në shoqëri, pas lirimit të tyre. Ndër qëllimet kryesore të projektit, synohet ofrimi i shërbimeve sociale, shëndetësore dhe strehimi pas lirimit, duke bërë të mundur punësimin e të miturve. Përpos këtij projekti, higjiena dhe kujdesi shëndetësor në institucionet penale, pranimi, komunikimi me botën e jashtme, takimet me familjarët, korrespondenca dhe ruajtja e privatësisë, janë kryer në përputhje të plotë me standardet e rekomanduara në Rregullat Evropiane të Burgjeve dhe Rekomandimet për të Miturit në konflikt me ligjin. Në këtë këndvështrim, u bënë

²² The Committee of Ministers Recommendation rec(2006)2 on the European Prison Rules, Strasbourg, 23.05.2011, PC-CP (2011) 10 revPc-cp/docs 2011/pc-cp (2011) 10 BIL REV

disa amendamente në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, si rishikimi i politikave të dhënies së masave disiplinore dhe ngritjen e Komisionit të Apelit të Masave Disiplinore në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, rritjen e numrit të takimeve me familjarët, shtimin e numrit të telefonatave, etj.²³ Për sa i përket rekomandimit të përfshirjes së të miturve të vendosur në paraburgime në aktivitete krijuese janë marrë masa të vazhdueshme që të paraburgosurit e mitur të përfshin në aktivitete edukuese, si arsimi formal, kurset profesionale, terapia e artit, aktivitete kulturore dhe sportive dhe përfshirja e tyre në spartakiada sportive. Organizimi i këtyre aktiviteteve ka njohur një rritje gjatë këtyre viteve. Përfshirja e të miturve në këto aktivitete kryhet sipas grafikut të punës. Stafet e edukimit në institucionet penale, i kanë dhënë rëndësi shtimit të numrit të aktiviteteve të ndryshme, pasi ndikojnë në rehabilitimin e kësaj kategorie.

OJF-të të cilat kanë si mision mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, janë lejuar në çdo kohë të kryejnë inspektime në ambientet e burgimit dhe të paraburgimit. Përfaqësuesit e këtyre organizatave janë lejuar të vizitojnë ambientet, të shohin dokumentacionin përkatës dhe të marrin kontakt direkt me personat e burgosur pa praninë e punonjësve të policisë.

Parandalimi i torturës nëpërmjet trajnimit të stafit

Që prej vitit 1997, në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve është hapur Qendra e Trajnimit. Në fillimet e saj, qendra ofronte trajnime bazë për punonjësit e policisë të ardhur rishitas në sistemin e burgjeve. Me konsolidimin e qendrës së trajnimit, filloi kualifikimi i të gjithë punonjësve të sistemit të burgjeve në të gjitha nivelet, nëpërmjet trajnimeve bazë dhe trajnimeve ndihmuese. Duke u mbështetur në eksperiencat më të mira të vendeve të BE-së, u hartua një program i ri trajnimi, i cili u synonte mundësinë e kombinimit të praktikës me njohuritë teorike në institucionet penitenciare. Programi i trajnimit u reformua dhe u konceptua në 240 orë, me një shtrirje kohore 45 ditë teori dhe 3 muaj praktikë.²⁴ Tregues suksesi i kësaj reforme është përmirësimi i shërbimit të trajnimeve në sistem, që përfshinte trajnime bazë, trajnime për ecjen në karrierë dhe trajnime specifike me një shtrirje kohore gjatë gjithë vitit. Neni 44 i ligjit për të drejtat e të dënuarve dhe paraburgosurve sanksion se, “personeli i burgut nuk përdor forcë kundër të burgosurve, me përjashtim të rasteve kur ky veprim është i nevojshëm për vetëmbrojtje ose në rast të tentativave për arratisje, rezistencë aktive ose pasive ndaj një urdhri të ligjshëm.”²⁵ Edhe në këto raste, forca përdoret si mjet i fundit. Masa e forcës së përdorur është minimumi i mundshëm dhe përdoret në kohën më të shkurtër të mundshme. Parandalimi i torturës, përbën një temë shumë të rëndësishme

²³ Neni 57, 61, i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve

²⁴ Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, www.dpbsh.gov.al

²⁵ Ligji nr. 8328, datë 16.04.1998, i ndryshuar

të trajnimit të gjitha niveleve të stafit në shërbimin e burgjeve. “Në trajnime janë përfshirë të gjitha nivelet e punonjësve, veçanërisht punonjësit e nivelit të mesëm të shërbimit të sigurisë, të cilët janë përfshirë në një program dy javor me dy faza, mbi programin bazë dhe programin e nivelit të mesëm të menaxhimit. Grupet e trajnimit janë kompozuar nga të gjithë shërbimet së bashku, me synim konsolidimin e ekipeve multi-disiplinare, qartësimin të roleve, theksimit të etikës profesionale dhe të bashkëpunimit”.²⁶ Modulet e trajnimeve janë pasuruar me problematikat e hasura në zbatimin praktik dhe me standardet ndërkombëtare. Kështu pjesë të moduleve kanë qenë Rec 2006(2) Rregullat Evropiane të Burgjeve, Rec. 2008 (11), “Mbi të miturit”, objekt i masave dhe sanksioneve, Konventat, Rregullat dhe Udhëzimet relevante për trajtimin e personave në konflikt me ligjin. Të gjitha aktet kryesore ndërkombëtare dhe legjislacioni i brendshëm, janë të lidhura në një tekst, të cilat janë dërguar pranë institucioneve për tu bërë pjesë e programeve të trajnimit. Gjatë vitit 2011, u përfshinë në trajnime 1028 punonjës të sistemit të burgjeve dhe paraburgimeve dhe u zhvilluan 218 ditë trajnime. Grupet që morën pjesë në trajnime ishin, punonjës të nivelit bazë të sigurisë të cilët u rekrutuan për herë të parë dhe të gjithë ata të cilët aplikuan për ngritje në gradë, punonjës të shërbimit të sigurisë niveli i mesëm, të cilët u trajnuan një javë për programin bazë dhe një javë për programin e nivelit të mesëm të menaxhimit. Grupi i tretë, specialistë të shërbimit social dhe të shëndetësisë të cilët u trajnuan një javë për trajtimin e personave përdorues të lëndëve narkotike. Në trajnime u përfshinë stafi që punon me të mitur si dhe niveli drejtues, drejtorët dhe zëvendësit e tyre.²⁷

Hap i rëndësishëm në sistemin e burgjeve, për të cilin edhe është vlerësuar në raportin e fundit të Bashkimit Evropian, ka qenë hartimi i formatit të dokumentimit të rasteve të dhunës fizike dhe psikologjike sipas rekomandimeve të Komisionit Evropian.²⁸ Sipas të dhënave zyrtare nga burgjet, “në bashkëpunim me Qendrën Shqiptare për Rehabilitimin e Traumës dhe Torturës, për herë të parë, gjatë vitit 2011, u hartua formati i dokumentimit të rasteve të ushtrimit të dhunës fizike dhe psikike, për urgjencat mjekësore, njohjen e ligshmërisë, dokument i unifikuar që u hartua sipas rekomandimeve dhe kërkesave të KE në përputhje të plotë me Protokollin e Stambollit”.²⁹ Ky format i ri është dërguar në të gjitha institucionet për tu bërë pjesë e veprimtarisë së punës. Hartimi i formatit, është produkt i trajnimeve të përbashkëta të vazhdueshme gjatë vitit 2011, me specialistë të fushës së shëndetësisë, policor dhe atij edukues të sistemit të burgjeve dhe ekspertëve të QSHRT. Në këtë kuadër janë organizuar trajnime të ndryshme, ku kanë marrë pjesë 35 mjekë dhe infermierë, 28 punonjës nga stafi policor dhe 33

²⁶ Rekomandimi 12 i Bashkimit Evropian

²⁷ Raport, Rekomandimi 12 i Bashkimit Evropian

²⁸ Shih referencë 23

²⁹ Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

punonjës nga stafi i edukimit. Ndër rekomandimet kryesore të Komitetit të Parandalimit të Torturës pranë Këshillit të Evropës, ishte marrja e masave për përmirësimin e mekanizmit të kërkesë ankesës në institucionet penitenciare. Përmirësimi i këtij mekanizmi shihej si një mjet efikas për parandalimin e torturës në institucionet e vuajtjes së dënimit, por në të njëjtën kohë ushtrimin e së drejtës së personave me liri të kufizuar për çdo ankesë apo kërkesë që e shikonin si mosrespektim të drejtave të tyre. Me iniciativën e Komitetit Shqiptar të Helsinkit u unifikua formati i kërkesë/ ankesës bazuar në modelin anglez të trajtimit të tyre. Gjithashtu është hartuar dhe një protokoll i cili do të shërbejë si udhëzues për të dënuarit në mënyrë që të lehtësojë dhe të përmirësojë plotësimin e formateve nga ana e të dënuarve.³⁰

Praktikat në trajtimin e personave me liri të kufizuar

Sipas të dhënave zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, deri në muajin shtator të vitit 2012, janë trajtuar mesatarisht rreth 4750 persona në të gjithë sistemin. Të ndarë sipas veprave penale të kryera, 41% e të dënuarve kanë kryer veprën penale të vrasjes, parashikuar nga nenet 76, 77, 78 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë. Veprat penale të plagosjes (20%) dhe trafikim të lëndëve narkotike (19%), përbëjnë dy vepra të tjera penale që dominojnë në klasifikimin e veprave të kryera nga personat me liri të kufizuar. Të dhënat mbi moshën e popullatës në burgje tregojnë se tre grupmoshat kryesore që janë të prirur të kryejnë krime përfshijnë 30-40 vjeç (25%), 25-30 vjeç (23%) dhe 21-25 vjeç (20%).

Duke u bazuar në veprat penale dominuese të kryera si dhe moshën e personave me liri të kufizuar, ku siç vërehet në figurën 5, të cilët i përkasin moshave relativisht të reja, hartimi i programeve rehabilituese, si individuale, ashtu dhe në grup, përveçse një domosdoshmëri, kërkon dhe aftësi të konsoliduara të stafit të burgjeve, veçanërisht atij social, në hartimin e planeve të edukimit dhe ri-integrimit social të personave me liri të kufizuar. Në një rrëfim për një gazetë të përditshme³¹, një e dënuar për vrasjen e bashkëshortit, rrëfen historinë e saj, ku tashmë fobia e krijuar, përtej pasojave të kryerjes së krimit, është bota që e pret jashtë.

“Unë e doja me çdo kusht këtë fëmijë, e kisha ndier të lëvizte brenda meje dhe me zor e prisja ta shihja. Ndërsa im shoq nuk donte t’ia dinte për këtë. Ai më thoshte se duhej të iknim në Itali. Filloi të më keqtrajtonte një ditë, kur ishim vetëm në shtëpi. Nuk e mendova gjatë, mora armën që ndodhej në dhomë dhe e qëllova.... Nuk e imagjinoj dot momentin kur të kthehem në shtëpinë e prindërore të mi. Ata nuk më kanë thënë asgjë deri tani, por e di që do më presin ... Të vuash dënimin është një gjë dhe të

³⁰ Sistemi i Burgjeve Shqiptare, Manual Informues, prill 2012, fq. 33

³¹ Suela Myseni “E vrava tim shoq se donte të abortoja fëmijën”, Gazeta Shekulli, 29 gusht 2009

bashkëjetosh me të burgosura të tjera, që kanë pasur halle të ngjashme më të tuat, është tjetër gjë... Punonjëset e burgut na qëndrojnë afër dhe na ndihmojnë për çdo problem, duke mos na gjykuar...Duke ndenjur gjithë kohës bashkë, jemi bërë si shoqe. U tregojmë brengat tona, sepse kemi nevojë të shprehim mallin dhe frikën që na mundon. Një ditë do të dal nga këto dyer, por më frikëson bota jashtë. Shpresoj të gjej një punë dhe të jetoj si të mundem”.

Studiuesi i mediave, Akademiku Prof. Dr. Artan Fuga, sqaron se “pesha e problemit është e madhe, sepse nga njëra anë shoqëria izolon fizikisht fajtorët për krime të ndryshme si ndëshkim, por edhe ka interes të realizojë me sa mundet edhe edukimin e tyre, të ruajë të drejtat e të dënuarve për informim, t’iu transmetojë vlerat e shoqërisë që qarkullojnë nëpërmjet mediave, si edhe të përgatisë ri-integrimin e tyre në shoqëri”.³² Sipas Përgjegjëses së Sektorit të Edukimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve janë tre faktorë kryesorë që ndikojnë në rehabilitimin e personave me liri të kufizuar: 1. Komunikimi i të burgosurve me botën e jashtme; 2. Aplikimi i programeve edukuese dhe sociale; 3. Krijimi i rrjeteve sociale, pas lirit nga burgu.³³ Komunikimi i të burgosurve me botën e jashtme shihet si një element mjaft domethënës në kuadrin e rehabilitimit social të tyre. Kontaktet e të burgosurve me botën e jashtme bëhen në zbatim të legjislacionit. Në një prononcim për mediat, Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve sqaroi se personat me liri të kufizuar, duhet të konsiderohen si pjesë të shoqërisë, pasi, pjesa më e madhe e tyre, shpresojnë dhe do t’i rikthehen jetës sociale të dikurshme. “Ura lidhëse midis botës përtej mureve të ngurta të burgimit dhe botës që kanë lënë pas tyre, padyshim që bëhet komunikimi. Natyrisht, komunikimin nuk e shohim thjesht si aspekt vizionar të një personi me liri të kufizuar, por si një realitet që krijohet dhe zhvillohet nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme të jetës në një institucion penal. Mënyra më efikase për të luftuar mbizotërimin e depressionit në institucionet e vuajtjes së dënimit, është nëpërmjet komunikimit efektiv me botën e jashtme”. Mbajtja e marrëdhënieve e të dënuarve me botën e jashtme, është një kapitull i veçantë në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve. Trajtimi dhe rehabilitimi i të burgosurve garantohet nga ligji Nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe paraburgosurve”, i ndryshuar, dhe nga Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve, miratuar me VKM. nr. 303 datë 25.03.2009, e ndryshuar.

*Korrespondenca dhe kontaktet me përfaqësues ligjorë, apo zyrtarë të burgjeve*³⁴: Bazuar në nenin 63 të VKM-së nr. 303 datë 25/03/2009, mbi “Takimet me

³² Artan Fuga, “Veçoritë e funksioneve të medias në institucionet e mbyllura. Përtej stereotipave jo kritike”, mbajtur në Konferencën Shkencore “Komunikimi në institucionet e mbyllura”, Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit”, Edlora, Tiranë, 2011, fq. 171

³³ Intervistë personale, 13/10/2012

³⁴ Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve

prokurorë, avokatë ose oficerë të policisë gjyqësore”, të burgosurit marrin takim me prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore ose avokatët, sa herë që këta të fundit e shikojnë të arsyeshme gjatë procesit të hetimit. Takimi i prokurorit, oficerit të policisë gjyqësore dhe avokatit, lejohet çdo ditë si rregull nga ora 08:00 deri në orën 19:00. Takimet nuk vëzhgohen. Mbështetur në nenin 60 të VKM-së nr. 303 datë 25/03/2009, të ndryshuar, për “Korrespondencën” i burgosuri ka të drejtë të mbajë korrespondencë. Për të burgosurit që nuk i kanë mundësitë, personeli i IEVP, vë në dispozicion mjetet e nevojshme për korrespondencë. Korrespondenca hidhet në kutinë postare të IEVP. Letrat merren nga një punonjës i postës, dy herë në javë dhe postohen sipas destinacionit. Shpërndarja e korrespondencës së ardhur, bëhet nga personeli i IEVP duke ruajtur fshehtësinë e saj. Në rastet kur ka dyshime të bazuara se në korrespondencë ka sende të ndaluara, ajo hapet në prezencë të burgosurit dhe të drejtuesve të IEVP. Drejtori i IEVP, me kërkesë të prokurorit ose të gjykatës, mund të kufizojë të drejtën e të burgosurit për korrespondencë, nëse kjo është e nevojshme për kryerjen e veprimeve procedurale penale. Kjo praktikë nuk bën përjashtim edhe për korrespondencën (me shkrim) e të burgosurit me përfaqësuesin e tij ligjor. I burgosuri me anë të kërkesave të parashtruara me shkrim ose verbalisht (sipas praktikës që ndiqet nga institucionet), ka të drejtë të marrë kontakt me zyrtarë të burgjeve brenda afateve të caktuara të parashikuara me ligj.

Lidhjet me familjen: Kujdes i veçantë i kushtohet ruajtjes dhe zhvillimit të lidhjeve mes të burgosurve dhe familjarëve të tyre. i) Të burgosurit lejohen të informojnë menjëherë familjarët për hyrjen e tyre në një institucion penitenciar, ose për transferimin nga një institucion në një tjetër. ii) Sipas legjislacionit në fuqi të burgosurit kanë të drejtë të takojnë familjarët dhe të afërmit e tyre. Këto takime realizohen 4 herë në muaj dhe zgjasin 30 minuta. I burgosuri ndër të tjera 1 herë në muaj ka të drejtën e një takimi të zgjatur me bashkëshortin/en. iii) Për gratë e dënuara dhe të miturit bëhet një program i posaçëm dhe favorizues për lidhjet me familjen. Për gratë e burgosura shtatzënë ose me fëmijë deri në 3 vjeç funksionon çerdhja me shërbim 24 orësh pranë IEVP. iv) Për gratë e dënuara me fëmijë në institucionet rezidenciale për fëmijë zhvillohet një program i veçantë “Prindërimi në distancë”. v) Për të burgosurit që për arsye të ndryshme personale nuk kanë kontakt me familjarët e tyre, institucionet nëpërmjet punonjësve socialë synojnë rivendosjen e këtyre kontakteve.

Telefonatat: Në zbatim të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, neni 61, të burgosurit i lejohet korrespondenca telefonike 8 (tetë) herë në muaj me familjarët, të afërmit dhe miqtë e tij. Drejtori i IEVP mund të autorizojë thirrje të tjera telefonike më situata të jashtëzakonshme. Për çdo bisedë telefonike, i burgosuri deklaron numrin e telefonit drejt të cilit do të kryhet thirrja dhe nuk mund të zgjasë më shumë se 10 minuta. Shërbimi telefonik ofrohet nëpërmjet aparatit kartofonik të IEVP, sipas grafikut të telefonatave

të miratuara nga drejtori i IEVP dhe kostoja e këtyre telefonatave përballohet nga vetë i burgosuri. Bisedat telefonike zhvillohen nën kontroll shikimi e jo dëgjimi nga personel i mbikëqyrës. Të burgosurve të mitur iu lejohet korrespondenca telefonike 16 herë në muaj. Në rastet kur të burgosurit nuk kanë mjete financiare për të kryer biseda telefonike me familjarët, iu sigurohet korrespondenca telefonike 1 herë në muaj deri në 5 minuta me shpenzimet e IEVP. Drejtori i IEVP, me kërkesë të prokurorit ose gjykatës, mund ta kufizojë të drejtën e të burgosurit për korrespondencë telefonike nëse është e nevojshme për kryerjen e veprimeve procedurale penale. Në çdo institucion janë të afishuara numra kontakti falas të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Avokatit të Popullit.

Kontaktet me përfaqësuesit diplomatikë për të burgosurit me shtetësi të huaj: Neni 62³⁵ parashikon se të burgosurit me shtetësi të huaj i krijohen të gjitha lehtësitë e nevojshme për komunikimin me përfaqësuesit diplomatikë ose konsullorë të shtetit përkatës. Të burgosurit, shteti i të cilit nuk ka përfaqësi në Republikën e Shqipërisë, refugjatëve, si dhe personave pa shtetësi, u krijohen të njëjtat lehtësira për të komunikuar me përfaqësuesit diplomatike të shtetit që merr përsipër mbrojtjen e interesave të tyre ose me autoritetet kombëtare apo ndërkombëtare që kanë për objekt të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e interesave të këtyre personave. Drejtoria e IEVP bashkëpunon me përfaqësuesit diplomatikë dhe konsullorë.

Lejet shpërblyese dhe lejet e veçanta: Për të burgosurit që përmbushin kriteret ligjore aplikohet dhënia e lejeve shpërblyese (neni 69) ose e lejeve të veçanta (neni 70). Kjo gjë synon ruajtjen e kontakteve me jashtë. Leja shpërblyese nuk mund të jepet më shumë se 10 ditë dhe në total nuk mund të jetë për më shumë se 20 ditë në vit. Për të dënuarit e mitur kohëzgjatja e lejeve shpërblyese nuk mund të jetë më shumë se 20 ditë për çdo rast dhe në total nuk mund të jetë më shumë se 45 ditë në vit. Në çdo rast, nga miratimi i lejes shpërblyese të fundit duhet të kenë kaluar të paktën 3 muaj. Leja e veçantë mund të jepet deri në 7 ditë dhe mund të zgjatet me miratimin e drejtorit të IEVP, vetëm për rastet e sëmundjeve të rënda, pasi i burgosuri të ketë plotësuar kërkesat e shkronjës "a" të pikës 1 të këtij neni, lidhur me rastin e sëmundjeve të rënda. Kohëzgjatja e lejes së veçantë nuk mund të jetë më shumë se 30 ditë.

Takimet me Avokatin e Popullit dhe takimet me noterët dhe punonjësit e gjendjes civile: Në zbatim të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, neni 64, të burgosurit kanë të drejtë të paraqesin ankesa, si dhe të takohen me Avokatin e Popullit. Takimi i të burgosurve me Avokatin e Popullit nuk vëzhgohet. Në çdo IEVP, ekziston një kuti postare për korrespondencën me Avokatin e Popullit. Neni 65 i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, për efekt të kryerjes së veprimeve ligjore, si lidhje dhe zgjidhje kontrate, hartimin e akteve të shit-

³⁵ Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve

blerjes apo huas, kalim trashëgimie etj, i burgosuri lejohet të kontaktojë me noterin e zgjedhur prej tij ose nga të afërmit e tij apo pala tjetër, me pëlqimin paraprak të burgosurit. Për efekt të kryerjes së procedurave dhe evidentimit në dokumentet përkatëse të fakteve të tilla si, celebrim martesor, lindje etj, i burgosuri lejohet të takohet me punonjësin e zyrës së gjendjes civile. Faktet e martesave, lindjeve, si dhe fakte të tjera të kësaj natyre, të ndodhura gjatë periudhës së qëndrimit në institucion, evidentohen në regjistrin themeltar.

Aplikimi i programeve edukuese, shihet si një praktikë tejet vlerësuese për marrjen e masave rehabilituese për personat me liri të kufizuar. Rekomandimi Nr. R (89) 12 i Këshillit të Evropës mbi "Edukimin në burgje", parashikon:

1. Të gjithë të dënuarit duhet të edukohen dhe kjo duhet të realizohet nëpërmjet klasave mësimore, edukimit profesional, aktiviteteve kulturore dhe krijuese, sporteve e edukimit fizik, edukimit social dhe shërbimit bibliotekar.
2. Edukimi për të burgosurit duhet të jetë njëloj si ai që u sigurohet grupmoshave të ngjashme jashtë burgut dhe se vargu i mundësive të mësimt duhet të jetë sa më i gjerë që të jetë e mundur.
3. Edukimi në burg duhet të ketë qëllim zhvillimin e personit në tërësi duke e ndërgjegjësuar për gjendjen e tij social-ekonomike dhe kulturore.
4. Të gjithë ata që përfshihen në sistemin e burgjeve duhet të lehtësojnë dhe mbështesin edukimin sa më shumë të jetë e mundur.
5. Edukimi nuk duhet të mbetet vetëm në letra, por edhe në punën që duhet të bëhet brenda regjimit të burgut dhe nga pjesëmarrja në edukim të burgosurit nuk duhet të humbin as financiarisht dhe as në ndonjë mënyrë tjetër.
6. Duhet të bëhet çdo përpjekje për të inkurajuar të burgosurit të marrin pjesë aktivisht në të gjitha aspektet e edukimit.
7. Duhet të sigurohen programe zhvillimi për edukatorët e burgjeve në mënyrë që të adaptojnë metoda të përshtatshme për edukimin e të rinjve.
8. Duhet t'u kushtohet vëmendje e veçantë të burgosurve me probleme të veçanta dhe sidomos atyre që nuk dinë shkrim dhe lexim.
9. Edukimi profesional duhet të synojë një zhvillim të gjerë të individit dhe duhet të jetë i ndjeshëm ndaj tendencave të tregut të punës.
10. Të burgosurit duhet ti ofrohet direkt shërbimi bibliotekës të paktën një herë në javë.
11. Duhet të theksohet dhe inkurajohet edukimi fizik dhe sportet për të dënuarit.
12. Duhet tu jepet rëndësi e madhe aktiviteteve kulturore dhe kreative,

sepse ato kanë një fuqi të veçantë për ti aftësuar të burgosurit të shprehin vetveten.

13. Edukimi social duhet të përfshijë elemente të veçanta që aftësojnë të burgosurin të organizojë jetën e përditshme në burg dhe për të lehtësuar kthimin në shoqëri.
14. Kur është e mundur, të burgosurit duhet të lejohen të marrin pjesë në edukim jashtë burgut.
15. Kur edukimi bëhet brenda burgut, komuniteti i jashtëm duhet të përfshihet sa më shumë të jetë e mundur.
16. Duhet të merren masa për të aftësuar të burgosurit që të vazhdojnë edukimin edhe pas lirimimit nga burgu.
17. Duhet të vihen në dispozicion fondet, pajisjet dhe stafi mësimor i nevojshëm për të aftësuar të burgosurit të marrin edukimin e përshtatshëm.

Në institucionet e vuajtjes së dënimit, veçanërisht gjatë viteve të fundit, si rrjedhojë edhe e nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me organizata të ndryshme jo fitimprurëse që operojnë në fushën e të drejtave të njeriut, organizohen aktivitete të shumëllojshme, me qëllim zbatimin e rekomandimeve ndërkombëtare për rehabilitimin e të burgosurve, por në të njëjtën kohë përmirësimin e ofrimit të shërbimeve tërësore në burgjeve, duke i përafuar me standardet ndërkombëtare. Në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, 2007-2013, janë përcaktuar treguesit e performancës së sistemit të burgjeve. Siç vihet re në figurën e mëposhtme, treguesit e performancës lidhen kryesisht me masat rehabilituese në kuadër të trajtimit dhe ri-integrimit të personave me liri të kufizuar. Sipas strategjisë, qëllim kryesor mbetet “përmirësimi i sistemeve të burgimit dhe paraburgimit në kuadër të garantimit të drejtave themelore të individit, krijimi i kushteve të duhura për zbatimin me rreptësi të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor ekzistues, duke garantuar që të gjitha organet e zbatimit të ligjit të sigurojnë një trajtim njerëzor në paraburgim dhe shndërrimin e dënimit penal në një mundësi riedukimi nëpërmjet.” Mbi bazën e kësaj strategjie, janë përcaktuar dhe tre objektivat kryesorë mbi të cilat bazohet ecuria dhe vlerësimi i përgjithshëm i Sistemit të Burgjeve Shqiptare.³⁶

Objektivi 1: Respektimi i konventave ndërkombëtare për ngritjen dhe drejtimin e institucioneve të vuajtjes së dënimit dhe trajtimin e të paraburgosurit e të burgosurit në pritje të gjyqimit;

³⁶ Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, Republika e Shqipërisë, Këshilli i Ministrave, mars 2008, fq. 29-30

Objektivi 2: Zbatimi i masterplanit për përmirësimin e kushteve për të burgosurit dhe zgjidhjen e problemit të mbipopullimit të burgjeve sipas rekomandimeve të Këshillit të Evropës;

Objektivi 3: Rritjes së përfshirjes së të burgosurve në veprimtari që do të mbështesin ri-integrimin e tyre pas lirimit;

Objektivi 4: Ngritjes së strukturës për zbatimin e dënimeve alternative;

Objektivi 5: Shpërndarja e të dënuarve nëpër institucionet pranë qendrave të tyre të banimit;

Objektivi 6: Reformës së sistemit të burgimit për të miturit, përshtatjes së mjediseve për funksionimin e Institutit të Riedukimit për të miturit, ndërhyrjes së nevojshme ndërtimore dhe pajisjes së ndërtesës, si dhe trajnimit të personelit të Institutit;

Objektivi 7: Rritja profesionale e stafit.

Reformimi dhe ndryshimi i politikës së sistemit të burgjeve, nga një sistem totalisht ndëshkivor gjatë regjimit komunist, në një sistem me mundësi rehabilitimi dhe ri-edukimi për personat të cilët mbahen dhe trajtohen në burgje dhe paraburgime, është rrjedhojë jo vetëm e partneritetit ndërkombëtar, por edhe e angazhimeve vendore. “Aspekt themelor në zbatimin e ligjshmërisë dhe përmirësimin e kushteve të burgjeve në Shqipëri, është monitorimi i gjithë sistemit nëpërmjet treguesve të realizimit të performancës, të cilat janë të përcaktuar në dokumente strategjike siç është Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, Plani i Veprimit i Rekomandimit të 12-të të Bashkimit Evropian, e shumë të tjera. Pra, janë vendosur objektiva strategjike dhe është vendosur një vizioni i qartë, ecuria e të cilave monitorohen në mënyrë të pavarur dhe transparente nga institucione publike vendase dhe ndërkombëtare, si dhe shoqëria civile.”³⁷

Sipas objektivit 5-së të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, sa i takon sistemit të burgjeve, si masë rehabilituese e veçantë konsiderohet “shpërndarja e të dënuarve nëpër institucionet pranë qendrave të tyre të banimit”. Shpërndarja e të burgosurve bëhet duke respektuar parimin rajonal në respektim të rregullave evropiane të burgjeve, ku i dënuari apo i paraburgosuri duhet të vendoset sa më afër vendbanimit me familjarët e tij. Sipas Rregullave Evropiane të Burgjeve³⁸, të burgosurit vendosen, për sa është e mundur, në burgje pranë shtëpive të tyre ose vendeve të rehabilitimit social. Në pajtim me ligjin nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar, “respektohet kriteri i sistemit të burgosurve në institucione që janë pranë vendndodhjes

³⁷ Intervistë, Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, Gazeta Shqip, 4 prill 2012

³⁸ Neni 11

së familjeve të tyre.”³⁹ Zbatimi i parimit rajonal, lehtëson rehabilitimin, liron barrën e familjeve dhe siguron që të liruarit me kusht të jenë në një distancë të afërt komunikimi me gjykatat dhe këshillimin ligjor.⁴⁰ Megjithatë, realizimi i këtij kriteri varet nga disa faktorë ku përfshihen konfliktet e mundshme që mund të ketë i burgosuri në një institucion penal bazuar në krimin e kryer, gjendja e tij shëndetësore fizike dhe mendore, përcaktimi i nivelit të sigurisë në të cilën personit që i është hequr liria do të mbahet, niveli i mbipopullimit në IEVP, apo vendndodhjen e gjykatës ku është duke u mbajtur seanca gjyqësore, për personat të cilët janë në proces gjykimi, apo apelimi.⁴¹

Si rrjedhojë e dukurive sociale si migrimi i brendshëm, varfëria e papunësia, divorcet, familjarët e personave të privuar nga liria për shkaqet e mësipërme, përfshirë dhe mundësinë e fenomenit të hasmërisë apo gjakmarrjes, një fenomen i cili mund të lindë si pasojë e veprës penale të kryer nga anëtari i familjes i akuzuar apo dënuar, vërehet një prirje e rritjes së numrit të personave të cilët ndryshojnë vendbanimin. Të dhënat zyrtare të INSTAT “vënë në dukje rolin e madh që luan migracioni në dinamikën e rajoneve, duke i dhënë një shtysë të madhe Tiranës dhe Durrësit dhe një ngadalësim të dukshëm rritjes demografike të rajoneve, në veçanti Jugut, dhe akoma më shumë, Veriut. Supozimet i kanë mbajtur të pandryshuara shkallët e migracionit të matura në 2000-2001-shin, por duhet marrë parasysh fakti se migracioni i brendshëm është një fenomen i cili po bëhet më se evident në Shqipëri. Qëndrueshmëria e tendencave më të fundit është një çështje e hapur. A do të jenë Tirana dhe Durrësi në gjendje të përballojnë lëvizjet konstante të porsaardhurve gjatë njëzet viteve të ardhshme? Ka të ngjarë që Veriu dhe Jugu të zbrazen nga popullsia gjatë dy dekadave të ardhshme. Ndoshta do të ishte me vend të kufizohej përdorimi i parashikimit të popullsisë në dhjetë në vend të njëzet viteve dhe të merreshin rezultatet për vitet e mëvonshme si një skenar i thjeshtë, i cili do të meritonte më shumë njohuri për zhvillimin e migracionit në Shqipëri para se ai të mund të konfirmohet apo të përshtatet, i cili parashikon mbipopullimin e pashmangshëm të zonës së Tiranës dhe Durrësit.”⁴²

Si dukuri, lëvizja demografike drejt zonave urbane, ka pasojat dhe ndikon dhe popullatën e të burgosurve në institucionet penale. Problematika lidhet me kërkesat për transferim të personave të privuar nga liria, ku si rrjedhojë e ndryshimit të vendbanimit të familjarëve, kërkohet dhe ndryshimi i institucionit, duke pasur një rritje të numrit të kërkesave për transferime në institucionet që ndodhen në Qarkun e Tiranës, apo Qarkun e Durrësit. Kështu, veçanërisht në ndërtimin e burgjeve të reja, duhet marrë në konsideratë lëvizjen demografike dhe migrimi i brendshëm lidhur me kapacitetet e institucioneve penale.

³⁹ Neni 66

⁴⁰ Sistemi i Burgjeve Shqiptare, fq. 31

⁴¹ Intervistë personale, 18/10/2012

⁴² INSTAT, “Lëvizja drejt qendrave urbane”, shtator 2009

Zhvillimi i programeve për rehabilitimin e personave me liri të kufizuar
 Rekomandimi nr. 89 i Këshillit të Evropës, përshkruan rëndësinë e ofrimit të shërbimeve edukuese në burgje, arsimimit, programeve të zhvillimit, shërbimit bibliotekar, edukimit social dhe lidhjen me komunitetin.⁴³ “Futja e një koncepti të ri të drejtimit të sistemit dhe trajtimit të individëve të privuar nga liria, është realizuar nëpërmjet procesit të përshtatjes së eksperiencave dhe legjislacionit, sipas kërkesave dhe standardeve të Bashkimit Evropian. Sistemi i Burgjeve nuk është sistem ku të dënuarit përveç dënimit të gjykatave të marrin dënime të tjera, por është një sistem që veprimtarinë e bazon në trajtimin rehabilitues për të dënuarit dhe të sigurisë për shoqërinë.”⁴⁴ Një nga bazat kryesore të trajtimit të personave me liri të kufizuar, është edukimi i tyre nëpërmjet arsimimit. Sipas punonjësve social të Sektorit të Problemeve Shoqërore në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve⁴⁵, arsimimi është çelësi kryesor i vazhdueshmërisë së jetës sociale pas lirimit nga burgu, por në të njëjtën kohë, krijon baza të qëndrueshme për rikthimin në shoqëri. Të dhënat zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve tregojnë se 49% e të burgosurve që ndodhen në institucionet e vuajtjes së dënimit, kanë arsim 8-vjeçar. 24% e kanë arsim të mesëm dhe 21% kanë arsim të ciklit të ulët shkollor. Sipas të dhënave 4% janë analfabetë dhe vetëm 2% e të burgosurve kanë arsim të lartë.

Profesori kërkues në universitetin e Monash, Gerald G. Gaes, nëpërmjet studimit të tij për impaktin e aplikimit të programeve edukuese në burgje, na sjell disa gjetje mjaft interesante, për të kuptuar rëndësinë që merr arsimimi në burgje për rikthimin me sukses të dënuarve në shoqëri, e për më tepër si faktor kryesor në uljen e numrit të recidivistëve. Studimi u krye duke marrë si grup kampion 3740 të dënuar dhe të paraburgosur që ndodheshin në burgjet amerikane gjatë viteve 1996-2006, me kohë qëndrimi deri në 5 vjet. Gjetja kryesore ishte se 56% e të dënuarve të cilët kishin qenë aktivë në programet edukuese që zhvilloheshin në burgje, nuk ishin kthyer në institucionet e vuajtjes së dënimit.⁴⁶ Natyrisht, që reduktimi i numrit të recidivistëve përfshin edhe faktorë të tjerë siç janë rrethanat shoqërore të përfshirjes në komunitet të personave të cilët kanë kryer vepra penale, duke i dhënë një alternativë të tjetër, përveç kryerjes së krimeve. Ky fakt mbështetet fort nga Drejtuesi Ekzekutiv i Menaxhimit të Shërbimit të Administratës së Burgjeve në Mbretërinë e Bashkuar, Martin Narey, i cili në raportimin e tij vjetor përpara Komisionit të Ligjeve, deklaroi: “Unë besoj fuqimisht se në kemi mundësi të ulin nivelin

⁴³ Rekomandimi nr. 89 i Këshillit të Evropës “Edukimi në burgje”, miratuar nga komiteti i Ministrave më 13 tetor 1989, Strasburg

⁴⁴ Aleksandara Bogdani, “Ja amnistia e të burgosurve për 100 vjetorin e Pavarësisë”, Gazeta Mapo, 10 shtator 2012

⁴⁵ Intervistë personale, 03/11/2011

⁴⁶ Gaes G. Gerald “The Impact of Prison Education Programs on Post-Release Outcomes”, shkurt, 2008

e kriminalitetit dhe të ndryshojmë jetën e shumë njerëzve. Mënyra më e mirë për këtë, është nëpërmjet edukimit dhe nëse kemi arritur sukses në edukimin e tyre ne do të mundemi të ulim numrin e recidivistëve”⁴⁷ Megjithatë, qëllimi i edukimit në burgje nuk duhet të përqendrohet vetëm në uljen e numrit të recidivistëve. Edukimi dhe procesi i të përfshirit në të mësuarit, ka një vlerë në vetvete të pazëvendësueshme e cila duhet të njihet. Fokusi që i jepet në uljen e numrit të recidivistëve, duke mos konsideruar të drejtat e të burgosurve për arsimimin, nuk është i mjaftueshëm. Kësaj pikëpamje i qëndron dhe profesori Andrew Coyle, Drejtor i Qendrës Ndërkombëtare të Studimit të Burgjeve në Kings College në Londër, i cili thotë: “Ne duhet të ofrojmë arsimimin në burgje, pasi është gjëja e duhur që duhet bërë. Kjo është një çështje tejet e rëndësishme, jo vetëm në kuptimin që ka edukimi, por të kuptuar se çfarë ndodh në burgje”.⁴⁸

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë “garanton arsimimin parauniversitar për të gjithë shtetasit e saj dhe u sigurohet ndjekja e Institucioneve arsimore parauniversitare pa asnjë lloj diskriminimi për shkak të përkatësisë së racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, besimit kombësisë, origjinës etnike, gjendjes sociale, pronësore, shëndetësore etj. Të gjithë fëmijët dhe të rriturit kanë të drejta të barabarta për të ndjekur Institucionet arsimore parauniversitare.”⁴⁹ Nenin 37 të Rregullores së Burgjeve trajtohet rëndësia e arsimit në ambientet e izolimit, nxitja e të dënuarve për arsim dhe formim profesional si dhe prania e ambienteve shkollore brenda këtyre institucioneve. Rëndësi e madhe u jepet persona të cilët janë nën moshën 25 vjeç ku qëllimi është ndërgjegjësimi i tyre ndaj arsimit. “Arsimimi dhe formimi kulturor e profesional bëhet me anë të organizimit të shkollës, e detyrueshme për të miturit, si dhe të kurseve profesionale, sipas sistemeve në fuqi. Nxitet kryerja dhe favorizohet ndjekja e studimeve profesionale, duke përdorur kurset me korrespondencë. Favorizohet leximi pa kufizim i publikimeve dhe përdorimi i sistemeve të tjera informative të bibliotekës së institucionit. Kujdes i veçantë i kushtohet formimit kulturor e profesional të dënuarve me moshë nën 25 vjeç”.⁵⁰ Ndryshimet në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, në dhjetor të vitit 2008 i hapën rrugë nënshkrimit të Memorandumit të Bashkëpunimit midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për arsimimin e paraburgosurve dhe të dënuarve në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale sipas programeve mësimore të miratuara nga MASH. Sipas marrëveshjes procesi mësimor do të realizohet me kohë të plotë ose të pjesshme në një ambient të veçantë të përshtatur për dhënie mësimi pranë

⁴⁷ Education and Skills, www.parliament.uk

⁴⁸ Po aty

⁴⁹ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 57

⁵⁰ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 96, datë 09.03.2000 “Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve” Neni 37

IEVP. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka marrë përsipër sigurimin e kushteve, lehtësirave dhe infrastrukturës së nevojshme si dhe sigurimin e transportit të personelit mësimdhënës në institucionet përkatëse.⁵¹ Prej vitit shkollor 2009-2010 deri në vitin shkollor 2011-2012, procesi mësimor i arsimit të detyrueshëm u zhvillua në 5 institucione penale, përkatësisht në Vaqarr, Kavajë, Peqin, Fushë-Krujë dhe Korçë. Shtrirja e procesit mësimor në institucionet penale ka qenë një ndër angazhimet kryesore të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve në kuadër të nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizimit Asociimit. Me nënshkrimin e memorandumit të bashkëpunimit midis MD dhe MASH, shkolla e parë 9-vjeçare u hap në IEVP Peqin.⁵² Tekstet mësimore ofrohen flas për të dënuarit. Deri me nënshkrimin e memorandumit procesi mësimor zhvillohej në mënyrë jo-formale nga sektorët e edukimit në IEVP dhe ishin të organizuara në formën e kurseve kundër analfabetizimit. Në marrëveshjen e bashkëpunimit është parashikuar se arsimimi me kohë të plotë do të realizohet vetëm për nxënësit në moshën e arsimit të detyruar, pra të miturve, ndërsa arsimimi me kohë të pjesshme do të realizohet në të gjitha IEVP, bazuar në legjislacionin përkatës për arsimimin me kohë të pjesshme. Gjatë vitit akademik 2012-2013, bazuar në marrëveshjen me Ministrinë e Arsimit është bërë e mundur hapja e shkollave edhe në katër institucione të tjera, ku prioritet i jepet hapjes së shkollave në institucionet e paraburgimit në seksionet e të miturve në Jordan Misja, Lezhë, Vlorë dhe Rrogozhinë. Më herët, arsimi ofrohej vetëm në vendet e vuajtjes së dënimit dhe për personat që kishin marrë një vendim të formës së prerë. Viti 2012, shënon vitin e parë të ofrimit të arsimit, veçanërisht për të miturit që ndodhen në institucionet e paraburgimit.

“Të gjithë të miturit që ndodhen në institucionet e paraburgimit në vend do të ndjekin ciklin shkollor 9-vjeçar në vendin e vuajtjes së dënimit. Nga fillimi i zbatimit të memorandumit të nënshkruar më datë 05.12.2008 midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Arsimit, kjo e drejtë ishte e siguruar vetëm për të miturit e dënuar në Institutin e të Miturve Kavajë. Të miturit e paraburgosur të regjistruar për fillimin e procesit arsimor do të kenë mundësi të ndjekin arsimin e detyruar 9-vjeçar deri në momentin e marrjes së vendimit gjyqësor së formës së prerë. Në rast marrje vendimi për dënim të miturit do të vazhdojnë procesin arsimor në I.M.Kavajë dhe në rast lirimi pranë qendrave të tyre të banimit.”⁵³

⁵¹ Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, për “Implementimin e ciklit të detyrueshëm parauniversitar në Sistemin e Burgjeve”, 05 dhjetor 2008

⁵² “Hapen Shkolla në burgje”, Kronikë, Top Channel, 21 shkurt 2009

⁵³ Njoftim për shtyp, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve “Edhe katër shkolla të tjera në Sistemin e Burgjeve”, 11/10/2012

Në një konkurs të shpallur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në bashkëpunim me Departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit në Universitetin e Tiranës, për esenë më të mirë, duke u bazuar në jetën e përditshme në institucionet penale, ku u trajtuan tema të ndryshme që rrokin nivelet e ndryshme të komunikimit në sistemin e burgjeve në Shqipëri me qëllim për të nxitur rritjen e impaktit të komunikimit në psikologjinë, dinjitetin dhe ri-integrimin social sa më shpejtë të dënuarve në paraburgime dhe burgje, i dënuari me inicialet A.S., në esenë e tij, flet për ndikimin e arsimimit në burgje. Sipas eksperiencës së tij personale ai shkruan se “ndjekja e shkollës në burg më ka ndihmuar dhe në të njëjtën kohë më ka frymëzuar për të vendosur disa qëllime të mira në jetën time, të cilat kanë ndikuar në rritjen e vetëvlerësimit, besimit, forcimin e dinjitetit dhe respektin për veten dhe të tjerët, por më tepër i kanë dhënë një vlerë jetës sime”.⁵⁴ Më tej ai shton se, “mbi të gjitha shkolla në burg dhe programet e tjera edukuese që ofrohen më ndihmuan që të jap një shembull të mirë për fëmijët e mi, familjen time, shembull që nuk e realizova me sukses gjatë viteve që isha i lirë.”⁵⁵ Psikologjia e institutit të miturve na shpjegon arsyet e rritjes së frekuentimit të shkollës në institut. Sipas saj në IEVP Kavajë ndodhen 42 të mitur. Gjendja e rënduar psikologjike, mendore dhe shpirtërore e të miturve gjatë fazës së pranimit në institut, shpesh nuk u siguron asnjë alternativë, aq më pak ndjekjen e shkollës e cila në vetëdijen e tyre do të thotë në një farë mënyrë “rregull dhe disiplinë”, e cila i ka munguar edhe në jetën jashtë burgut. Bazuar në këta faktorë psiko-socialë, të miturit dhe më së shumti ata që ndihen si “kryetarë të grupit”, e kanë të vështirë të marrin vendimin për të rifilluar procesin mësimor. Nëpërmjet hartimit të programeve të individualizuara dhe terapive okupacionale, është arritur ndërgjegjësimi i të miturve për të shfrytëzuar mundësinë që po i jepet për përfundimin e shkollës 9-vjeçare – thotë specialistja.⁵⁶

Gjatë vizitës së zhvilluar në Shqipëri të zotit Robert Badinter, senator në dhomën e parlamentit në Francë, 12-14 tetor 2011, me qëllim vlerësimin dhe hartimin e rekomandimeve për reformën në drejtësi për të miturit, ai theksoi se: “Duhet të mbizotërojë nevoja e zhvillimit të masave edukuese dhe të mbrojtjes sociale të zbatueshme, natyrisht kjo e paraprire nga iniciativa ligjore për këtë kategori. Nuk duhet lënë mënjanë ekzistenca e një procedure të qarte dhe sistematike të shërbimeve sociale me anë të së cilës mundësohet vlerësimi i masës së duhur për çdo të mitur”.⁵⁷ Ish edukatorja e burgut të grave 325, Fatime Sadikaj në një intervistë për një të përditshme sqaron se, “bëhet një punë e madhe në drejtim të edukimit. “Këtu kanë ardhur artistë për të argëtuar si dhe klerikë të feve të ndryshme, të cilët ndi-

⁵⁴ A. S, I dënuar në IEVP Fushë- Krujë “Arsimimi në burg”, Ese, tetor 2011

⁵⁵ Po aty

⁵⁶ Intervistë personale, 13 nëntor 2011

⁵⁷ Raport vlerësues “Reforma në drejtësi për të miturit”, tetor 2011

hmojnë të dënuarat nga ana shpirtërore”.⁵⁸ Një nga të dënuarat e burgut 325, B.A. e dënuar për vrasjen e bashkëshorti të saj, rrëfen se gjatë kohës së qëndrimit në burg, përpiqen të aktivizohen në kurset profesionale që ofrohen nga institucioni. “Përpiqemi të jemi të aktivizuara me kurse. Unë sapo kam përfunduar kursin e kompjuterit, tani jam në atë të qëndristarisë. Ka edhe të tjera: është rrobaqepësia, kuzhina. Deri tani unë jam pajisur me 3 certifikata. Me pak fjalë nga mëngjesi deri në darkë, përpiqem ta zë kohën me aktivitet.”⁵⁹ Pra, elementë të rëndësishëm në edukimin dhe rehabilitimin e personave me liri të kufizuar, shihen kurset e formimit profesional. Në to përfshihen kurse kuzhine, punë dore, kopshtari, kurse të gjuhëve të huaja dhe kompjuterit, parukeri, etj. Në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit, procesi i formimit profesional është zhvilluar normalisht mbështetur në kërkesat e të burgosurve, hapësirat e lira fizike dhe bazën materiale që disponojnë disa nga institucionet, si dhe llojet e kurseve profesionale që ofrohen nga drejtoritë rajonale. Kurset e formimit profesional ndiqen me satarisht nga 452 të dënuar dhe paraburgosur në 14 IEVP.

“Gama e aktiviteteve edukuese në burgje është e gjerë, duke filluar me programet e individualizuara të trajtimit të burgosurve, koha e këshillimit dhe terapisë 2.8 orë për një të burgosur, organizimin e aktiviteteve social-kulturore dhe sportive në burgje, promovimin e talenteve në art, punë dore dhe aftësi krijuese, ofrimin kurseve profesionale, e shumë të tjera.”⁶⁰ Shërbimi psikologjik u fut për herë të parë në sistemin e burgjeve gjatë vitit 2007⁶¹. Numri i stafit psikolog ka pësuar rritje nga viti në vit, duke shtuar në këtë mënyrë kohën e këshillimit dhe terapisë në muaj për çdo të burgosur. Koha e këshillimit dhe terapi është rritur nga 1.6 orë në muaj në 2007, në 2.7 orë në muaj për çdo të burgosur gjatë 2011. Rritja e orëve të këshillimit dhe terapisë, ka efekt mjaft pozitiv në lehtësimin e gjendjes psikologjike dhe shpirtërore të personave me liri të kufizuar. Ndikon në uljen e stresit dhe tensionit që ka një person, në kushtet kur kontakti me botën e jashtme është i kufizuar, si dhe merret më shumë informacion individual mbi gjendjen e personit. Është ndjekur dhe monitoruar implementimi i Planit të Vuajtjes së Dënimit dhe është trajnuar stafi i ri social në burgje për zbatimin e këtij formati, i cili shërben si orientim i të gjithë punës rehabilituese, që do të kryhet me të burgosurin gjatë periudhës së vuajtjes së dënimit. Sipas psikologëve të institucionit zbatohen modulet e programeve të trajtimit individual, për kategori të ndryshme personash me liri të kufizuar. Temat kryesore të programit përfshinin: a) mendimi prosocial (Të rinjtë); b) dhuna Gjinore; c) heroina, kokaina dhe drogat sintetike; d) parandalimi i vetëvrasjeve; e) personat me aftësi të kufizuar; f) të rinjtë 18-21 vjeçar (Modul respekti); g) trajnim për reduktimin

⁵⁸ Shih referencë 35

⁵⁹ Entela Resuli “Një ditë në burgun e grave”, Forumi Virtual, aksesuar më 10/10/2012

⁶⁰ Shih referencë 40

⁶¹ Sistemi i Burgjeve Shqiptare, fq. 19

e agresivitetit (ART), menaxhimi i zemërimit, abuzimi me alkoolin; h) disa programe para lirimit, etj. Qëllimi kryesor i zbatimit të këtyre programeve individuale është këshillimi dhe ofrimi i terapisë nga ana e specialistëve të kujdesit social në lehtësimin e gjendjes psikologjike dhe emocionale të dënuarve.⁶² Si pasojë, gjatë 2011 nuk është kryer **asnjë** vetëvrasje nga të burgosurit. Tentativa për vetëvrasje, por që janë parandaluar nga stafi policor, janë shënuar **8** raste në Qendrën Spitalore të Burgjeve, Jordan Misja, Fushë Krujë, Krujë dhe Tepelenë, kundrejt **25** rasteve në 2010.⁶³

Amendimet e bëra në VKM nr. 303 datë 25/03/2009, "Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve" të ndryshuar, përfaqësojnë një nismë të qartë të Qeverisë Shqiptare në drejtim të promovimit të burgosurve për t'u punësuar dhe për të përfutur shpërblim për punën e kryer. Që prej vitit 1991, Qeveria Shqiptare ka ratifikuar Konventa të ndryshme të Kombeve të Bashkuara dhe Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut. Në Rekomandimin (2006) 2 i Këshillit të Ministrave për Shtetet Anëtare mbi Rregullat Evropiane të Burgjeve⁶⁴ theksohet se "Puna në burgje konsiderohet një element pozitiv i regjimit të burgjeve dhe nuk përdoret asnjëherë si ndëshkim". Më tej neni 26/10 thekson se "Në të gjitha rastet, puna e të burgosurve shpërblehet me pagesën e duhur". Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve⁶⁵ përcakton qartë procedurat e punësimit të burgosurve, shpërblimin për punën, rregullat e funksionimit të Komisionit të Përhershëm të Vlerësimit të Punës në burgje, procedurat e vlerësimit dhe miratimit të kërkesës për të zhvilluar aktivitetin e punës, si dhe zbatimin e projekteve të punësimit. Me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 446 datë 16/11/2009, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve është ngritur Komisioni i Përhershëm i Vlerësimit të Aktivitetit të Punës në Burgje, në përbërje të cilit janë përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financës, Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, si dhe përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Në kuadër të zhvillimit të aktiviteteve të punësimit çdo Institucion i Ekzekutimeve të Vendimeve Penale, ka hartuar organikat e punës për të burgosurit mbështetur në nevojat e tyre dhe kërkesat e të burgosurve për t'u përfshirë në aktivitete punësimi. Mbështetur në këto organika, numri aktual i të burgosurve të përfshirë në aktivitet punësimi në të gjithë sistemin e burgjeve është 606 persona.⁶⁶ Indikatorët e objektivave që synojnë të arrihen nëpërmjet miratimit të projekt-aktit përfshijnë:

- ✓ Lehtësimi i rehabilitimit të burgosurve nëpërmjet punësimit;
- ✓ Aftësimi dhe trajnimi profesional i të burgosurve nëpërmjet përfshirjes në aktivitet punësimi;

⁶² "Në burgun e grave", Reportazh, Channel One, 16 qershor 2012

⁶³ Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Raport 2011

⁶⁴ Neni 26/1

⁶⁵ Kreu III, Nenet 83, 84, 85, 86, 87, 88,

⁶⁶ Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, faqja zyrtare online, aksesuar më 09/10/2012

- ✓ Rritja e kapacitetit financiar të burgjeve për shpërblimin për punën e të burgosurve, në përputhje me aktet ligjore në fuqi;
- ✓ Sigurimi i të ardhurave nga të burgosurit mbështetur në punën e kryer prej tyre, për plotësimin e nevojave personale dhe familjare;

Aplikimi i dënimeve alternative në vend, është një element më tepër për të kuptuar kursin e ndryshimit të sistemit, nga një sistem ndëshkues dhe të mbullur, në një sistem integruar dhe të hapur. Si pjesë e reformës në Sistemin e drejtësisë, me ligjin nr. 10024, datë 27.11.2008, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8331, datë 21.4.1998, "Për ekzekutimin e vendimeve penale", Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar kuadrin normativo-ligjor për ngritjen dhe funksionimin e institucionit të Shërbimit të Provës si organ shtetëror i specializuar për mbikëqyrjen e dënimeve alternative ndaj burgimit. Dhënia e dënimeve alternative synon të shmangë eksperiencën e burgosjes ose të kufizojë kohëzgjatjen e saj, duke pasur parasysh përshtatjen dhe integrimin e tyre në shoqëri.⁶⁷ **Që nga fillimi i funksionimit në vitin 2009 e deri në fund të vitit 2011, 4669 të dënuar morën dënime alternative. Nëse nuk do të ishin aplikuar alternativat e dënimit me burgim, sikurse parashikohej në Kodin Penal para ndryshimeve të bëra me anë të ligjit Nr. 10023, datë 27.11.2008 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 7895, datë 27.01.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar", atëherë këta 4669 persona do të ishin duke vuajtur dënimin me burg, në një nga institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, duke rritur nivele mjaft të larta mbipopullimin. Gjatë vitit aktual, janë rreth 2000 persona nën mbikëqyrjen e këtij shërbimi.**⁶⁸ Aktualisht, në bashkëpunim me ekspertë të huaj anglez, është duke u hartuar një projekt, për uljen e shpenzimeve në sistemin e burgjeve dhe rritjen e buxhetit për Shërbimin e Provës. Ky është një element shtesë për të kuptuar kursin e ndryshimit të sistemit të drejtësisë dhe rëndësinë e integritetit të personave me liri të kufizuar, duke aplikuar alternativa të tjera përveç burgimit. Këtij aspekti miratimi i ligjit për mbikëqyrjen elektronike të burgosurve. "Ligji përcakton teknikisht që mbikëqyrja elektronike të funksionojë me një pajisje elektronike, e cila do të jetë e lidhur me një sallë operative, nga ku do të monitorohet respektimi i urdhrave të gjykatës nga personat e dënuar. Ky model është praktikuar nga shumë vende të zhvilluara të botës dhe softi që do të blejë Shqipëria do të jetë nga modelet më të mira në treg. Mbikëqyrja elektronike do të përfshijë vendosjen e një byzylyku ose detektori në trupin e personit dhe do të mbikëqyret 24 orë. Rreth 300 persona janë parashikuar që të përfitojnë nga ky projekt, duke ulur në mënyrë të ndjeshme shpenzimet e Sistemit të Burgjeve."⁶⁹

⁶⁷ Historik i Shkurtër, Shërbimi i Provës, <http://www.sherbimiproves.gov.al>, aksesuar më 20/10/2012

⁶⁸ Shih referencë 75

⁶⁹ "Mbikëqyrje elektronike, GPS për të burgosurit me leje", Albanian Screen, 23 shtator 2011

Sipas Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, konceptimi i vendeve të vuajtjes së dënimit, si mundësi rehabilitimi, përpos një numri të konsiderueshëm programesh dhe aktiviteteve në këtë qëllim, ka ecur në mënyrë të njëtrajtshme me përmirësimin e disa procedurave dhe mekanizmave siç është i përmirësimit të kërkesë ankesave, mbrojtjes së dhënave personale dhe konfidenciale, si dhe parametrave të përgjithshëm të sistemit. Ndryshimet e akteve ligjore dhe nënligjore të sistemit të burgjeve kanë përmirësuar procedurat për të drejtën e kërkesave dhe të ankesave të burgosurve. Të burgosurit i krijohet mundësia që çdo ditë, me shkrim të paraqesë kërkesë, ankesë, Ministrit të Drejtësisë, Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, Avokatit të Popullit, Prokurorit, Gjykatës, Komisionit Mbikëqyrës të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, apo institucioneve të tjera shtetërore, si dhe të marrë përgjigje brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore në fuqi. Çdo ditë të premtë të javës, të gjithë qytetarët, zhvillojnë takime me Drejtorin e Përgjithshëm, duke parashtruar të gjitha kërkesat apo ankesat e tyre në lidhje me sistemin. Gjithashtu, që prej vitit 2008, funksionojnë kutitë postare në burgje për dorëzimin e ankesave dhe kërkesave të personave me liri të kufizuar, të cilat menaxhohen nga institucioni i Avokatit të Popullit.⁷⁰

Analiza e të dhënave

Në zbulimin e praktikave rehabilituese që zbatohen në sistemin e burgjeve dhe në të njëjtën kohë efektivitetin e tyre në rehabilitimin e personave me liri të kufizuar u përzgjedhën si grup kampionimi 20 persona, prej të cilëve 10 ekspertë të pavarur dhe 10 punonjës socialë të punësuar në sistemin e burgjeve. Duke qenë se ky punim synonte për të mbledhur të dhëna për të kuptuar praktikat që implementohen në sistemin e burgjeve shqiptare për rehabilitimin e personave me liri të kufizuar, nuk u synua të bëhej një ndarje e barabartë për sa i takon gjinisë së të intervistuarve. Kështu, në mënyrë rastësore u intervistuan 6 meshkuj dhe 14 femra, prej të cilëve, 3 i përkisnin moshës 25-30 vjeç, 10 i përkisnin moshës 30-35 vjeç dhe 7 i përkisnin moshës 35-40 vjeç. Lloji i intervistës së përdorur është intervistë e standardizuar me pyetje të mbyllura. Pyetësi ishte i përbërë nga 5 pyetje ku u synua që të mblidhej informacion rreth praktikave rehabilituese që ofroheshin në sistemin e burgjeve, e në mënyrë të veçantë nëse programet rehabilituese luajnë rol në uljen e recidivizmit, si dhe integrimin e të dënuarve në shoqëri. Sipas të dhënave zyrtare të Drejtërisë së Përgjithshme të Burgjeve, 85% e të dënuarve në vitin 2011 kishin kryer krime për herë të parë, 15% e tyre ishin përsëritës, prej të cilëve 9% përsëritës të njëjtit krim dhe 9% kishin kryer krime të tjera.⁷¹

⁷⁰ Shih referencë 49

⁷¹ Shih referencë 70, fq. 14

Referuar të dhënave të mësipërme, nevojitet një studim i veçantë për të kuptuar faktorët që kanë ndikuar në përsëritjen e krimeve dhe kthimin e një numri të konsiderueshëm individësh në institucionet e vuajtjes së dënimit. Kryesisht, studiues të shkencave sociale rendisin si faktorë kryesorë nivelin ekonomik dhe atë social. Megjithatë, nevojiten studime të mirëfillta edhe brenda sistemit të burgjeve për të kuptuar mbi efektivitetin e programeve rehabilituese dhe në mënyrë të veçantë, programeve gjatë fazës së përgatitjes për lirim. Të pyetur mbi rëndësinë e programeve dhe shërbimeve rehabilituese në sistemin e burgjeve, 100% e të intervistuarve u përgjigjën shumë të rëndësishme.

Raporti i vitit 2011 i Avokatit të Popullit, e vinte theksin mbi rritjen e numrit të aktiviteteve edukuese dhe gjithëpërfshirëse në institucionet e vuajtjes së dënimit. Nëse synohet krijimi i një sistemi efektiv rehabilitues dhe integruës, shtimi i programeve me karakter rehabilitues, duhet të jetë në fokusin kryesor.⁷² Natyrisht, e gjitha politika e rehabilitimit duhet të jetë e bazuar në studime të mirëfillta praktika të veçanta. Lidhur me efektivitetin e praktikave rehabilituese në uljen e numrit të recidivistëve në sistem, 15% e të intervistuarve u përgjigjën se kanë qenë disi efektive, 35% kanë qenë mjaftueshëm, 30% të rëndësishme dhe 20% mjaft të rëndësishme.

Bazuar në përgjigjet e të intervistuarve, lind nevoja për ri-konceptimin e programeve rehabilituese në sistem, veçanërisht të programeve të përgatitjes për lirim, duke u fokusuar në karakteristikat individuale të dënuarit, por edhe pritshmëritë e vlerësuara pas lirimit. Po kaq me skepticizëm shihet dhe efektiviteti i programeve rehabilituese në integrimin e personave me liri të kufizuar. 15% e të intervistuarve u përgjigjën nuk kishin efektivitet, 20% u përgjigjën se kishin disi, 40% u përgjigjën se ishte bërë një punë e mjaftueshme, 15% të rëndësishme dhe 10% shumë të rëndësishme.

Megjithatë, duhen konsideruar edhe faktorë të tjerë në integrimin e personave me liri të kufizuar në shoqëri, përpos programeve dhe praktikave që zhvillohen në institucionet penale. Nga përgjigjet e të intervistuarve, organizatat joqeveritare, veçanërisht ato që operojnë brenda sistemit të burgjeve, duhet të luajnë një rol më aktiv, në mbrojtjen e të drejtave të personave me liri të kufizuar, si dhe mundësitë e rrjeteve bashkëpunuese për integrimin e tyre në shoqëri. 40% e të intervistuarve e shikonin mjaft të rëndësishëm rolin e OJQ-ve, veçanërisht në krijimin e rrjeteve sociale të bashkëpunimit pas lirimi nga burgju të personave të burgosur.

⁷² www.avokatipopullit.gov.al, akseuar më 19/10/2012